

TIRANË  
2020



INSTITUTI I  
STUDIMEVE  
POLITIKE

KUVENDI:  
BILANCI, TRANSPARENCA  
DHE PROBLEMATIKA  
Raport monitorues shtator-dhjetor 2019




Kingdom of the Netherlands

DEPUTETIM.al





Kingdom of the Netherlands



# KUVENDI: BILANCI, TRANSPARENCA DHE PROBLEMATIKA

RAPORT MONITORUES

SHTATOR – DHJETOR 2019

TIRANË 2020



Projekti për monitorimin e Kuvendit (shtator 2017-shtator 2020) realizohet nga Instituti i Studimeve Politike [www.isp.com.al](http://www.isp.com.al) me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta. Në funksion të projektit është realizuar aplikacioni online [www.deputetim.al](http://www.deputetim.al) ku reflektohen të dhënat e vazhdueshme të monitorimit. Ky është raporti i pestë i monitorimit në kuadër të projektit.

**Opinionet e shprehura në këtë studim nuk përfaqësojnë  
opinionet e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta**

## **BOTUES**

Instituti i Studimeve Politike

## **EKIPI REALIZUES**

### **Drejtues i projektit**

Afrim Krasniqi

### **Ekipi i ekspertëve**

Ervin Karamuço

Brunilda Duriçi

Rudina Niklekaj

Juliana Bilbilaj

Dorjana Pano

Bora Elezi

Silvana Jaupaj

Kristi Bratja

Dorina Berdufi

Xhovana Cenga

### **Kopertina**

M&P Studio

**ISBN** ISBN 978-9928-4592-2-0

© Instituti i Studimeve Politike, Tiranë 2020

*INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE*

*Web: [www.isp.com.al](http://www.isp.com.al)*

*E-mail: [contactaips@isp.com.al](mailto:contactaips@isp.com.al)*

*Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies*

*Adresa: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë*



## PËRMBAJTJA E LËNDËS

---

### 1. HYRJE

### 2. GJETJET KRYESORE

#### 2.1. REKOMANDIME KRYESORE

### 3. SESION I DOMINUAR NGA PËRQËNDRIMI I PUSHTETIT

- 3.1. KUVENDI, MË SHUMË AKTE NORMATIVE SESA LIGJE TË PLOTA
- 3.1.2. NISMAT KRYESORE SHTYHEN PËR SESIONIN E RI PARLAMENTAR
- 3.1.3. NISMAT LIGJORE TË DEPUTETËVE NË TRE KATEGORI
- 3.1.4. PROBLEMATIKAT INSTITUCIONALE E TEKNIKE ME NISMAT LIGJORE
- 3.2. PD DHE LSI, NDRYSHIM KURSI NDAJ PARLAMENTIT
- 3.3. GRUPET PARLAMENTARE: NJË SHKRIHET, NJË HYN NË KONFLIKT
- 3.4. PARADOKSI: MAZHORANCA “ZGJEROHET” ME 10-16 DEPUTETË TË OPOZITËS
- 3.5. VOTIMET NË KUVEND ME DOKUMENTACION ITALISHT?
- 3.5.2. PAKETA “ANTI SHPIFJE”, GJASHTË VLERËSIME KRITIKE
- 3.5.3. PROKURORI I PËRGJITHSHËM, DY PROBLEME TEKNIKE TË VOTIMIT
- 3.6. GJASHTË DEPUTETËT “REBELË” NË PS, KRYESONJË BUSHATI E XHAFAJ
- 3.7. DEPUTETI DITMIR BUSHATI, ZËRI I VETËM KRITIK NË PS?
- 3.8. MUNGESA E OPOZITËS SË ORGANIZUAR, ZGJEDHJE “FORMALE” NË KUVEND
- 3.9. KUVENDI, VONESA NË PËRMBUSHJEN E FUNKSIONEVE ZGJEDHORE
- 3.10. HAPJA PËR PUBLIKUN, TË DHËNA POZITIVE PËR KUVENDIN
- 3.11. BASHKËPUNIMI ME SHOQËRINË CIVILE, PROGRES E PROBLEME
- 3.12. KUVENDI, I VETMI INSTITUCION ME TRANSPARENÇË FINANCIARE
- 3.13. RASTET ABUZIVE? MUNGON REAGIMI NGA KUVENDI
- 3.14. DY INTERPELANCA NË 4 MUAJ, NJË TJETËR NË PRITJE
- 3.15. KUVENDI 3 REZOLUTA POLITIKE GJATË SESIONIT TË VJESHTËS
- 3.16. KËRKESAT PËR INFORMACION DHE DHËNIA E INFORMACIONIT
- 3.17. DEPUTETË “HEADLINE” ME LAJME NEGATIVE?
- 3.18. DEPUTETËT, NJË RROGË MUJORE PËR TËRMETIN? JO TË GJITHË
- 3.19. VULLNET SINAJ, 10 MILIONË LEKË DONACION PËR VIKTIMAT E TËRMETIT

### 4. KOMISIONET: BILANCI E PROBLEMATIKA TË FUNKSIONIMIT

- 4.1. STANDARDET E PUNËS NË KOMISIONE? DISA GJETJE NGA MONITORUESIT
- 4.1.2. TRENDI I KOMISIONEVE, NXITIM PËR TË MBYLLUR DEBATET DHE MBLEDHJET
- 4.1.3. KOMISIONI PËR EKONOMINË, REKORD PËR DREJTIM TË PERSONALIZUAR
- 4.1.4. “KOMISIONI PËR EDUKIMIN” REKORD PËR SHKELJE ETIKE
- 4.2. TRANSPARENCA E MUNGUAR: 44% E PROCESVERBALEVE, JO PUBLIKE
- 4.3. KOMISIONET, MANGËSI ME DOKUMENTACIONIN ONLINE
- 4.4. MË PAK SE NJË E TRETA E DEPUTETËVE, AKTIVË NË KOMISIONE
- 4.5. ANGAZHIMI NË KOMISIONE, GRATË DEPUTETE 2% MË AKTIVË SESA MESHKUJT



5. **VOTA E DEPUTETËVE: GJETJET MË KRYESORE NË ÇDO KATEGORI**
    - 5.1. IKJA NGA VOTIMI NË SEANCË, SHIFËR REKORD NGA DISA DEPUTETË
    - 5.2. KRYEMINISTRI RAMA VOTOI VETËM 21% TË NISMAVE LIGJORE TË QEVERISË SË TIJ
    - 5.3. OPOZITA: 60% VOTË “PRO” AKTEVE TË QEVERISË NË KUVEND
    - 5.4. ALIMADHI 73% VOTË “KUNDËR”, 4 DEPUTETË ME 0% VOTA “KUNDËR”
    - 5.5. DEPUTETËT E RINJ ABSTENUES: KRYESONJË GJUZI, PAPA E MEÇO
  
  6. **SEANCAT PLENARE: BILANCI I FJALIMEVE, TEMATIKAVE DHE DEBATIT**
    - 6.1. PËR ÇFARË FLITET NË PARLAMENT?
    - 6.2. JAVA ELEKTORALE? VETËM 31% FOLËN PËR ZGJEDHËSIT
    - 6.3. “HESHTËN” OSE “FOLËN” VETËM NJË HERË, RRETH 45% E PARLAMENTIT
    - 6.4. “ORATORËT” KRYESORË NË SEANCË, DOMINUES PRURJET E REJA
    - 6.5. ANGAZHIMI NË SEANCË PLENARE, KRYESON GRUPI “DEMOKRAT”
    - 6.6. DEPUTETËT MË TË “SPONSORIZUAR” NGA PARTITË
    - 6.7. NË TOTAL 22% E DEPUTETËVE, “0” FJALIME NË 13 SEANCAT PLENARE
  
  7. **KLASIFIKIMI I EFIKASITETIT TË DEPUTETËVE 2019**
    - 7.1. DEPUTETËT MË EFEKTIVË: BALLA, HAJDARI, AHMETAJ DHE ROSHI
    - 7.2. DEPUTETËT MË PAK EFEKTIVË? KOKA, DOSHI...DHE 12 “PRURJE TË REJA”
    - 7.3. GRUPI “DEMOKRAT” DHE GRATË DEPUTETE MË EFEKTIVET
    - 7.4. GRUPI I PS, - KRYESONJË TË NJËJTIT, PA SURPRIZA NË RENDITJE
    - 7.5. GRUPI “DEMOKRAT”, KRYESONJË HAJDARI E MURRIZI
    - 7.6. GRUPI “I PAVARUR”, KRYESONJË GJONI DHE ROSHI
    - 7.7. DEPUTETËT PA GRUP, KRYESONJË ROSHI, STERJOVSKI DHE PËRMETI
    - 7.8. ISH GRUPI “PARTITË E DJATHTA”, TË GJITHË MIDIS 18-48 PIKËVE
    - 7.9. GRATË DEPUTETE, KRYESONJË HAJDARI, FELAJ DHE DHIMA
    - 7.10. MINISTRAT MË AKTIVË? MË PAK AKTIV JANË KRYEMINISTRI DHE ZV/KRYEMINISTRI
  
  8. **RAPORTI MIDIS “PËRFITIMEVE” FINANCIARE DHE EFIKASITETIT TË DEPUTETËVE**
    - 8.1. DEPUTETËT MË TË PAGUAR 2019, KRYESONJË DEPUTETËT E QARQEVE PERIFERIKE
    - 8.2. TRE DEPUTETËT QË KANË PËRPUTHSHMËRI MIDIS “RROGËS” DHE “EFIKASITETIT”
    - 8.3. DEPUTETËT MË EFEKTIVË NË RAPORT ME “PAGËN”, DOMINOJNË PRURJET E REJA
    - 8.4. DEPUTETËT MË “PËRFITUES”, POR MË PAK EFEKTIVË NË KUVEND?
    - 8.5. ME “0” FJALIME NË PARLAMENT? 8 NGA 20 DEPUTETËT MË TË “PAGUAR”
  
  9. **SHTOJCË 1: TABELA E PLOTË E VLERËSIMIT TË DEPUTETËVE SIPAS TREGUESVE TË AKTIVITETIT PARLAMENTAR**
- 



#### 4. HYRJE

---

Prej vitit 2017 Instituti i Studimeve Politike (ISP) vijon të bëjë monitorimin aktiv të Kuvendit të Shqipërisë dhe të veprimtarisë parlamentare të deputetëve. Projekti mbështetet nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta dhe paraqet nismën e vetme të monitorimit integral dhe profesional të jetës parlamentare në Shqipëri. ISP ka publikuar rregullisht raporte monitorimi pas çdo sesioni parlamentar. Ky është raporti i pestë dhe përmbledh periudhën shtator – dhjetor 2019. Monitorimi do të vijojë edhe gjatë sesioneve të tjera deri në shtator 2020.

Në funksion të monitorimit, transparencës dhe llogaridhënies publike ISP ka krijuar edhe platformën online të monitorimit, [www.deputetim.al](http://www.deputetim.al), ku pasqyrohen gjetjet më të rëndësishme të monitorimit, qëndrime të ISP, raporte periodike dhe historike, deklarata, fjalimet e deputetëve, të dhënat e pasurisë për deputetët, CV dhe komunikimi i qytetarëve me deputetët përmes platformës, etj. Platforma është funksionale edhe në formën e aplikacionit për çdo pajisje android.

Çdo raport monitorues sjell risi të reja. Raporti aktual bën për herë të parë korrelacionin midis të ardhurave financiare të deputetëve në aktivitetin e tyre parlamentar me nivelin e efektivitetit të tyre, duke krijuar një pasqyrë domethënëse midis privilegjeve dhe përgjegjësive që kanë deputetët. Po ashtu, në këtë raport janë analizuar edhe zhvillime të reja në parlament në kuadër të ndryshimeve që kanë ndodhur në Rregulloren e Kuvendit në korrik 2019, përfshirë seancat plenare të posaçme dedikuar zgjedhësve dhe zonave elektorale.

ISP ka krijuar tashmë një sistem klasifikimi të nivelit të efektivitetit të deputetëve, sistem që bën vlerësimin e përdorimit e të gjithë mekanizmave e mjeteve parlamentare nga ana e deputetëve, nivelin profesional si dhe të angazhimit të deputetëve në të gjitha format e aktivitetit parlamentar. Bazë e vlerësimit janë të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve, përfshirë nismat ligjore, amendamentet ligjore, nismat për interpelancë e seancë pyetjesh, kërkesat adresuar institucioneve, angazhimi me prezencë e debat në mbledhjet e komisioneve dhe në seancat plenare, pjesëmarrje në debatet publike dhe niveli i angazhimit në zonat elektorale. Raporti bën edhe monitorimin e të gjithë strukturës së Kuvendit, sidomos të programit të transparencës lidhur me aktivitetin parlamentar, si dhe verifikimin e zbatimit të Rregullores, të Kodit të Sjelljes dhe të akteve të tjera ligjore në aktivitetin parlamentar.

ISP vijon paralelisht bashkëpunimin korrekt me institucionin e Kuvendit dhe aktualisht ndjek disa problematika monitorimi që lidhen me të, - jo vetëm monitorimin e Kuvendit dhe aktivitetit parlamentar (mbështetje nga qeveria e Mbretërisë së Vendeve të Ulta), por edhe monitorimin e praktikave të Konfliktit të Interesit dhe zbatimit të Kodit të Sjelljes (mbështetje nga qeveria norvegjeze), monitorimin e problematikave të dekriminalizimit edhe pjesërisht në parlament (mbështetje nga qeveria e Mbretërisë së Vendeve të Ulta), sistemin e mbikëqyrjes parlamentare në organet e sigurisë (në partneritet me Qendra Europiane për Studime të Sigurisë/Center for European Security Studies), si dhe monitorimin e plotësimin të ligjeve përmes akteve nënligjore pjesërisht edhe në parlament (me mbështetjen e programit për Demokracinë, Zyra e Marrëdhënive Publike në Ambasadën Amerikane në Tiranë).



## 5. GJETJET KRYESORE

---

- ❖ Periudha shtator – dhjetor 2019 është karakterizuar nga aktiviteti formal parlamentar dhe kapërcimi i debatit mbi legjitimitetin. Aktiviteti parlamentar nuk ka pasur protesta apo pengesa të tjera në ushtrimin e funksioneve. Normaliteti është tregues pozitiv, por i pamjaftueshëm për pritshmëritë publike ndaj Kuvendit. Kuvendi pati vështirësi për të luajtur rolin e organit kryesor vendimmarrës dhe për të promovuar pluralizmin në përbërjen dhe vendimet e tij.
- ❖ Në vlerësimin e ISP, Kuvendi i përmbushi përgjegjësitë e tij në funksionin legjislativ, duke shqyrtuar e miratuar ligje dhe akte të tjera me rëndësi në vendimmarrjen parlamentare. Numri i akteve ligjore është më i vogël sesa e njëjta periudhë e vitit të kaluar (76 akte të miratuara më 2018 dhe 62 më 2019) dhe vetëm 5 ligje të reja u votuan në katër muaj.
- ❖ Parlamenti e përmbushi pjesërisht edhe funksionin e tij të dytë, atë zgjedhor. Ai zgjodhi disa prej funksionarëve të lartë në përgjegjësi të tij, përfshirë dy anëtarë të rinj të Gjykatës Kushtetuese dhe Prokurorin e Përgjithshëm. Vlerësimi i “pjeshëm” lidhet me faktin se parlamenti nuk arriti të marrë vendim për disa vende vakante në përgjegjësi të tij, sidomos në KD të RTSH, AIDSSH, etj. Ai gjithashtu nuk bëri përpjekje për zgjidhjen e krizës për zgjedhjen e kryetarit të KLSH. Po ashtu Kuvendi shkarkoi një anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të BSH dhe bëri disa emërimë në institucione të pavarura, shumica e të cilave përmes një procedure formale dhe të paracaktuar.
- ❖ Në ushtrimin e funksionit të tij të tretë, funksionin kontrollues, parlamenti nuk arriti ta përmbushë atë. Në tërësinë e tij Kuvendi lejoi të imponohet në aktivitetin e vendimmarrjen e tij nga pushteti ekzekutiv. Gjatë sesionit nuk pati asnjë mocion, komision hetimor dhe as seancë pyetjesh ndaj kryeministrit dhe qeverisë së tij, nuk pati ndjekje të nivelit të zbatimit të ligjeve që miratohen në parlament dhe se në disa nisma të qeverisë. Parlamenti veproi më shumë si noter institucional i saj, sesa si institucioni kryesor i përfaqësimit dhe ushtrimit të sovranitetit qytetar në Shqipëri.
- ❖ Dy nismat më të rëndësishme të kalendarit sesional të Kuvendit, Komisioni Hetimor lidhur me Presidentin e Republikës dhe Komisioni për Reformën Zgjedhore, e shtynë mandatin e tyre, duke mos arritur të kenë produkt brenda sesionit parlamentar. Nisma të tjera paralele, përfshirë paketa e ndryshimeve në legjislacionin mbi median e komunikimet elektronike apo nisma për investimet strategjike, etj, zunë vend prioritar në axhendën parlamentare dhe u votuan përmes kritikave publike vendase dhe të huaja për mungesë të mjaftueshme konsultimi dhe transparencë.
- ❖ Ky ishte sesioni i parë i zhvilluar mbi bazën e Rregullores së re të Kuvendit të ndryshuar në korrik 2019, e cila shton elementët dhe instrumentet e transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies. Java elektorale u aplikua në dy raste, por shumica e deputetëve nuk morën



pjesë në debatin për problemet e zgjedhësve të tyre. Vetëm 31% u angazhuan për zgjedhësit, një zhvillim gjithsesi pozitiv nga praktikatat e të kaluarës.

- ❖ Sessioni parlamentar shënoi një numër të lartë të akteve normative (8) në raport me vetëm 2 në të njëjtën periudhë të vitit 2018 dhe një në të njëjtën periudhë të vitit 2017. Një pjesë e akteve normative u imponuan nga situata e emergjencës e krijuar pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019, megjithatë të gjitha u ndërmorën ndërkohë që parlamenti ishte i mbledhur.
- ❖ Sessioni shtator-dhjetor shënoi edhe rënie të numrit të akteve të iniciuara nga Këshilli i Ministrave në raport me të njëjtin sesion më 2018 (52 më 2018 dhe 47 më 2019), por të njëjtin numër nismash ligjore të iniciuara nga deputetët (11 më 2018, 11 më 2019). Kuvendi miratoi tri rezoluta politike dhe zhvilloi dy interpelanca.
- ❖ Të dhënat e monitorimit treguan se rreth 60% e deputetëve të ardhur në parlament gjatë 2019 në emër të opozitës ishin votues të rregullt “pro” akteve të mazhorancës dhe nismave të qeverisë. Ky është një tregues i ndryshimit të raporteve politike në parlament dhe dobësimit të përfaqësimit opozitar. Mazhoranca fitoi mbështetjen e rregullt e 10-16 deputetëve të rinj në Kuvend, duke dobësuar përfaqësimin dhe duke krijuar mazhorancë absolute për çdo vendimarrje në interes politik të saj. Për pasojë, është rritur numri i deputetëve që nuk merr pjesë rregullisht në votimet e akteve në Kuvend dhe që ankohen se zëri i tyre nuk po dëgjohet.
- ❖ Kuvendi vijon të jetë institucioni i vetëm shtetëror që publikon online të ardhurat financiare të zyrtarëve të saj përbërës (deputetëve), një praktikë pozitive, megjithatë mungojnë ende të dhënat e përditësuara mbi stafin, raportet e vlerësimit të brendshëm, raportet vjetore, shpenzimet për aktivitetet publike, etj.
- ❖ Rreth 40% e procesverbaleve të komisioneve parlamentare nuk janë publikuar, procedurat drejt miratimit të akteve ligjore shpesh kanë mangësi në dokumentacion dhe programi i transparencës vijon të mos jetë i plotë e funksional.
- ❖ Në klasifikimin e deputetëve sipas nivelit të efikasitetit në aktivitetin parlamentar rezultoi se deputetët Taulant Balla (PS) dhe Rudina Hajdari (DEM) janë deputetët më të kuotuar. Gjatë këtij sessioni pati rritje të ndjeshme të aktivitetit të deputetëve të rinj në përpjekje për të krijuar një identitet e bilanc publik të aktivitetit të tyre parlamentar. Pjesa më e madhe e prurjeve nga biznesi vijoi të jetë jo aktive në aktivitetet parlamentare.
- ❖ Stafi i ISP paraqet në këtë raport për herë të parë korrelacionin midis deputetëve me më shumë përfitime financiare dhe nivelit të efektivitetit të tyre në parlament. Krahasimi tregoi se në tërësi, deputetët më të “mirë-paguar” në parlament kanë nivele kritike të efikasitetit dhe produktit parlamentar. Vetëm 3 deputetë (2 të PS dhe 1 nga opozita) kanë përputhshmëri midis dy komponentëve.





- ❖ Komisionet e Përhershme dhe të Posaçme përballen me riskun e aktivitetit formal në funksionimin e tyre. Më pak se një e treta e deputetëve është aktive në debatet në komisione. Drejtimi i tyre shpesh është i personalizuar dhe vendimmarrja e paracaktuar.
- ❖ Gratë deputete rezultuan shumë më efektive në aktivitetin parlamentar sesa deputetët meshkuj. Në total gratë deputete patën mesatarisht 2% më shumë nivel vlerësimi gjatë sesionit parlamentar. Ato ishin më aktive në ushtrimin e përgjegjësive parlamentare, në fjalime dhe në debatet në komisione.
- ❖ Ligjërimi politik ka ndryshuar pozitivisht në aspektin formal. Çështjet dominuese në fjalimet e deputetëve ishin ato mbi buxhetin e paketën fiskale, reformën në drejtësi dhe rininë, procesin e integritetit dhe problematikat zonale. Në aspektin e brendësisë deputetët shfaqin nevojën e trajnimeve të vazhdueshme, asistimit nga ekspertët dhe përgatitjes më të mirë për debatet në parlament dhe të gjithë procesin ligjvënës. ISP ka vlerësuar edhe me parë nevojën për më shumë staf mbështetës në parlament për deputetët e grupet, sidomos për teknikën legjislativë.
- ❖ Në total vetëm 6 deputetë të PS patën votë ndryshe nga grupi dhe vetëm dy prej tyre (D. Bushati dhe F. Xhafaj) e shprehën opinionin publikisht. Tri grupet parlamentare nuk kanë miratuar ende Rregulloret e tyre të brendshme si detyrim nga Rregullorja e Kuvendit.

### 2.1. REKOMANDIMET KRYESORE

---

- ❖ Kuvendi mund dhe duhet të fokusohet në jetësimin e plotë të standardeve të përcaktuara në Rregulloren e Re të Kuvendit të miratuar në korrik 2019, sidomos në lidhje me komponentët e transparencës dhe të llogaridhënies.
- ❖ Kuvendi mund dhe duhet të krijojë një sistem transparent deklarimi, verifikimi dhe publikimi të praktikave të konfliktit të interesit, të deklarimit të dhuratave dhe elementët e tjerë të Kodit të Sjelljes, në mënyrë që të rrisë standardet e integritetit dhe besueshmërisë.
- ❖ Kuvendi mund dhe duhet të hetojë çdo rast të raportuar të shkeljes së ligjit, procedurës, Kodit të Sjelljes, por edhe të akuzave për presione e lobing të parregullt, që adresohen nga grupe monitoruese, nga vetë deputetë të caktuar apo nga media. Ai duhet të krijojë një sistem më efikas monitorimi të brendshëm të aktivitetit parlamentar, për të evituar praktikat abuzive në funksionimin e komisioneve, praktikat formale të vlerësimit të projekt-akteve, dhe për të rritur transparencën publike ndaj risive të akteve, ndaj ndryshimeve, ndaj impaktit dhe ndaj raportit të secilit deputet me to.
- ❖ Kuvendi mund dhe duhet të krijojë hapësirë/kushte për më shumë konkurrueshmëri për kandidatët për poste të ndryshme që zgjidhen nga Kuvendi, të përmbushë në kohë detyrimet ligjore për zgjedhjen e zyrtarëve në përgjegjësinë e tij dhe të investohet në rritjen e besimit publik tek koncepti i garës së papërcaktuar paraprakisht në vendimmarrjet e tij.



- ❖ Kuvendi mund e duhet të korrektojë rastet kur ka tendenca njësimi midis pushteteve, deputetit dhe institucioneve partiake, politike e shtetërore. Ai mund të investohet më shumë në përmbushjen e funksionit të tij kontrollues ndaj ekzekutivit, si dhe në rritjen e efikasitetit të institucioneve të pavarura në varësi të tij. Mekanizmi i ndjekjes së jetësimit të plotë të ligjeve që miraton mund e duhet të jetë përgjegjësi e Kuvendit.
- ❖ Kuvendi mund e duhet të reformojë sistemin e konsultimit publik me shoqërinë civile, grupet e interesit, partnerët dhe aktorët e tjerë, në mënyrë që procesi i konsultimeve të jetë dobiprurës për rritjen e standardeve të ligjeve dhe të aktivitetit parlamentar.
- ❖ Grupet parlamentare mund e duhen të bëhen struktura më demokratike në vendimmarrje dhe funksionim, të kenë më shumë staf mbështetës, të ofrojnë trajnime dhe kualifikime për deputetët, të reflektojnë mbi kritikën dhe të përmirësojnë aktivitetin e tyre, si dhe të krijojnë një sistem efektiv dhe publik vlerësimi për deputetët brenda grupit.
- ❖ Kuvendi mund e duhet të bëjë ndryshime cilësore në faqen online dhe në adresimet e tjera online, në mënyrë që media e qytetarët e interesuar të kenë në çdo kohë informacionet e duhura mbi agjendën, aktivitetet, procesverbalet e plota, mbi emërtesat, nismat, projektet, raportet monitoruese, dhe të dhënat e detajuara mbi strukturat e reja të ngritura në kuadër të reformës në drejtësi



## 6. SESION I DOMINUAR NGA PËRQËNDRIMI I PUSHTETIT

Sesioni parlamentar shtator-dhjetor 2019 mbyll vitin e dytë të legjislaturës aktuale, por edhe vitin e parë të situatës unike të krijuar pas dorëzimit kolektiv të mandateve nga dy partitë e opozitës PD e LSI. Zhvillimet e vitit 2019 treguan se ky vendim ishte shumëfish i gabuar dhe me pasoja për vetë opozitën, jetën politike e institucionale dhe nivelin e demokracisë në vend. Zgjedhjet jo konkurruese të qershorit 2019 ishin një shans i humbur për rikthimin e politikës në institucione dhe se prej shtatorit 2019, jeta politike vijon të jetë dukshëm e njëanshme, produkt vetëm i mazhorancës.

Një nga tiparet e dukshme të kronikës politike të katër muajve të fundit është njësimi i deputetëve të mazhorancës me funksionet shtetërore në pushtetin qendror dhe lokal. Monitoruesit kanë evidentuar raste të shumta kur deputetët drejtonin inaugurimin e veprave publike në nivel lokal e qendror, drejtonin mbledhje të strukturave të bashkive, marrin pjesë e flasin nga pozita drejtuese në mbledhjet e këshillave bashkiakë, drejtonin operacione të emergjencës dhe të koordinimit edhe me institucione, të cilat janë përgjegjëse përpara ligjit ose janë institucione të pavarura nga politike, etj. Një vëzhgim i thjeshtë në debatet parlamentare, sidomos ato që lidhen me menaxhimin e situatës post tërmet në shtator, nxjerrin në pah mbivendosjen e pushteteve, siç edhe një vëzhgim në listën e aktiviteteve publike të deputetëve në faqen zyrtare të Kuvendit si dhe publikimin e aktiviteteve vetëm të një pale politike. Mungesa e kujdesit për të bërë ndarje të qartë midis mandatit dhe aktivitetit partiak me atë shtetëror dhe për të miksuar pushtetet në varësi nga hierarkia partiake në mazhorancë, përbën një zhvillim negativ dhe një prej pasojave të tjera të mungesës së opozitës së organizuar në jetën institucionale qendrore e lokale.

Nga ana tjetër, rreth 40 deputetë të ardhur rishtas në parlament gjatë sesionit të parë të vitit 2019 nuk kanë ende një identifikim të përbashkët opozitar, ata përfaqësojnë flukse e interesa të ndryshme, nuk kanë krijuar ende grupime politike dhe për rrjedhojë nuk kanë arritur ta zëvendësojnë nevojën e madhe të një sistemi demokratik pluralist për opozitë alternative dhe monitoruese të mazhorancës.

### 6.1. KUVENDI, MË SHUMË AKTE NORMATIVE SESA LIGJE TË PLOTA NË 4 MUAJ

Referuar vendimmarrjes legjislative Kuvendi kaloi më shumë se 60 akte, një pjesë e të cilave rezoluta dhe vendime. Midis tyre ishin 5 ligje të plota, 3 rezoluta, 4 vendime të rëndësishme dhe 18 amendime ligjore në ligje të tjera të miratuara më përpara.

Të ndara sipas periudhave mujore, periudha më e pasur për vendime ishte muaji dhjetor me rreth 46% të akteve të miratuara pavarësisht se dhjetori është muaji i debatit mbi buxhetin e ri shtetëror dhe si e tillë ka pasur vetëm dy seanca plenare.


#### NË 4 MUAJ VETËM 5 LIGJE TË PLOTA

*Parlamenti ka miratuar akte të shumta gjatë sesionit shtator-dhjetor 2019, por në thelb, ligje të reja (jo amendime) ka miratuar vetëm 5, në total 1 ligj në 25 ditë*

1. Projektligji “Për rininë”
2. Projektligji “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”
3. Projektligji “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”
4. Projektligji “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”
5. Projektligji “Për rivlerësimin e pasurisë së paluaitshme”



- Vetëm në seancën e fundit të Kuvendit, më 18 dhjetor ishin në axhendën parlamentare miratimi i 22 akteve ligjore (ligje, amendime ligjore, vendime për zgjedhje, etj).
- Muaji më me pak vendimmarrje legislative është muaji shtator, me vetëm 12% të totalit, megjithatë data 12 shtator mban rekordin e një seance plenare në të cilën Kuvendi rrëzon së paku 8 dekrete të Presidentit të Republikës, përfshirë atë për zgjedhjen e kryetarit të KLSH.



Kushtetuta e Shqipërisë, neni 101, përcakton se “*Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mblidhet brenda 5 ditëve, nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve*”.

Gjatë sesionit shtator-dhjetor 2019 Kuvendi ka qenë gjithë periudhën “i mbledhur” ose në mundësi të plota të zhvillimit të mbledhjeve, megjithatë qeveria ka aplikuar shifrën rekord të akteve normative, 8 akte në katër muaj. Konkretisht, në nëntor u miratuan dy akte normative që lidheshin me ndryshimet në buxhetin e shtetit dhe një ndryshim në taksat vendore. Në dhjetor kemi shifra rekord me 6 akte normative, - një akt për ndryshime në tatimin e vlerës së shtuar, një mbi ndryshime në tatimin mbi të ardhurat, si dhe katër akte që lidheshin me pasojat e gjendjes së emergjencave natyrore të krijuara pas tërmetit të datës 26.11.2019.

### 6.1.1. NISMAT KRYESORE SHTYHEN PËR SESIONIN E RI PARLAMENTAR

Parlamenti pati dy nisma prioritare në kalendarin e punimeve të tij në shtator 2019: nisma e grupit parlamentar të PS për hetimin e veprimeve të Presidentit të Republikës lidhur me anulimin e datës së zgjedhjeve lokale dhe nisma për reformën zgjedhore përmes Komisionit të Posaqëm parlamentar. Në dhjetor 2019, të dy nismat nuk u finalizuan, përkundrazi, të dy komisionet kërkuan shtyrje të afateve të punës për tremujorin e ri të vitit 2020.

Vendimi më i rëndësishëm ishte ai për shtyrjen e afatit për Komisionin Hetimor ndaj Presidentit. Vendimi i datës 3 dhjetor e shtyn afatin për katër muaj, duke e çuar në më shumë se tetë muaj mandatin e Komisionit. Shtyrja erdhi për shkak të debateve që u krijuan pas vendimit të Presidentit për të dekretuar një anëtar tjetër të Gjykatës Kushtetuese nga lista me tre emra të miratuar nga KED dhe adresimi i konfliktit të ri tek Komisioni i Venecias. Në objektin shtesë të Komisionit Hetimor, - një prej rasteve të rralla në 30 vjet parlament ku Komisioni ndryshon në thelb objektin dhe lëndën e hetimit, - mazhoranca vlerësoi se “*duke vërejtur se shkelja e Kushtetutës nga ana e Presidentit të Republikës tashmë është bërë kronike, përmes kësaj kërkesë vlerësojmë se edhe veprimet e mosveprimet e tij të*

*fundit duhet të bëhen pjesë e vlerësimit nga Komisioni Hetimor i ngritur për këtë qëllim, në mënyrë që edhe vendimmarrja vijuese e Kuvendit të jetë sa më serioze dhe e bazuar”.*

Në dhjetor mazhoranca mori dy nisma ligjore për ndryshimin e praktikës kushtetuese e ligjore të aktit të betimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese tek Presidentit i Republikës, duke ia kaluar kompetencat akteve individuale dhe alternative të betimit. Nisma është e motivuar politikisht dhe e inspiruar në zhvillimet afatshkurtra, pasi në thelb, përveç ushqimit të krizës kushtetuese dhe institucionale, nuk ofron zgjidhje të qëndrueshme, pasi në asnjë vend demokratik nuk mund të ndodh që një zyrtar të bëjë betimin personalisht dhe ky akt personale të konsiderohet si akt zyrtar, ligjor dhe Kushtetues.

### 6.1.2. NISMAT LIGJORE TË DEPUTETËVE NË TRE KATEGORI

Në fillim të muajit shtator disa deputetë nisën të depozitojnë nisma ligjore. Janë tri kategori të nismave ligjore të propozuara në këtë sesion:

- kategoria e parë, nisma formale ligjore që lidhen me shpallje datash historike ose ditë pushimi;
- kategoria e dytë, nisma ligjore që lidhen me amendime ligjore ose përgjigje ndaj shqetësimit të grupeve të ndryshme sociale,
- si dhe kategoria e tretë, nisma politike kryesisht nga mazhoranca që i ngarkohen si nisma personale deputetëve të caktuar të saj.

Në thelb, nisma të vërteta ligjore morën vetëm një numër i kufizuar deputetësh (A. Ahmetaj, I. Beqaj, M. Murrizi), për çështje si rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme, ndryshime në legjislacionin për mbrojtjen e shëndetit apo faljen e gjobave të dhëna nga AKU, si dhe nisma për ndryshim të sistemit zgjedhor apo kufizime ligjore mbi bazën e funksioneve të së kaluarës për promovimin në poste publike e shtetërore. Kategoria tjetër e nismave politike u është besuar kryesisht deputetëve A. Shameti, A. Hyseni, E. Leka, etj, nga mazhoranca, si dhe një numri të madh deputetësh së bashku nga deputetët e rinj në parlament. Kategoria e nismave formale dhe ceremoniale, përfshin deputetët M. Murrizi e V. Sterjovski, etj.

### 6.1.3. PROBLEMATIKAT INSTITUCIONALE E TEKNIKE ME NISMAT LIGJORE

Gjatë sesionit ka pasur së paku tre raste kur janë konstatuar problematika lidhur me praktikën e ndjekur në hartimin dhe paraqitjen e nismave ligjore në Kuvend. Në një rast çështja u trajtua në Konferencën e Kryetarëve. Në mbledhjen e konferencës së kryetarëve më 17 shtator, drejtuesi i Kuvendit theksoi se nismat dhe relacionet e KM duhet të respektojnë rigorozisht kërkesat e nenit 68, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, *“pasi në shumë raste ka mjaft projektligje që vijnë në Kuvend jo sipas kërkesave të përcaktuara nga Rregullorja dhe këtu kam parasysh, në radhë të parë, pjesën e konsultimit me publikun”*. Sipas tij, tabela e konsultimit me publikun në shumicën e rasteve mungon në të gjitha relacionet e projektligjeve megjithëse është e detyrueshme për një kategori jo të vogël projektligjesh.

Gjithashtu mungojnë raportet e vlerësimit të ndikimit, që është i detyrueshëm, sipas Rregullores së Këshillit të Ministrave, etj. Kryetari i Kuvendit theksoi<sup>1</sup> se janë *“vënë re mospërputhje të tekstit të relacionit me projektligjin; mangësi në shpjegimin e disa risive që sjell projektligji e që në relacion nuk përmendet fare; mangësi në shpjegimin e efekteve sociale dhe ekonomike që ka ai projektligj për një*

<sup>1</sup> Mbledhja e Konferencës së Kryetarëve, 17.09.2019.



*komunitet të caktuar për efektet mjedisore e të tjera, për të mos përmendur këtu edhe mangësitë në tekstet e marrëveshjeve ku tabela e përputhshmërisë, apo anekse dhe shtojca të tyre mungojnë” dhe raste kur marrëveshjet nuk janë të vërtetuara paraprakisht nga Ministria e Drejtësisë.*

Në një rast tjetër, më 16 shtator në Komisionin e Ekonomisë kryetari i Komisionit i tërhoqi vëmendjen zv/ministrit pasi drafti i sjellë në komision/kuvend për ndryshim nuk ishte firmosur nga Ministria përkatëse, ndaj nuk plotësonte kushtet procedurale dhe të protokollit për t’u marrë në konsideratë. Nisma për të cilën flitet është projektligji “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” e iniciuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në një rast të tretë disa deputetë publikuan në mediat sociale dhe profilet e tyre publike nismën ligjore “Për përjashtimin nga emërimi, zgjedhja në organe drejtuese dhe punësimi në funksione publike, shtetërore dhe politike të ish – funksionarëve, nëpunësve që kanë ushtruar detyra drejtuese në periudhën 28.11.1944 e deri në 8.12.1990”. Kjo e fundit dominohej nga gabimet drejtshkrimore dhe injorim të standardeve formale në paraqitjen e një drafti ligjor. Pas reagimit të ISP autorët e draftit ndryshuan formën dhe përmbajtjen si dhe e parashtruan në Kuvend, duke eliminuar pjesën më të madhe të mangësive, por jo të gjitha. Nëse në dy rastet e para kemi të bëjmë me problematika institucionale, kurse në rastin e tretë kemi të bëjmë me mangësi në teknikën parlamentare dhe në burimet njerëzore në dispozicion të deputetëve/grupeve parlamentare.

## 6.2. PD DHE LSI, NDRYSHIM KURSI NDAJ PARLAMENTIT

Në shtator PD dhe LSI iu bashkuan tryezës së iniciuar nga OSBE për reformën zgjedhore, duke sjellë një ndryshim të ri politik. Rikthimi i pjesshëm i opozitës në institucione nuk u shoqërua me pranimin prej saj të legjitimitetit të Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore. Puna paralele për reformën zgjedhore (parlamenti në Komision dhe opozita në një Komision tjetër jashtë parlamentar) në thelb e pranon legjitimitetin e parlamentit dhe të drejtën e tij për të votuar çdo propozim që vjen për reformën zgjedhore, përfshirë edhe propozimet që PD e LSI do të duhet të sjellin. Pra indirekt opozita jashtë parlamentit e pranoi kompetencën parlamentare dhe legjitimitetin e tij, duke kontestuar vetëm drejtuesit e Komisionit të Posaçëm.

Nga shtatori në dhjetor nuk pati protesta nga opozita dhe për më tepër u regjistruan një numër minimal konferencash shtypi apo adresime kritike të opozitës ndaj parlamentit dhe aktivitetit të tij. Përqendrimi tek reforma zgjedhore dhe reforma në drejtësi e zhvendosën retorikën ndaj parlamentit, duke i krijuar kushte komode parlamentit të veprojnë sipas axhendës së tij. Në dhjetor opozita iu rikthye axhendës parlamentare duke organizuar paralelisht me seancën plenare tryeza pune jashtë parlamentit në lidhje me paketën anti shpifje.

Pjesëmarrja në tryezën e Komisionit për Reformën Zgjedhore, ndalimi i protestave, fokusimi së fundi i debatit politik në axhendën parlamentare, pranimi i vendimeve të parlamentit aktual (për shembull, në zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm), si dhe ndalimi i fushatës denigruese ndaj deputetëve të opozitës që pranuan mandatet parlamentare janë disa nga treguesit pozitiv në sjelljen e opozitës aktuale në raport me parlamentin. Pavarësisht se opozita jashtë parlamentare nuk është e nuk mund të jetë më edhe teorikisht pjesë e parlamentit, për shkak të vendimit të saj të gabuar në shkurt 2019, fakti është e mbetet se sesioni i vjeshtës ndryshoi kursin politik dhe kriza politike e pranverës dhe e verës u arkivua për t’u rikthyer ndofta në muajt e vitit 2020.



### 6.3. GRUPET PARLAMENTARE: NJË SHKRIHET, NJË HYN NË KONFLIKT

---

Më 5 dhjetor kryetari i Kuvendit njoftoi seancën se “*Grupi Parlamentar i Partive të Djathta pushon së ekzistuari, pasi numri i anëtarëve ka rënë nën minimumin e parashikuar në pikën 6 të nenit 15 të Rregullores, si pasojë e largimit nga ky grup i 4 deputetëve*”. Midis deputetëve që u larguan nga grupi dhe drejtuesit të grupit pati replika të ashpra në mediat sociale, të dominuar nga retorikë fyese dhe denigruese.

Nga ana tjetër, në fillim të tetorit një situatë tjetër problematike u krijua në Grupin “Demokrat”. Fillimisht përmes mediave sociale deputeti Korab Lita lajmëroi se është zgjedhur kryetar i Grupit në vend të deputetes Rudina Hajdari, por pak orë më vonë kjo e fundit e përgënjeshtroi lajmin. Në dy rastet dy palët publikuan firma deputetësh mbështetës, por siç rezultoi më vonë disa prej tyre kishin firmosur nën presion ose nuk ishin nënshkrime të sakta. Kryetarja e Grupit “Demokrat” akuzoi rivalët e saj për ushtrim dhune dhe akte antiligjore, për çfarë i kërkoi Kuvendit dhe organeve përkatëse hetime dhe penalizim sipas Rregullores dhe Ligjit. Kërkesa e saj nuk u trajtua nga Kuvendi sipas praktikave të mira parlamentare.

Më 17 tetor kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi informoi seancën plenare se “së pari, më ka ardhur një kërkesë ose njoftim për ndryshime në drejtimin e Grupit Parlamentar Demokrat, ku kërkohet të deklarohet si kryetar grupi deputeti Korab Lita. Së dyti, nga deputetë të tjerë të po këtij grupi parlamentar, si deputeti Halit Valteri dhe Fatjona Dhimitri, më ka ardhur një shkresë, të cilët më vënë në dijeni se ky vendim nuk është marrë. Deputeti Murrizi dhe zonja Hajdari konfirmojnë të njëjtën gjë. Së treti, kam pesë kërkesa nga deputetët Ligoraq Karamelo, Majlinda Halili, Krenar Rryçi, Elda Hoti dhe Vasil Sterjovski, të cilët deklarojnë pjesëmarrjen e tyre në Grupin Parlamentar Demokrat”.

Në të njëjtin debat u sugjerua detyrimi me Rregulloren e Re të Kuvendit për secilin grup parlamentar që të hartojë e miratojë Rregulloren e funksionimit të grupit, si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve brenda grupeve në respekt të procedurës parlamentare. Debati vijoi edhe në seancën pasuese në tetor 2019, në të cilën kryetari i Kuvendit informoi se lidhur me deklaratimet për kërcënime ndaj deputetes Hajdari ka informuar MPB për ta ndjekur atë sipas ligjit. Deri në fundin e dhjetorit 2019 nuk pati më zhvillime të reja në këtë grup, ndërkohë që në faqen e Kuvendit zonja R.Hajdari vijon të jetë drejtuese e Grupit, ndërkohë që pesë deputetët që bënë kërkesë për bashkimin me të në tetor ende figurojnë si deputetë pa grup parlamentar.

### 6.4. PARADOKSI: MAZHORANCA “ZGJEROHET” ME 10-16 DEPUTETË TË OPOZITËS

---

Partia Socialiste fitoi zgjedhjet më 2013 me 74 deputetë. Gjatë sesioneve parlamentare 2018 PS humbi një deputet (Gj.Gjetani) dhe mori një deputet (R.Bitri). Në total PS do të duhej të kishte 74 deputetë, pavarësisht se dy deputetë, R.Lala dhe D.Bici të zgjedhur në emër të PDIU deklaruan publikisht se duan t’i bashkohen PS në mazhorancë.

Në faqen zyrtare të PS dhe të Kuvendit PS ka 74 deputetë. Megjithatë, një analizë e votës parlamentare shtator-dhjetor 2019 rezulton se edhe në votimet politike në parlament, në të cilat ka pasur debate e kundërshti të shumta, mazhoranca ka ruajtur një kuotë votash të qëndrueshme prej 84-90 deputetësh, pra rreth 10-16 deputetë më shumë, sesa vota elektorale e vitit 2013.



Konkretisht, Kuvendi miratoi me 82 vota edhe paktën ligjore “anti-shpifje”, nismë e kritikuar gjerësisht nga shoqëria civile, media dhe organizatat ndërkombëtare. Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil kandidatura e mbështetur nga 28 deputetë të PS-së fitoi me 95 vota pro, pra 21 vota më shumë, sesa numri total i deputetëve të PS në parlament ose 21 deputetë të “opozitës” mbështetën kandidaturën e PS. Për zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm kërkohen 84 vota, megjithatë kandidati i parë në listë, Olsian Çela siguroi 101 vota pro, 17 më shumë sesa numri minimal i votave që i duhej ose 27 vota nga deputetët jashtë grupit parlamentar të PS. Edhe në zgjedhjen e dy anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese PS siguroi përveç votave të saj edhe 31 vota të tjera nga deputetë të ardhur rishtas në parlament gjatë sesionit të kaluar parlamentar. Po ashtu në votimin për buxhetin 2020, pro buxhetit të qeverisë votuan 92 deputetë nga 74 që ka PS, pra 18 deputetë më shumë sesa mazhoranca. Edhe në votimin e aktit normativ për buxhetin më 4 nëntor PS mori 9 vota më shumë sesa numri total i deputetëve të saj, pra 83 vota.

### 6.5. VOTIMET NË KUVEND ME DOKUMENTACION ITALISHT?

Më 5 dhjetor kryetari i Kuvendit njoftoi se është shkrië Grupi i Djathtë parlamentar, megjithatë në dokumentet zyrtare të seancës, përfshirë edhe në votimin e rezolutës “Për ndërhyrjet e huaja në proceset zgjedhore dhe dezinformimit në proceset demokratike kombëtare” figuron Grupi i djathtë dhe ish deputetët e këtij grupimi paraqiten ende si grup. Ndonëse detaj teknik, problematika me dokumentacionin e rregullt është detyrim ligjor dhe përbën një prej motiveve për kontestimin e vendimeve të ndryshme të Kuvendit.

```

DIAGNOSTICA TERMINALI

      01      02      03      04      05      06      07      08      09      10
000|050 VOT|043 VOT|070 VOT|130 EAB|143 EAB|139 EAB|... ..|018 VOT|151 VOT|036 VOT|
010|132 EAB|125 EAB|041 VOT|... ..|144 EAB|142 VOT|027 VOT|... ..|... ..|... ..|
020|... ..|... ..|... ..|... ..|147 EAB|... ..|116 VOT|057 VOT|001 VOT|003 VOT|089 VOT|
030|039 VOT|068 ...|062 ...|005 VOT|100 VOT|124 VOT|059 VOT|047 VOT|129 VOT|120 VOT|
040|... ..|096 VOT|007 VOT|023 VOT|013 VOT|037 ...|064 VOT|... ..|079 VOT|080 VOT|
050|008 VOT|026 VOT|111 VOT|131 VOT|004 VOT|051 VOT|110 VOT|152 VOT|153 VOT|154 VOT|
060|158 VOT|015 VOT|030 VOT|... ..|025 VOT|038 VOT|... ..|034 VOT|006 VOT|024 VOT|
070|061 VOT|022 VOT|099 VOT|085 VOT|065 VOT|106 VOT|058 VOT|086 VOT|053 VOT|045 VOT|

STATI :   Tess. Abil.:114   Tess. Non Abil.:0   Err Tess.:0   Err NR:0

LEGENDA
...=Mungon/Pa kartë          PO.=Po          JO.=Jo          ABS=Abstenim
VOT=Votues (Sekret)         PRE=Prezent(Prezenka)  NVT=Jo pjesëmarrës  ECP=Karta e vendosur gab:
*P=Err. Tipo tessera       ELE=Gabim në lexim tessera  ELG=Gabim Legjislature  EFW=Gabim Firmware
*Terminale Nuk pëgjigjet   EAB=Tessera Kartë e pa aktivizuar  EPO=Vend i Gabuar      ___=E pa instaluar

```

I tillë vijon të jetë edhe aplikimi në gjuhën italiane të emërimit për grupet e deputetëve dhe disa procedurave teknike në votimet elektronike, ndërkohë që Kuvendi ka detyrimin kushtetues e ligjor të operojë vetëm me gjuhën shqip. Argumenti i zyrtarëve të Kuvendit se gjuha italiane vijon të jetë e mbetur për shkak të programimit është i paqëndrueshëm për sa kohë është një detyrim ligjor dhe Kuvendi ka të gjithë kapacitetet dhe mundësitë të respektojë gjuhën shqipe në komunikimet dhe vendimet e tij zyrtare e publike.





### 6.5.1. PAKETA “ANTI SHPIFJE”, GJASHTË VLERËSIME KRITIKE

---

Më 18 dhjetor 2019 Kuvendi kaloi në seancë paketën e njohur me emrin “anti-shpifje”, një nismë e qeverisë për ndryshime në legjislacionin për median, konkretisht ndryshime në ligjin 97/2013 për median audio-vizive dhe ndryshime në ligjin 9918/2008 për komunikimet elektronike.

Nismat ligjore shkaktuan reagime e protesta nga media dhe shoqëria civile, si dhe nga disa institucione ndërkombëtare. Për herë të parë pothuajse të gjitha grupimet mediatike e civile ishin kundër një akti të mazhorancës, megjithatë kjo e fundit, edhe pse zhvilloi disa seanca dëgjimore, përdori shumicën në parlament për kalimin e dy nismave. Në seancën plenare Kryeministri përdori gjuhë të ashpër kundër kritikëve dhe etiketoi çdo mendim kundër, duke e konsideruar nismën e tij si akt politik dhe votën pro saj si pjesë të axhendës politike.

Kalimi i dy nismave pati disa problematika ligjore, procedurale dhe politike.

- E para, drafti i kaluar në komisionet përkatëse në parlament u prezantua në faqen zyrtare të Kuvendit vetëm pak orë përpara kalimit në seancën plenare, duke kufizuar ndjeshëm mundësinë e reagimit të ekspertëve dhe zërave nga grupet e interesit. I gjithë procesi u bë aq i shpejtuar, sa një numër deputetësh e zyrtarësh të lartë, të painformuar, por të motivuar politikisht, vijonin të mbronin ndryshime të cilat *de facto* ishin rrëzuar në negociatat e mesnatës së 16-17 dhjetorit 2019 midis qeverisë dhe faktorëve ndërkombëtarë.
- E dyta, krahas draftit të komisionit gjithashtu në orët e pasdites së datës 17.12.2019 u publikua edhe një nismë ligjore paralele e kryetarit të grupit parlamentar të PS T. Balla, për ndryshime thelbësore në draft. Këto të fundit nuk kishin qenë pjesë e seancave dëgjimore dhe as e konsultimeve me grupet e interesit, dhe për pasojë, u përfshinë në draftin final pa konsultim publik.
- E treta, asnjë prej materialeve kritike dhe alternative, përfshirë mendimet e pakicës në parlament apo të grupeve të interesit, apo deklarime e sugjerime të organizmave ndërkombëtarë adresuar Kuvendit nuk u publikuan as në faqen zyrtare të Kuvendit dhe as nuk u morën në konsideratë në debatin dhe votimin në seancën plenare.
- E katërta, ishte hera e parë që të gjitha grupet e interesit ishin kritike me mazhorancën dhe fakti se kjo e fundit nuk ndryshoi qëndrim, e bën të parëndësishëm të gjithë bilancin dhe premtimin e procesit të konsultimit të parlamentit me shoqërinë civile, të promovuar për muaj e vite me radhë.
- E pesta, relatorë e mbështetës politikë të nismës më të kritikuar parlamentare të vitit 2019 u bënë disa deputetë, të cilët në CV e tyre kanë një të kaluar të pasur në shoqërinë civile dhe jetën akademike. Ky është një prej rasteve që tregon se prurjet në politikë nga sektorë të tillë nuk sjellin domosdoshmërisht cilësi dhe një kulturë të re në jetën parlamentare.
- Së fundi, nisma u shoqërua me kritika nga një numër i madh aktorësh ndërkombëtarë, u kontestua nga gjysma e anëtarëve të AMA dhe institucionet vendore që promovojnë të drejtat e njeriut, si dhe pritet të jetë element shtesë në monitorimin dhe kërkesat ndaj Shqipërisë gjatë 2020.



### 6.5.2. PROKURORI I PËRGJITHSHËM, DY PROBLEME TEKNIKE TË VOTIMIT

---

Me rastin e zgjedhjes së Prokurorit të Përgjithshëm, stafi i ISP konstatoi se ka parregullsi në deklarimin e pjesëmarrjes në votim. Përmes një shënimi në rrjetet sociale ISP vuri në dukje se në momentin e votimit kryetari i seancës njoftoi se janë të pranishëm në sallë 113 deputetë. Referuar të dhënave të tabelës së votave për dy kandidatët e parë konfirmohet se numri total i votave është 113, por për kandidaten e tretë, F.Memçaj rezulton se ka pasur prezent 114 deputetë, pra 1 deputet më shumë sesa në dy votimet e para dhe sesa vetë kryetari i seancës konfirmoi. Konkretisht në votimin e saj, siç u pasqyrua edhe në tabelën finale, pati 8 vota pro, 16 kundër, 87 abstenime dhe 3 deputetë që nuk morën pjesë në votim, në total 114 deputetë nga 113 prezent.

Në vijim të këtij rasti nga të dhënat e Kuvendit rezultoi se deputeti A.Alimadhi është emri i 114, i cili është regjistruar, por nuk ka marrë pjesë në votimin për kandidaten Memçaj, ndërsa rezulton se ka munguar në votimin e dy kandidatëve të tjerë. Stafi kontaktoi me deputetin, i cili me korrektesë u përgjigj se nuk ka marrë pjesë në procedurën e votimit për asnjë nga kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm. ISP i kërkoi Kuvendit përmes të drejtës së informimit një sqarim për këtë rast, përgjigje e cila ende nuk ka ardhur. Në raste të tilla kur ka paqartësi Kuvendi do të duhej të sqaronte problematikën, nëse kemi të bëjmë me një problem teknik, nëse individi është paraqitur vetëm me kartë në votimin e tretë, i cili korrespondon me votimin me 114 deputetë apo nëse ka vlerësim tjetër.

Një problematikë tjetër që meriton rishikim në praktikën e punës së Kuvendit ka të bëjë me rastet e votimit të kandidatëve alternativë. Sipas praktikës secili kandidat votohet më vete dhe në përfundim fiton kandidati më me shumë vota pro, sipas rastit kur kërkohet shumicë e thjeshtë apo e kualifikuar. Por praktika të tilla krijojnë rrethana që një deputet të mund të votojë pro për më shumë se një kandidaturë, siç ndodhi në rastin e Prokurorit të Përgjithshëm. Në total rezulton se 19 deputetë kanë votuar pro për më shumë se një kandidat për Prokuror të Përgjithshëm. Nëse do të kishte vetëm një votim me tre emrat, për të nxjerrë fituesin nuk do të kishte hapësirë të votimit të dyfishtë pro apo kundër dhe kandidati fitues do të ishte më i qartë.

### 6.6. GJASHTË DEPUTETËT “REBELË” NË PS, KRYESJNË BUSHATI E XHAFJA

---

Në total mazhoranca vijon të votojë në mënyrë kolektive pro nismave të qeverisë dhe vendimeve politike të grupit. Rastet përjashtimore janë të rralla. Konkretisht, ligji me më shumë “devijime” në votën politike “kundër” të grupit të PS është nisma ligjore e deputetit I.Beqaj, për faljen e gjobave të vendosura nga AKU. Për këtë nismë PS votoi kundër, deputeti Beqaj votoi “pro”, si dhe tre deputetë të PS, D.Bushati, V.Hysi dhe A.Xhembulla vendosën të abstenojnë. Deputeti Bushati ka abstenuar edhe në dy votimet politike të iniciuara nga kryeministri Rama, të njohur si paketa anti-shpifje, konkretisht ligji për mediat audio-vizive dhe ai për komunikimet elektronike në RSH.

Votë tjetër ndryshe nga grupi ishte vota abstenuese në dy raste e deputetit F. Xhafaj, e para për rrëzimin e dekretit të Presidentit lidhur me kthimin e ligjit për Akademinë e Shkencave dhe e dyta për nismën ligjore të kryeministrit E.Rama “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”. Po ashtu deputetja B.Gjylameti votoi ndryshe nga grupi, me votë abstenuese për projektligjin “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”



DEPUTETËT E PS ME VOTË “NDRYSHJE” NGA GRUPI POLITIK		
DEPUTETËT	GRUPI	ABSTENIM/KUNDËR
DITMIR BUSHATI	PS	3 VOTA ABSTENIM
FATMIR XHAFAJ	PS	2 VOTA ABSTENIM
BLERINA GJYLAMETI	PS	1 VOTË ABSTENIM
ALMIRA XHEMBULLA	PS	1 VOTË ABSTENIM
VASILIKA HYSI	PS	1 VOTË ABSTENIM
ILIR BEQAJ	PS	1 VOTË KUNDËR

Vlen të theksohet një diskutim ndryshe në seancën dedikuar zgjedhësve dhe situatës post – tërmet në shtator 2019, gjatë të cilës bëri diferencë vetëm deputeti dhe ish-ministri Fatmir Xhafaj. Ai pjesën e parë të fjalës ia dedikoi luftës politike, por në pjesën e dytë deklaroi se *“qeveria do t’i bënte një shërbim të mirë vendit nëse në reflektim të kësaj që përjetuam dhe nevojës për t’u përballur me dëmet, të përgatiste e të bënte shumë shpejt publike një strategji të qartë reflektimi, të shoqëruar me një plan serioz veprimi. Më së paku, është domosdoshmëri nevoja për dokumentimin shkencor të dëmeve, azhurnimin e hartës sizmike të vendit, ndërmarrjen e një analize shkencore për përcaktimin e zonave problematike, të cilat sjellin risqe të mëdha nga tërmetet për shkak të ndërtimeve të paligjshme, ashtu si dhe për digat, urat, rezervuarët, shtesat e kateve e të objekteve pa cilësi, të legalizuara tashmë, e të tjera të tilla. E kemi të domosdoshme për të ringritur apo fuqizuar institucionet shkencore të këtyre fushave, përmirësimin cilësisht të kuadrit ligjor e institucional në lidhje me rregullat e ndërtimit, kontrollin e ndërtimeve, përgjegjësitë ligjore përkatëse që ndalojnë dhe ndëshkojnë ndërtues të papërgjegjshëm, leje të paligjshme, mungesën e hapësirës për gjendjen dhe veprimin e emergjencës në situata të tilla, miratimin e protokolleve të reagimit të njerëzve në fatkeqësi të tilla, si dhe komunikimin publik në raste të kësaj natyre”*. Të gjitha këto këshilla janë një kontribut pozitiv parlamentar dhe ofrojnë një ekspertizë cilësore, e cila nëse do të dëgjohej e vlerësohej me siguri, në disa elementë do të minimizonte dëmet e mëdha që pësuam në tërmetin e dytë dhe më të madh të 26 nëntorit.

## 6.7. DEPUTETI BUSHATI, ZËRI I VETËM KRITIK NË PS?

Ish-Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati, tashmë deputet i thjeshtë në parlament, gjatë sesionit të fundit parlamentar u identifikua si zëri i vetëm kritik ndaj nismave të nxituara politike të mazhorancës në parlament. Në total ai ka votuar në 24 raste në pakicë me votën e shumicës në mazhorancë. Bushati ishte disa herë kritik në parlament, ishte deputeti i vetëm i mazhorancës që abstenoj në votimin e paketës anti-shpifje, por edhe një prej zërave të vetëm kritikë në aktivitetin e Komisionit të Jashtëm parlamentar në parlament.

Më 6 nëntor në mbledhjen e Komisionit të Jashtëm Bushati ndërhyri disa herë duke argumentuar dobësitë, kundërshtitë dhe problematikat e projektrezolutës së propozuar nga kreu i grupit të PS T.Balla. Midis të tjerave ai deklaroi se *“prandaj po ju them: mos ta fusim veten në ujërat e turbullta që nuk e ka futur asnjë parlament. Nuk ka një rezolutë të parlamenteve demokratike në Shqipëri, pas ’90-ës, që të jetë marrë me emra shtetesh. Koha kur ne u shpallnim luftë shteteve të ndryshme ka përfunduar më 8 dhjetor 1990”*.



Interesant është fakti se ndonëse D.Bushati shtroi pyetje konkrete mbi konsultimet në nivel të BE, praktikat e rajonit, konsultimet në nivel OSBE dhe përputhshmëria me Strategjinë Kombëtare të Sigurisë, të gjitha kritikrat e kërkesat e tij u refuzuan, madje siç vlerësoi deputeti mbështetës i rezolutës A.Shameti, ai u kritikua se “vetëm propozime konkrete nuk dëgjova në asnjë fjali apo paragraf të kësaj rezolute”, qëndrim që u mbështet edhe nga kryetarja e komisionit M. Kodheli.

Edhe në muajin shtator në fjalën e tij në seancë plenare deputeti, duke kritikuar qasjen ndaj integritit dhe diasporës tha se “kjo nuk është një çështje e majtë e djathtë, po nëse doni si socialist, si progresist, si politikan si qytetar, më shqetëson përqendrimi i të ardhurave në një grusht njerëzish, më shqetëson prirja jonë për zgjidhje të lehta në vend që të punojmë për modele të qëndrueshme”.

#### 6.8. MUNGESA E OPOZITËS SË ORGANIZUAR, ZGJEDHJE “FORMALE” NË KUVEND

Gjatë sesionit të fundit parlamentar pati disa vendime dhe procese zgjedhesh në Kuvend. Në praktikat parlamentare pothuajse gjithnjë ka ndodhur që kandidatët për postet e rëndësishme në institucionet me burim zgjedhor Kuvendin, të jenë kandidatë të mbështetur nga mazhorancat. Po ashtu në shumicën absolute të rasteve ka ndodhur që për të njëjtin post të ketë më shumë se dy aplikime, në mënyrë që edhe thirrjet për kandidim dhe vetë procesi zgjedhor të marrë më shumë kuptim dhe të ketë konkurrencë.

Gjatë sesionit të fundit kjo traditë pësoi ndryshim kryesisht për shkak të mungesës së interesit për kandidim formal në një Kuvend ku ka vetëm një shumicë parlamentare dhe ku pakica nuk është e organizuar. Për rrjedhojë, postet që kërkonin nismë propozuese prej 28 deputetësh apo ato që përfshijnë seleksionim nga strukturat politike të Kuvendit, siç janë Komisionet e Përhershme, ku mazhoranca ka shumicën, janë me vetëm një kandidat në garë.

Për shembull, zgjedhja e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në mandatin e parë është bërë së paku me dy kandidatë në garë dhe me disa kandidatë të tjerë në fazën fillestare (shprehje interesi), kurse rizgjedhja në tetor 2019 u bë me vetëm një kandidat në garë dhe me vetëm një kandidat që ka shprehur interes. Në vendimin e Kuvendit për zgjedhjen me vetëm një kandidat në garë të Komisioneres (rizgjedhje) relacioni përmbledhë firmat e 28 deputetëve mbështetës për kandidaturën e zonjës P.Strakosha. Në firmat mbështetëse janë

#### 15 DEPUTETË TË “OPOZITËS” I JAPIN BESIM QEVERISË PËR BUXHETIN 2020

*Në votimet parlamentare votimi për buxhetin konsiderohet gjithnjë votim politik, sepse ka të bëjë me diferencat në prioritetet e politikave dhe në identitetet programore të partive që janë në qeveri ose në opozitë. Referuar të dhënave të vitit 2019, rezulton se në votimin e datës 18 dhjetor mbi buxhetin e ri shtetëror 2020, kanë votuar pro mazhorancës, pra pro propozimit të qeverisë së majtë në pushtet rreth 17 deputetë, nga të cilët 15 supozohet të jenë deputetë të opozitës.*

*Konkretisht, krahas votës pro të përhershme të Doshit (PSD) dhe Lalës (PDIU) qeveria siguroi votën pro për buxhetin e saj edhe nga deputetët e rinj Eugen Bojaxhiu, Ediola Braha, Majlinda Halilaj, Edlira Hyseni, Selami Jenishehri, Aurora Mara, Ervis Meço, Nimet Musaj, Klajdi Qama, Enver Roshi, Edmond Rrushu, Krenar Rryçi, Ylli Shehu, Edlond Stojku dhe Suzana Topi, shumica e të cilëve të ardhur nga lista proporcionale e LSI. Pjesa më e madhe e tyre ka votuar gjithashtu pro aktit normativ nr. 2, të datës 02.10.2019, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", pra është një votë e vazhdueshme dhe publike në mbështetje të qeverisë dhe politikave buxhetore të saj.*



edhe deputetët U.Manja, B.Fino, E.Leka, etj, që janë anëtarë të Komisionit të Ligjeve ku bëhet vlerësimi i kandidaturës dhe kalimi i saj në seancë plenare për votim. Edhe në rastin e zgjedhjes së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (shtator 2019) gjithashtu pati vetëm një kandidat në garë, rikandidimi i Komisionerit në detyrë.

Pavarësisht cilësive të individit dhe vlerësimit për mandatin e parë (për mbështetje në rikandidim) në tërësi koncepti i vetëm një kandidati për poste me rëndësi publike dhe për drejtim në institucione të pavarura përbën një cenim të standardeve të mira të demokracisë funksionale.

## 6.9. KUVENDI, VONESA NË PËRMBUSHJEN E FUNKSIONEVE ZGJEDHORE

Këshilli Drejtues i RTSH vijon të ketë për anëtarë, individë të cilëve u ka mbaruar mandati në shtator 2018 dhe në mars 2019. Procedurat e nisura nga Kuvendi për zëvendësimin e anëtarëve të parë (2018), megjithëse ishin në përfundim, u ndërprejnë pas vendimit të opozitës për dorëzimin e mandateve në shkurt 2019, ndërkohë që procedurat e reja për anëtarët zëvendësues ende nuk kanë dhënë rezultat. Për pasojë, Këshilli Drejtues i RTSH vijon të marrë vendime edhe në nëntor-dhjetor 2019 përmes vetëm 6 anëtarëve, K.Traja, Xh.Aliu, S.Kumbaro, Xh.Mato, P.Përvathi dhe H.Haliti. Sipas ligjit KD i RTSH përbëhet nga 10 anëtarë, por ai vijon të funksionojë me vetëm 6 anëtarë, ku midis tyre ka anëtarë me mandat të përfunduar kohë më parë.

Institucioni i dytë më i vonuar në plotësimin e vendit vakant nga Kuvendi është Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Prej muajit maj 2018 institucioni vijon të ketë një vend vakant, pas dorëheqjes së anëtarit D.Gumeni Kuvendi ka bërë disa thirrje, ka vijuar procedurat, por në përfundim, i gjithë procesi është ndërprerë në kërkim të një kandidati më të përshtatshëm për mazhorancën. Në sesionin aktual parlamentar 28 deputetë iniciuan kërkesën për mbështetjen e kandidatit B.Ndregjoni për postin vakant të anëtarit, megjithatë ende nuk ka një vendim dhe as procedurë të avancuar nga Komisioni i Ligjeve dhe nga Kuvendi. Lënia vakant e një posti të thjeshtë në hierarkinë shtetërore për më shumë se 20 muaj është një tregues kritik për Kuvendin.

Prej dhjetorit 2018 është ende vakant edhe posti i kryetarit të KLSH. Presidenti propozoi tre emra, secili prej tyre u rrëzua nga mazhoranca me motive të ndryshme (por jo të njëjta), një tregues se standardi i zgjedhjes lidhet më shumë me arsyetime politike sesa ligjore. Aktualisht presidenti nuk ka iniciuar emër tjetër dhe Kuvendi nuk ka bërë kërkesë për plotësimin e vendit vakant, i cili vijon të ushtrohet tej mandatit nga kryetari Bujar Leskaj. Për më tepër, në çdo raportim në Kuvend, në komisione dhe në strukturat e tjera të tij, KLSH vijon të përfaqësohet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe jo nga kryetari në detyrë, një tregues i përshtatjes dhe pranimit nga Kuvendi të kësaj situatë absurde.

### **BRENDA PAK MINUTASH, I NJËJTI PERSON ZGJIDHET NË DY POSTE**

*Kuvendi, përmes një procedure të shpejtuar më 18 dhjetor brenda pak minutash vendosi shkarkimin e kryetarit të AKEP, zgjedhjen e një anëtar në vendin vakant dhe menjëherë më pas zgjedhjen e të njëjtit anëtar edhe kryetar të Këshillit Drejtues të AKEP. Zgjedhja lidhet me emrin e zyrtarit të protokollit në kryeministri, T. Frashëri dhe me nevojën e mazhorancës për të siguruar funksionimin e plotë të AKEP pas miratimit në të njëjtën ditë në Kuvend të paketës "anti-shpifje", e cila njeh dhe ngarkon përgjegjësi konkrete për AKEP në jetësimin e saj.*



Një arsyetim për këto dhe raste të ngjashme lidhet me prioritetet politike të mazhorancës, në të cilat asnjëri nga institucionet, përfshirë KLSH, RTSH apo AIDSSH nuk bëjnë pjesë. Megjithatë, pavarësisht interesave politike, Kuvendi si institucion kushtetues ka detyrimin dhe përgjegjësinë të jetë model në zbatimin e ligjit dhe përgjegjësi të tij, gjë që nuk ka ndodhur së paku në raste të tilla të cituara më lart.

## 6.10. HAPJA PËR PUBLIKUN, TË DHËNA POZITIVE PËR KUVENDIN

Edhe gjatë muajve shtator-dhjetor 2019 vijoi praktika e zhvillimit të aktiviteteve të hapura për publikun nga ana e Kuvendit. Konkretisht, monitoruesit e ISP identifikuan më shumë se 20 raste kur grupe të rinjsh, studentë apo aktivistë, ishin të ftuar në sallën e mbledhjeve të seancës plenare, në mjediset e Kuvendit, në aktivitetet e tij apo në komisione të ndryshme parlamentare. Po ashtu, u identifikuan raste të shumta të kërkesave që vijnë në Kuvend nga individë e grupe të ndryshme qytetare, të cilat trajtohen dhe në rastet e nismave që kërkojnë vendimmarrje, adresohen nëpër komisione ose strukturat e Kuvendit.

Në kuadër të aktiviteteve për 100 vjetorin e Kuvendit pati disa nisma të suksesshme dhe përpjekje për angazhimin e të rinjve, universiteteve dhe botës akademike në punë kërkimore, në konkurse apo në forma të tjera angazhimi, duke ndihmuar në zgjerimin e hapësirës së debatit dhe të njohurive mbi parlamentarizmin. Në disa komisione parlamentare, përfshirë në Komisionin e Reformës Zgjedhore u ftuan pothuajse të gjitha organizatat civile dhe grupet e interesit që kanë adresuar gjatë 2019 çështje të ndryshme në këtë komision, praktikë që përbën zhvillim pozitiv në raport me të kaluarën.

## 6.11. BASHKËPUNIMI ME SHOQËRINË CIVILE, PROGRES E PROBLEME

Gjatë sesionit shtator – dhjetor 2019 përgjithësisht Kuvendi ka treguar bashkëpunim pozitiv me shoqërinë civile përfshirë edhe stafin monitorues të ISP. Në një takim rajonal me organizata të njëjta monitoruese të shoqërisë civile mbi parlamentin vendet partnere shprehën habi mbi praktikën e parlamentit të Shqipërisë, i cili kërkon CV të detajuar të ekipeve monitoruese nga shoqëria civile, megjithatë për ISP kjo nuk ka qenë pengesë për vijimin e monitorimit aktiv. Gjithashtu ISP është ftuar disa herë nga Komisione të ndryshme në Kuvend, sidomos Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore.

Megjithatë, në vlerësimin e përgjithshëm mund e duhet të bëjmë një dallim thelbësor midis bashkëpunimit të shoqërisë civile me Kuvendin (pjesën administrative të tij) me strukturat vendimmarrëse në Kuvend (pjesën politike të tij). Pjesa administrative është më korrekte, më institucionale, më e hapur dhe më bashkëpunuese, kurse pjesa politike vijon të jetë më e mbyllur, më paragjyquese ndaj krtikave apo sugjerimeve që vijnë edhe aktorëve të shoqërisë civile që e realizojnë atë, përfshirë ISP. Për këtë arsye shoqëria civile ngriti shqetësimin e saj në seancën dëgjimore me Komisionin e Posaçëm për Reformën

### ISP MONITORIM DHE ASISTENCË NDAJ DEPUTETËVE

*ISP i është bashkuar Kuvendit në përgatitjet e aktiviteteve për 100 vjetorin e parlamentarizmit në Shqipëri, si dhe në procese të ndryshme publikimesh në kuadër të botimeve profesionale nga parlamenti. Gjithashtu ISP ka konfirmuar tashmë ardhjen e dy ekspertëve ndërkombëtare për të kryer në muajin mars 2020 një trajnim aktiv mbi funksionet dhe nevojat e tjera në aktivitetin parlamentar për deputetet anëtare të Aleancës së Grave Deputete, praktikë që do të vijojë edhe në të ardhmen në varësi nga kërkesat dhe nevojat e Kuvendit.*



Zgjedhore dhe me pas edhe në disa komisione të tjera, se sjellja e disa deputetëve ndaj sugjerimeve të saj është arrogante dhe mungon vlerësimi për një kontribut vullnetar dhe qytetar që sjellin zërat civil në aktivitetin parlamentar. Kjo kritikë vlen kryesisht nga ato struktura politike në Kuvend, grupe parlamentare apo komisione, të cilat rezultojnë me kritika në raportet monitoruese të ISP, natyrisht për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të tyre në raport me ligjin, Rregulloren dhe Kushtetutën e RSH.

Nga ana tjetër, stafi i ISP dhe organizata të ndryshme partnere të shoqërisë civile kanë adresuar disa herë direkt (përmes komunikimit online ose me shkresë zyrtare) shqetësime që lidhen me procese selektive të komisioneve të ndryshme në Kuvend, me mos publikimin në asnjë rast nga Komisionet dhe Kuvendi të rekomandimeve apo kërkesave e raporteve të ardhura nga shoqëria civile, si dhe mos dhënien asnjëherë të ndonjë përgjigjeje qoftë edhe formale nga Kuvendi lidhur me rekomandimet, raportet, sugjerimet apo kërkesat që adresojmë ndaj Kuvendit.

## 6.12. KUVENDI, I VETMI INSTITUCION ME TRANSPARENÇË FINANCIARE

Kuvendi vijoi edhe gjatë muajve të fundit të vitit 2019 të publikojë rregullisht të dhënat financiare mbi të ardhurat e deputetëve. Ky standard i nisur më 2018, e bën Kuvendin institucionin e vetëm kushtetues e shtetëror në vend që publikon të dhënat financiare, - një model që do të duhej të ndiqej edhe nga institucionet e tjera që paguhen me taksat qytetare.

Po ashtu Kuvendi publikon të dhëna të rregullta periodike mbi përdorimin e buxhetit vjetor, të dhëna për shpenzimet, investimet, si dhe mbi projektet. Kuvendi ka botuar raporte të rregullta vjetore të aktivitetit dhe bilancit të tij midis viteve 2013-2017, por ende nuk ka publikuar raportin e vitit 2018 edhe pse ndodhemi në janar 2020, një e dhënë kritike që duhet të përmirësohet në funksion të transparencës publike. I njëjti sugjerim dhe e njëjta kritikë vlen edhe për publikimin vjetor të raportit mbi pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes, raporte që janë botuar për vitet 2015 dhe 2016, por nuk kanë vijuar të publikohen për vitet në vijim, 2017-2019.

## 6.13. RASTET ABUZIVE? MUNGON REAGIMI NGA KUVENDI

Praktikat demokratike kërkojnë që institucionet, kur marrin raportime kritike për shkelje rregullash, ligjesh apo procedurash, reagojnë në dy forma. Nëse kritikën janë subjektive, ato e adresojnë shqetësimin e tyre tek organizata apo institucioni që ka bërë raportimet kritike. Nëse kritikën janë objektive vetë Kuvendi nis një hetim administrativ dhe merr masa konkrete, të cilat më pas i bëhen të njohura publikut dhe organizatave monitoruese që kanë adresuar kritikën.

Në rastin e raporteve nga ISP, përfshirë raportimin e parë të vitit 2019, ashtu edhe në raportimet 2018, kemi adresuar me raste, data dhe emra konkretë shkelje të Rregullores dhe procedurave parlamentare, siç janë rastet e pjesëmarrjes fiktive të deputetëve në komisione, rastet e abuzimit me regjistrimin njëherësh në dy ose më shumë mbledhje në strukturat në Kuvend, rastet e abuzimit me përfitimin e bonusit financiar, etj, për të cilat në asnjë rast nuk kemi pasur asnjë reagim, njoftim apo reflektim nga Kuvendi.

Mungesa e reagimit nga Kuvendi për raste të tilla mund të ndikojë në dobësimin e raportit të tij me besimin publik dhe llogaridhënien, si dhe në cenimin e vetë konceptit të transparencës dhe të standardeve demokratike të funksionimit në nivel politik dhe administrativ të Kuvendit.



#### 6.14. DY INTERPELANCA NË 4 MUAJ, NJË TJETËR NË PRITJE

---

Gjatë sesionit të fundit deputetët kërkuan dy interpelanca. Interpelanca e parë u kërkua me Ministrin e Jashtëm lidhur me rastin e një qytetari shqiptar në Siri. Debatu u zhvillua më 4 nëntor, megjithatë vëmendjen kryesore e mori debati nëse duhej të ishte kryeministri në përgjigjen e interpelancës, me cilësinë edhe të Ministrin të Jashtëm apo ai mund ta delegojë përgjegjësinë e interpelancës tek një prej ministrave të tij, konkretisht Ministres për Marrëdhëniet me Parlamentin Elisa Spiropali. Deputetët iniciues të opozitës, me folës Andi Përmeti, insistuan tek ardhja e kryeministrit, ndërkohë që drejtuesi i Kuvendit arsyetoi se meqenëse Kryeministri është edhe Ministër i Jashtëm ai mund ta delegojë përgjegjësinë e tij tek një ministër tjetër në kabinet.

Interpelanca e dytë lidhet me Ministren e Financave Anila Denaj, rreth nevojës për informim “mbi politikën fiskale të ndjekur kohët e fundit në lidhje me aksionin kundra informalitetit si dhe goditjet selektive ndaj bizneseve nga njëra anë dhe favorizimi për mos pagesë-gjore prej miliona eurosh nga ana tjetër për subjekte të veçanta”, kërkuar nga deputeti Myslim Murrizi. Interpelanca u zhvillua në tetor.

Një tjetër interpelancë e kërkuar nga një grup deputetësh të opozitës me Ministren e Infrastrukturës dhe Energjetikës ka në fokus një kërkesë të veçantë rreth projektit të rrugës Korçë-Maliq-Lozhan, si dhe me aksin rrugor Qukës - Qafë Pllaçë dhe atë Qafë Pllaçë - Gocë - Voskopojë -Vithkuq. Kjo interpelancë e paraqitur në fundin e muajit nëntor është ende në procedurë pritëse dhe i mbetet axhendës së vitit 2020.

#### 6.15. KUVENDI 3 REZOLUTA POLITIKE GJATË SESIONIT TË VJESHTËS

---

Mazhoranca u investua dukshëm në përpjekjet për të ushtruar presion politik ndaj Presidentit të Republikës lidhur me vendimin e tij preferencial në zgjedhjen e një anëtari të Gjykatës Kushtetuese. Mbi këtë bazë ajo jo vetëm inicioi zgjerim të fokusit të hetimit në Komisionin Parlamentar dhe ndryshime ligjore në formulat e betimit të gjyqtarëve kushtetues, por më 15 nëntor miratoi edhe një rezolutë të dedikuar debatit me Presidentin.

Rezoluta *"Shmangia e krizës kushtetuese me synim legjitimitetin e gjykatës kushtetuese - detyrë imperative e organeve më të larta të shtetit"* kaloi në nëntor 2019, por pa pasur efekt real në krizën kushtetuese. Një tjetër rezolutë e iniciuar nga mazhoranca është ajo *"Për ndërhyrjet e huaja në proceset elektorale dhe dezinformimin në proceset demokratike kombëtare"*, gjithashtu e votuar nga Kuvendi më 5 dhjetor 2019. Një tjetër rezolutë u fokusua në mbështetjen e procesit të fillimit të bisedimeve për anëtarësimin e RSH në Bashkimin Evropian, kaluar në tetor 2019.

#### 6.16. KËRKESAT PËR INFORMACION DHE DHËNIA E INFORMACIONIT


---

Një nga mekanizmat në dispozicion të aktivitetit të deputetëve është e drejta e tyre për të kërkuar informacione nga institucione të ndryshme si dhe për të adresuar problematika apo kërkesa institucioneve mbi bazën e përgjegjësisë së tyre si ligjvënës. Tradicionalisht kjo e drejtë është ushtruar vetëm nga një numër minimal deputetësh, kryesisht deputetë që kanë trajnimin e duhur për aktivitetin parlamentar dhe që ndajnë shqetësime të ndryshme me zonat elektorale.





Nga të dhënat zyrtare të Kuvendit gjatë periudhës shtator – dhjetor 2019 vetëm 14 deputetë e ushtruan këtë të drejtë, 9 nga të cilët vetëm në një rast. Rekord me kërkesa mbajnë deputetët me përvojë Ermonela Felaj dhe Antoneta Dhima, si dhe deputeti i ri Vasil Sterjovski. Së bashku ata zënë 62% të totalit të kërkesave për informacion dhe rekomandime. Të dhënat e detajuara janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Për sqarim, vetëm deputetët e përfshirë në tabelë kanë përfituar nga bonusi i vlerësimit me 10 pikë në tabelën përmbledhëse të efikasitetit të deputetëve, ku janë të klasifikuara vlerësimet sipas kompetencave të deputetëve dhe mënyrës sesi ata i përdorin instrumentet përfaqësues në dispozicion gjatë aktivitetit parlamentar.



Kërkesat për informacion dhe kërkesat për ndërhyrje, kryesisht për shtesë në fonde, janë të ndryshme, por dominuese janë kërkesat që lidhen me problematika të zonave elektorale dhe me pozicionin e deputetit në komisionet parlamentare. Konkretisht, gjenden kërkesa që lidhen me zbatimin e ligjit 28/2019 për trajtimin financiar të punonjësve të naftës e gazit, për rikonstruksionin e qendrës shëndetësore në Zharës dhe për qendrën sociale në Fier (A.Dhima), informacion mbi investimet për puse uji në Bashkinë Pustec dhe hapjen e Qendrës Kulturore Informative ne Shkup (V. Sterjovski), informacion mbi ngjarjet e ndodhura në I EVP Shënkoll (A.Zeneli, A.Çaçani, A.Elezi), informacion mbi kompaninë “Bankers Petrol” (M.Murrizi), informacion mbi rezultatet e luftes antitrafik (E.Gjebrea), informacion mbi rastin e femijës Alvin Berisha (R.Hajdari), informacion mbi projektet e viteve 2017, 2018, 2019 nga FSHZH (T.Balla), informacion mbi shqetësimin e banorëve të Germenj dhe Shelegur Korçë (Çaçani), informacion mbi spitalin Kuçovë, për rehabilitimin e shtëpive të familjeve rome në Kuçovë, për ristrukturimin e Kishës në Kozarë (E.Felaj) apo kërkesa për spostimin e kabinës elektrike nr.7 në Tiranë (E.Bushati). Dy deputetët, Xh.Qefalia e S.Vorpsi kanë kërkuar informacion tek SHISH lidhur me deklaratimet e Presidentit, kërkesë e bërë për shkak të aktivitetit të tyre në Komisionin e Sigurisë Kombëtare.

Një problematikë tjetër lidhet me respektimin ligjor nga institucionet për të drejtave të deputetit, sic është edhe e drejta e kërkesës për informacion. Nga monitorimi rezulton se deputetët janë ankuar për vështirësi në marrjen e përgjigjeve mbi kërkesat për informacion adresuar institucioneve të ndryshme. Në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve më 17 shtator u debatua mbi këtë pikë, pasi sipas deputetëve disa institucione, si Ministria e Mbrojtjes dhe e Brendshme, nuk iu përgjigjen kërkesave për

informacion prej tyre. Në përgjigje të shqetësimit kryetari i Kuvendit deklaroi se *“ne si Kuvend duhet t’i ndjekim informacionet për deputetët. Ka një Rregullore, një ligj për deputetin, si bëhet kërkesa, kush e adreson, kur kërkohet, ku adresohet dhe kur përgjigjet. Nëse nuk përgjigjet, është detyra e Shërbimeve të Kuvendit të ndjekin kërkimin e informacionit...Kuvendi ka edhe rolin monitorues dhe kontrollues, individualisht si deputet, si komision apo si institucion, ndaj nuk duhet të ketë asnjë spekulim në këtë drejtim”*.




Tabela më sipër pasqyron raportin e përgjigjeve nga institucionet shtetërore ndaj kërkesave të deputetëve. Konkretisht, rreth 29% e kërkesave nuk kanë marrë përgjigje, - një shifër shumë e lartë dhe alarmante e devijimit të institucioneve nga detyrimi i tyre ligjor për t’iu përgjigjur çdo kërkesë të deputetëve.

Nga të dhënat e marra nga Kuvendi rezulton se institucionet që nuk janë përgjigjur ende lidhur me kërkesat (dhe për pasojë jashtë çdo afati ligjor), janë Kabineti i Kryeministrit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Kulturës, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave, Ministria e Jashtme, Ministria e Brendshme, Autoriteti i Konkurrencës, SHISH, etj. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë mban shifrën rekord të institucionit më me shumë refuzim ose injorim të kërkesave për informacion nga deputetët, ndjekur nga Kryeministria dhe Ministria e Shëndetësisë.

### 6.17. DEPUTETË “HEADLINE” ME LAJME NEGATIVE?

Gjatë sesionit të fundit parlamentar pati disa raste kur deputetë të Kuvendit, sidomos disa deputetë të ardhur nga lista proporcionale e opozitës, pas vendimit të saj për dorëzimin kolektiv të mandateve, u bënë “headline” në media për skandale në fjalime ose komunikime jo etike.

- Në një rast deputetja M.Halilaj u bë lajm negativ në media për problemet e shfaqura gjatë mbajtjes së të vetmit fjalim të saj në seancat plenare.
- Lajm negativ u bënë edhe përdorimi i ligjërimit denigrues nga zv/kryetari i Kuvendit M.Murrizi për kategori të veçuara sociale, çfarë solli protesta të shoqërisë civile në parlament dhe reagim kritik nga institucionet e Komisionerit Anti Diskriminim dhe Avokatit të Popullit.
- Lajm negativ prodhuan disa deklarata të deputetit K.Gjuzi në parlament e jashtë tij, si dhe kritikën e Kuvendit se ai ka shkelur Kodin e Sjelljes.

- Një incident midis deputetit R.Gjoni dhe ministrit E.Shalsi në parlament solli ndërprerjen e përkohshme të seancës plenare më 17 tetor. Dy palët akuzuan njëri tjetrin për shkelje të Kodit të Sjelljes dhe kërkuan masa sipas Rregullores megjithatë nuk pati asnjë veprim pasues.
- Gjithashtu gjatë këtij sesioni pati raste kur grupet monitoruese përfshirë ISP publikuan të dhëna kritike për shkeljet tërësore të standardeve të përdorimit të rregullave të paraqitjes formale të nismave ligjore dhe të drejtshkrimit shqip, si dhe raste kur CV e ndonjë prej deputetëve ishin hartuar në mënyrë të tillë që dëshmonin nivel minimal të përgatitjes profesionale dhe natyrisht edhe politike.

Në tërësi media vazhdimisht raportoi për rritjen e perceptimit dhe e vlerësimit negativ publik mbi parlamentin dhe rolin e tij në jetën publike, duke u bazuar në skandalet e deputetëve apo elementë të ligjërimit kritik të tyre në parlament dhe në komisionet parlamentare.

Elementë të tillë nxorën në pah jo vetëm problematikat e dobësitë e përfaqësimit politik, me burim vetë partitë politike, por edhe nevojën jetike që kanë një pjesë e madhe e deputetëve për trajnim të vazhdueshëm në procesin ligjvënës, në ushtrimin e mandatit parlamentar, në ligjërimin publik, në marrëdhëniet institucionale dhe në elementë të tjerë thelbësorë të aktivitetit të tyre parlamentar. Pothuajse të gjitha vendet me probleme si Shqipëria aplikojnë trajnime të vazhdueshme, megjithatë në rastin tonë, ato ose kanë munguar ose kanë qenë kryesisht formale. Vetë grupet parlamentare nuk ofrojnë trajnime dhe parlamenti nuk ka një buxhet të dedikuar për këtë element të rëndësishëm të forcimit të cilësisë në përfaqësimin parlamentar.

Një rast tipik është ai i deputetit M.Murrizi, i cili mban edhe pozitën e zv/kryetarit të Kuvendit. Deputeti ka kaluar një nga sesionet parlamentare më aktive, me një bilanc të pasur angazhimesh në seancat plenare, në komisione, në debatet publike, në punën e Komisionit të Reformës Zgjedhore, etj. Ai shfrytëzoi në maksimum kompetencat parlamentare duke ushtruar të drejtën ligjvënëse, duke propozuar ligje e amendime ligjore, duke adresuar kërkesa për informacion dhe duke iniciuar interpelancë në parlament.

Nga ana tjetër deputeti Murrizi ishte edhe nga deputetët më të kontestuar kryesisht për shkak të ligjërimit politik e publik jo etik që u përdor. Në shtator pati një protestë kundër tij nga një grup i shoqërisë civile, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi adresoi një shqetësim publik ndaj tij dhe të njëjtën gjë bëri edhe institucioni i Avokatit të Popullit. Rregullorja e Kuvendit parashikon që në raste të tilla pretendimet verifikohen dhe parashikohen masa përkatëse. Pavarësisht mungesës së reagimit nga Kuvendi etika e vlerësimit profesional e bindi ekipin monitorues të vlerësojë deputetin me - 5 pikë penalizim në vlerësimin e përgjithshëm (- 10 pikë jepen kur Kuvendi merr një vendim penalizues).

## 6.18. DEPUTETËT, NJË RROGË MUJORE PËR TËRMETIN? JO TË GJITHË

Nga të dhënat e deklaruara në faqen e parlamentit 66 deputetë të mazhorancës (PS) e dhuruan rrogën e tyre të muajit nëntor për viktimat e tërmetit dhe procesin e rindërtimit pas tij. Me siguri që nismës i janë bashkuar edhe 9 deputetë që janë pjesë e kabinetit qeveritar, megjithëse nuk ka pasur një deklaratë publike dhe as ndonjë të dhënë konkrete e të verifikueshme.

Nga të dhënat e publikuara në faqen e parlamentit rezulton se deputetët e tjerë të Kuvendit nuk deklaruan dhurim rroge dhe se zyrtarisht figurojnë përfitues të trajtimit të rregullt mujor financiar. Në



këtë listë bëjnë pjesë edhe deputeti R.Bitri (zyrtarisht pjesë e grupit parlamentar të PS), si dhe deputetët e tjerë T.Doshi, Gj.Gjetani, E.Xhina, R.Lala e L.Koka, të cilët jo zyrtarisht janë pjesë e grupit të mazhorancës dhe mbështetës politikë të saj, pavarësisht se më 2017 janë zgjedhur përkatësisht nga PSD, PS, PDIU dhe LSI.

### **6.19. VULLNET SINAJ, 10 MILIONË LEKË DONACION PËR VIKTIMAT E TËRMETIT**

---

Në reagim ndaj tragjedisë që krijoi tërmeti i datës 26 nëntor 2019 grupi parlamentar i PS në Kuvend vendosi të dhurojë rrogën mujore në mbështetje të fondit për viktimat dhe rindërtimin. Megjithatë, një prej deputetëve, Vullnet Sinaj, deklaroi publikisht se do të dhurojë 10 milionë lekë (100 milionë të vjetra).

Në deklaratën e tij dhënë në media, Sinaj, tha se *“ndonjëherë thuhet që e keqja dhe e mira rrinë shumë afër dhe sot në këtë ditë, shikoj që e keqja e tërmetit na ka bërë të gjithë bashkë. Doja të shprehja trishtimin tim, hidhërimin, ngushëllimet e familjarëve që kanë humbur familjarët që kanë humbur të afërmit e tyre, të falënderoja trupat e specializuar që erdhën nga vendet mike. Unë në politik kam hyrë nga biznesi, para një ditë grupi i PS vendosi që të linte pagën e nëntorit për të ndihmuar familjet e dëmtuara, por mua nuk më shkonte kaq për shtat. Veç asaj rroge do të jap edhe 100 mln lekë të vjetra nga llogaria ime personale. Me gjithë zemër, ftoj të gjithë ata që kanë mundësi sado të kenë mundësi të kontribuojnë. Shpresoj që Zoti të mos na vërë më në vështirësi për të treguar që jemi bashkë”*. Vlen të theksohet se në grupin parlamentar të PS dhe në Kuvend ka më shumë se 30 biznesmenë dhe Sinaj ishte i vetmi deputet që bëri një donacion publik nga të ardhurat e biznesit.



## 7. KOMISIONET: BILANCI E PROBLEMATIKA TË FUNKSIONIMIT

Aktiviteti i deputetëve në Komisionet e Përhershme dhe të Posaçme përbëjnë zërin kryesor të aktivitetit javor në parlament. Në dallim nga shumica e parlamenteve perëndimore, në Shqipëri aktiviteti në komisione përbën lajm në media për shkak të pranisë së saj aktive, gjë që shpesh shkakton edhe debate e situata të evitueshme, sidomos kur ka konflikt ose mosmarrëveshje në politikë. Megjithatë gjatë periudhës shtator-dhjetor 2019 ka pasur vetëm disa raste sporadike kur deputetë të veçantë, në një rast edhe kryetarja e komisionit, ose grup deputetësh kanë deklaruar braktisjen e mbledhjes në shenjë mos aprovimi të ndonjë vendimmarrjeje.

### 7.1. STANDARDET E PUNËS NË KOMISIONE? DISA GJETJE NGA MONITORUESIT

Vëzhguesit e ISP kanë arritur të jenë prezent në më shumë se 90% të mbledhjeve të komisioneve, duke ndjekur në vazhdimësi procedurat, problematikat, vendimet dhe elementë të tjerë të punës së tyre, përfshirë edhe brendësinë e debatit dhe të akteve të miratuara. Më poshtë janë vetëm disa elementë teknikë të problematikave, në raport me Rregulloren e Kuvendit për Komisionet.

#### 1. Në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut monitoruesit

konstatuan tri raste kur deputetë që nuk kanë qenë prezent në mbledhje figurojnë se janë prezent (4/9, 6/9, 18/9), raste kur mbledhja është zhvilluar në ditën e seancës plenare dhe për të cilën nuk ka pasur njoftim paraprak (12/9 dhe 30/9), ka dy deputetë që marrin pjesë në të njëjtën kohë në dy komisione duke qëndruar në komision vetëm disa minuta (18/11 dhe 20/11), etj. Në këtë komision pati ankesa nga disa subjekte për parregullsi në njoftimet paraprake. Në një prej rasteve më 18 nëntor, Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Gent Ibrahim i deklaroi se “sot jam i papërgatitur për të kundër-argumentuar në mënyrë të efektshme për një arsye shumë të thjeshtë. Sot në mëngjes, jam me fat që e kam marr vesh, se edhe mund të mos e merrja, se këtu do të diskutohej buxheti i KLP-së. Se si dhe pse, është puna juaj, ndaj zgjidheni ju”.

#### **DEPUTETI FINO, SI NJË SHEMBULL POZITIV?**

*Në debatin e Komisionit të Ligjeve për buxhetin 2020 për institucionet e pavarura, të zhvilluar në nëntor 2019 deputeti Fino, me cilësinë e relatorit, dëshmoi njohuri dhe aftësi të dukshme parlamentare duke analizuar, prezantuar dhe vlerësuar buxhetet dhe problematikat përkatëse me një cilësi të dallueshme për çdo praktikë tjetër pune në komisionet aktuale në parlament. Ky rast tregon se të qenit relator nuk është thjesht një përgjegjësi formale që fillon e mbaron me vlerësime teknike dhe mbështetje për palën tjetër, por është një përgjegjësi thelbësore që kërkon përgatitje, përvojë, investim dhe kurajë për të prezantuar në mënyrë sintetike të gjithë problematikën e çështjes.*

#### 2. Në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave

monitoruesit konstatuan rastin kur kryetari largohet nga mbledhja duke ia dhënë drejtimin e saj një deputeteje anëtare në komision (17/12 dhe 21/11), raste kur kryetari aplikon dy standarde, pasi nuk pranon në mbledhje dy zyrtarë që vijnë me vonesë nga një komision tjetër, por pranon një zyrtar tjetër që u vonua për të njëjtën arsye (1/10), ka replika personale midis kryetarit, të ftuarve dhe deputetëve (3/9), ardhje me vonesë të një numri të madh deputetësh në mbledhje ose ardhje dhe



largime deputetësh (16/12, 15/11, 12/12), pjesëmarrje paralele të dy deputetëve në dy komisione të ndryshme (21/11), shtyrje të mbledhjes për shkak të mungesës së ministrit (18/11), etj.

3. Në **Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin** pati disa problematika teknike dhe procedurale, si p.sh, detyrimi për të bërë pushim në pritje të krijimit të kuoromit të deputetëve për votim (8/10), detyrimi për të shtyrë mbledhjen në pritje të ardhjes së deputetëve për krijimin e kuoromit për hapje (6/11), ankesa nga deputetë se njoftimi është bërë publik vetëm 15 minuta përpara fillimit të mbledhjes apo se jo të gjithë deputetët kanë marrë materialet paraprake që do diskutohen në mbledhje (29/10), nisma e mbledhjeve përpara kohës së lajmëruar apo largimi i ministrave për një komision tjetër në mesin e mbledhjes (18/11), etj.
4. Në **Komisionin e Sigurisë Kombëtare** gjithashtu monitoruesit evidentuan ndërprerje ose shtyrje të mbledhjes për shkak të mungesës së ministrit në komision (2/10 dhe 20/11), largimin e 6 deputetëve nga mbledhja e komisionit (10/10), pjesëmarrja e dy deputetëve paralelisht në dy mbledhje komisioni (18/11), ardhjen e dy deputetëve vetëm në momentet e fundit të mbledhjes për të firmosur prezencën formale (21/11), debate të ashpra midis deputetëve (18/9), etj.
5. Në **Komisionin e Edukimit dhe Mjetet e Informimit Publik** monitoruesit konstatuan raste të ardhjes së deputetëve në 5 minutat e fundit vetëm për të shënuar emrin formal për prezencë (9/9), debat i ashpër midis drejtuesit, të ftuarit ose deputetit për mosdhënie fjale për procedurë (10/10 dhe 11/12), zhvillim mbledhje në të njëjtën datë me seancën plenare, debat i ashpër midis drejtuesve, deputetëve dhe ministrit prezent (14/11), kontestim i të ftuarit në komision nga kryetarja dhe largimi i saj në shenjë proteste (15/11 dhe ), ikje të deputetëve në shenjë proteste nga Komisioni (16/12), etj.
6. Në **Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë** monitoruesit e ISP konstatuan raste minimale problematike, si p.sh, kur gjatë mbledhjes janë krijuar probleme për shkak të zhurmës nga jashtë (1/10), raste të lëvizjes së deputetëve nga një komision në tjetrin, si dhe raporte të problematikave formale, siç janë përdorimi i telefonave, etj.
7. Në **Komisionin e Politikës së Jashtme** dhe në **Komisionin e Integritimit Evropian** monitoruesit nuk konstatuan problematika serioze përveç rasteve të fillimit të mbledhjeve me vonesë, përdorimin e vazhdueshëm të celularëve gjatë debatit dhe debateve në disa raste edhe të personalizuara midis disa deputetëve.

### 7.1.1. TRENDI I KOMISIONEVE, NXITIM PËR TË MBYLLUR DEBATET DHE MBLEDHJET

Një nga tiparet e mbledhjeve të komisioneve të parlamentit është nxitimi i theksuar dhe i deklaruar kryesisht i drejtuesve të komisioneve për të kufizuar hapësirën dhe mundësinë e ndërhyrjeve, pyetjeve apo komenteve të deputetëve. Pretendimi i përhershëm, “duhet të nxitojmë”, “kemi axhendë të ngjeshur”, “nuk kemi kohë”, “mos të humbim kohë me detaje”, etj, gjenden me shumicë në procesverbalet e komisioneve, sidomos tek Komisioni i Ligjeve, i Ekonomisë, i Jashtëm, etj. Pothuajse në të gjitha rastet janë drejtuesit e komisionit ose ndonjë prej deputetëve mbështetës të tij, që propozojnë mbylljen e diskutimeve ose kufizimin e kohës për diskutim e ndërhyrje. Praktika të tilla ndonëse mund të kenë qëllim rritjen e efektivitetit të vendimmarrjeve në komisione, faktikisht e dobësojnë aktivitetin e



tyre, kufizojnë rolin e deputetëve dhe ndikojnë në uljen e efektivitetit dhe transparencës në vendimmarrjen finale.

### 7.1.2. KOMISIONI PËR EKONOMINË, REKORD PËR DREJTIM TË PERSONALIZUAR

---

Komisioni për Ekonominë dhe Financat shënon rekord në faktin se ndërhyrjet dhe diskutimet e kryetarit të Komisionit, Arben Ahmetaj, janë më të shumta sesa më shumë se 70% e anëtarëve të Komisionit të marrë së bashku. Në këtë komision kryetari mban rekord për numrin e pyetjeve, komenteve, deklarimeve, deri edhe relativitetin e akteve dhe praktikave të tjera teknike të punës së komisionit. Në disa raste ai madje i jep përgjigje pyetjeve të anëtarëve të Komisionit, një praktikë që duhej t'ua bënte i ftuari në mbledhje dhe jo kryetari. Drejtimi i personalizuar i këtij komision buron edhe nga fakti se kryetari ka qenë ministër paraardhës i Financave dhe iniciues i disa akteve që kanë qenë në axhendën e këtij komisioni gjatë 2019.

### 7.1.3. KOMISIONI PËR EDUKIMIN REKORD PËR SHKELJE ETIKE

---

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik mban rekordin e incidenteve, gjuhës së papërshtatshme në komunikim dhe për konfliktin midis kryetares dhe zv/kryetares në drejtimin e tij. Në asnjë komision tjetër nuk ka pasur gjatë katër muajve të fundit më shumë incidente dhe gjuhë jo etike komunikimi, sesa tek komisioni që duhet të ishte model i etikës në komunikim, për shkak se mbulon edukimin, arsimin e lartë, botën akademike dhe median, - sektorë me rol të rëndësishëm në formësimin e etikës dhe kulturës së komunikimit në një shoqëri. Në këtë komision ka pasur së paku dy raste kur drejtuesi ka braktisur mbledhjen në shenjë proteste, raste të fyerjes midis deputetëve, midis të ftuarve dhe deputetëve pjesëmarrës, raste të sjelljes arrogante nga deputetët ndaj zyrtarëve të lartë të ftuar ashtu edhe anasjelltas, nga ministra e zyrtarë të lartë të ftuar ndaj komisionit dhe drejtuesve të tij.


## 7.2. TRANSPARENCA E MUNGUAR: 44% E PROCESVERBALEVE, JO PUBLIKE

---

Rregullorja e Kuvendit detyron institucionin të bëjë publike periodikisht të gjitha procesverbalet e seancave plenare, të mbledhjeve të Komisioneve të Përhershme, të Posaçme, Komisioneve Hetimore, nën komisioneve si dhe të strukturave drejtuese të Kuvendit (Konferenca e Kryetarëve dhe strukturat e tjera). Me përjashtim të dy seancave në Komisionin e Sigurisë Kombëtare, të cilat janë konsideruar zyrtarisht të mbyllura për publikun për shkak të përmbajtjes së tyre me të dhëna sekrete, 98% e mbledhjeve do të duhej të ishin publike.

Nga të dhënat e verifikuara në javën e parë të muajit janar 2020, rezulton se Kuvendi nuk ka publikuar 44% të të gjitha mbledhjeve të komisioneve, një shifër shumë e lartë dhe po ashtu, e dhënë e dukshme kritike për mungesën e transparencës dhe llogaridhënies. Publikimi i dokumenteve të mbledhjeve dhe procesverbaleve të tyre do të ishin bazë referimi në media dhe bazë informimi për çdo individ apo institucion të interesuar, sidomos kur lidhen me mbledhje në të cilat janë marrë vendime të rëndësishme politike apo ekonomike. Mospublikimi i tyre në vazhdimësi krijon deficit demokratik. Argumenti i Kuvendit, se volumi i madh i punës nuk përballohet me ngarkesën e stafit aktual, është relative dhe nuk përbën justifikim, për sa kohë shifra 44% tregon për një gjendje jo normale dhe se vetë Kuvendi ka mekanizma të shumtë në dispozicion për të angazhuar individë e mjete për respektimin e detyrimit ligjor dhe standardeve të transparencës.





Referuar të dhënave konkrete, siç rezultojn edhe nga tabela bashkëngjitur, Komisioni i Veprimtarive Prodhuese ka përqindjen më të lartë të procesverbaleve të papublikuara (82%), ndjekur nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave (68%) dhe Komisioni Hetimor ndaj Presidentit (67%), por me dallim nga numrat e mbledhjeve, i pari 17 dhe i dyti 4 procesverbale. Vetëm Komisioni i Sigurisë Kombëtare ka përqindje mospublikimi më të ulët sesa 20%, ndërkohë që të gjitha komisionet e tjera, përfshirë Komisionin e Ligjeve, janë mbi 25% deri në 50% mospublikime.

### 7.3. KOMISIONET, MANGËSI ME DOKUMENTACIONIN ONLINE

Nga monitorimi i dokumentacionit parlamentar për publikun dhe përputhshmëria e tij me detyrimet që burojnë nga Rregullorja e Kuvendit, rezultojn se vijohet të ketë standarde të dyfishta dhe boshllëqe të dukshme. Për shembull, një numër aktesh të rëndësishme të parlamentit nuk janë shoqëruar me dokumentacionin përkatës me interes për publikun. Ja të dhënat ilustruese për së paku 5 raste, nga një numër shumë i madh rastesh të konstatuara:

- Tek vendimi “Për një shtesë në objektin e veprimtarisë së komisionit hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij, lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve në organet e qeverisjes vendore”, ngritur me vendimin e kuvendit nr. 84/2019” nuk ka relacion të Komisionit përgjegjës;
- Tek vendimi për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” nuk ka relacion të komisionit përgjegjës;
- Tek Rezoluta “Shmangia e krizës kushtetuese me synim legjitimitetin e Gjykatës Kushtetuese - detyrë imperative e organeve më të larta të shtetit” mungon kërkesa dhe raporti i komisionit përgjegjës;
- Tek propozimi “Për pezullimin nga detyra të një anëtari të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë” mungon relacioni i komisionit përgjegjës;
- Tek dokumentacioni rreth zgjedhjes së kreut të AKEP nuk ka CV publike, etj.






#### 7.4. MË PAK SE NJË E TRETA E DEPUTETËVE, AKTIVË NË KOMISIONE

Një e dhënë interesante e angazhimit parlamentar është zhvillimi i debateve dhe diskutimeve në mbledhjet e komisioneve e përhershme në Kuvend. Tradicionalisht deputetët që diskutojnë në komisione duhet të kenë përgatitje dhe të dhëna paraprake për projektligjet apo aktet e tjera në diskutim, të marrin të dhëna, të kenë formim të përafërt me fushën e diskutimit dhe aftësinë e trajtimit të problematikave në komisione.

Nga të dhënat e muajve tetor-nëntor 2019, kohë kur pjesa më e madhe e komisioneve kanë bërë publike edhe procesverbalet e plota të mbledhjeve, rezulton se ka një shpërndarje disproporcionale të angazhimit të deputetëve në komisione.




Komisioni me më shumë debate është ai i Edukimit dhe Medias me 32%, kjo kryesisht jo vetëm për shkak të debateve mbi paketën anti-shpifje, por edhe për shkak të mosmarrëveshjeve midis vetë drejtuesve të komisionit. Komisioni i dytë me më shumë debate është Komisioni i Jashtëm me 30% diskutime, kryesisht edhe për shkak se debatet kanë qenë të fokusuar në procesin e integritetit dhe rezolutën e iniciuar nga PS për ndikimet e huaja në Shqipëri.

Dy komisione, ai për Ekonominë dhe ai për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin kanë të njëjtën përqindje diskutimesh, 27%, ndjekur nga Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë me 24%. Tri komisionet me përqindjen më të ulët të pjesëmarrjes së deputetëve në diskutime janë ai i Sigurisë me 23%, ai i Integritetit Europian me 22% dhe me numër rekord negativ Komisioni i Ligjeve me vetëm 18%. Kjo shifër do të thotë se ka pasur diskutime në nivel proporcional vetëm nga rreth 1 në 6 deputetë anëtarë të Komisionit. Komisioni i Ligjeve mban edhe peshën kryesore të punës së komisioneve të Kuvendit, ndaj niveli minimal i angazhimit të anëtarëve në diskutime përbën shqetësim për cilësinë e filtrit ligjor dhe mangësitë në formimin real juridik të një pjese të komisionit.

## 7.5. ANGAZHIMI NË KOMISIONE, GRATË DEPUTETE 2% MË AKTIVE SESA BURRAT

Të dhënat krahasuese tregojnë se grupi i deputetëve të PS-së ka pasur angazhime në përqindje më të larta në komisione, sesa grupet e tjera në parlament. Konkretisht, socialistët kanë shënuar angazhime në nivel vlerësimi mesatar prej 10,5 nga 20 pikë maksimale në punën e komisioneve. Grupi i dytë më aktiv i përket grupit tashmë të shpërbërë të Partive të Djathta me 9,6 dhe në vend të tretë me vlerësim të njëjta Grupi Demokrat dhe Grupi i Pavarur i deputetëve, mbi 90% e të cilëve janë prurje të reja parlamentare gjatë gjysmës së parë të vitit 2019.



Në nivelin e krahasimit të angazhimit të deputetëve në komisione (pjesëmarrje, debate, diskutime, pyetje, relatorë, etj), rezulton se gratë deputete kanë nivel shumë të lartë angazhimi në raport me grupet parlamentare dhe 2% më shumë se deputetët meshkuj. Konkretisht gratë deputete shënuan një koeficient mesatar angazhimi në komisione prej 11,4 pikë nga 20 të mundshme, në raport me vetëm 9,4 të deputetëve meshkuj në parlament. Ky është një tregues cilësor për prezantimin e grave deputete, i aftësive të tyre për të trajtuar problematikat e ndryshme ligjore në komisione, si dhe i shfrytëzimit prej tyre të mekanizmave të angazhimit në komisione për promovim politik.

## 8. VOTA E DEPUTETËVE: GJETJET MË KRYESORE NË ÇDO KATEGORI

Për shkak të veçorisë në përbërjen aktuale parlamentare grupi monitorues ka analizuar edhe votën e deputetëve, kryesisht votën pro, kundër dhe abstenim, si dhe pjesëmarrjen në votime në seancat plenare për të krijuar korrelacion midis votës dhe identifikimit politik të deputetëve. Të dhënat paraprake tregojnë se një numër deputetësh mjaft aktivë në fjalimet parlamentare dhe aktivitetin parlamentar nuk kanë patur interes dhe nuk kanë marrë pjesë rregullisht në votimin e akteve në parlament, ku bën pjesë edhe kryeministri. Ndërkohë që ka deputetë që nuk kanë marrë pjesë në asnjë prej votimeve në Kuvend në katër muajt e fundit, ndonëse kanë qenë aktivë në diskutime dhe në debatet parlamentare në seancë.

### 8.1. IKJA NGA VOTIMI NË SEANCË, SHIFËR REKORD NGA DISA DEPUTETË

Në sesionin e fundit parlamentar statistikat tregojnë se ka deputetë që nuk kanë votuar asnjë prej vendimeve publike të Kuvendit (ligje, vendime, rezoluta, procese zgjedhore të hapura, etj). Rasti më tipik është ai i deputetit E.Piciri, i cili nuk ka votuar asnjë prej akteve parlamentare në katër muajt e fundit. Votimi i akteve në politikë në vendet me demokraci funksionale ka të bëjë me identitetin dhe pozicionin politik, ndërkohë që në praktikën e vendeve me demokraci të brishtë politikanët e shprehin identitetin dhe pozicionin e tyre kryesisht përmes fjalimeve publike, jo përmes votës.

Mënjanimi i pjesëmarrjes në votim mund të lexohet edhe si ikje nga përgjegjësia. Në rastin tonë mund të ketë arsye të tjera që kanë çuar në vendimin e disa deputetëve për të mos marrë pjesë në shumicën e votimeve në parlament. Kështu për shembull, tabela bashkëngjitur ilustron deputetët sipas përqindjes së mospjesëmarrjes në votim (refuzim personal, udhëtimet jashtë vendit, problematikat politike apo edhe mungesa e interesit për të votuar).


DEPUTETËT QË KANË VOTUAR MË PAK AKTE NË KUVEND		
NR	EMRAT E DEPUTETËVE	NUK VOTOI (%)
01	ERION PICIRI	100%
02	LEFTER KOKA	98%
03	ADRIATIK ALIMADHI	82%
04	MYSLIM MURRIZI	82%
05	ENADA KAPLLANI	80%
06	EDI RAMA	79%
07	ELDA HOTI	62%
08	AMRA BAROVA	61%
09	RUDINA HAJDARI	59%
10	FATJONA DHIMITRI	56%
11	FATMIR VELAJ	54%
12	GJETAN GJETANI	54%
13	KOÇI TAHIRI	51%



Në krye të tabelës qëndron deputeti E.Piciri, i cili nuk ka marrë pjesë në votimin e 100% të akteve në parlament, ndjekur nga deputeti L.Koka me 98% mospjesëmarrje, si dhe dy deputetët aktivë të opozitës, M.Murrizi e A.Alimadhi me nga 82% mospjesëmarrje në votimin e akteve. Shifër të përafërt mospjesëmarrje në votime kanë edhe deputetja e re E.Kapllani me 80%, thujse identike me përqindjen e mospjesëmarrjes në votim nga vetë kryeministri E.Rama. Në total janë 15 deputetë që nuk kanë marrë pjesë në votimet e akteve të parlamentit në mbi 50% të rasteve, shifër shumë e lartë për një parlament me vetëm 13 seanca plenare në katër muaj.

## 8.2. KRYEMINISTRI RAMA VOTOI VETËM 21% TË NISMAVE LIGJORE TË QEVERISË SË TIJ

Kryeministri E.Rama vijon të mos jetë mbështetës me votë në parlament për nismat ligjvënese që vijnë me firmën e tij në pozitën e kreut të ekzekutivit. Duke mos u shqetësuar për mungesën e opozitës së organizuar parlamentare dhe duke gëzuar mbështetje të fortë brenda grupit të tij parlamentar, ai nuk merr pjesë pothuajse në 4/5 e votimeve në parlament. Gjatë sesionit të fundit parlamentar kryeministri ka mbajtur vetëm 5 fjalime në 13 seancat parlamentare, megjithatë ai ka votuar vetëm 21% të akteve në parlament. Nga kjo shifër, E.Rama ka votuar 20% pro nismave të mazhorancës së drejtuar prej tij dhe në një rast kundër (nisma e deputetit Ilir Beqaj) një nismë të deputetit të listës së tij partiake. Kryeministri nuk ka abstenuar asnjëherë, ndërkohë që nuk ka marrë pjesë në 79% të votimeve në parlament.



## 8.3. OPOZITA, 60% E TYRE PRO AKTEVE NË KUVEND

Nga të dhënat e votave të deklaruara nga deputetët në faqen e Kuvendit rezultojnë se opozita aktuale në parlament është treguar shumë më konstruktive ndaj mazhorancës së grupet e tjera opozitare të fillimit të kësaj legjislature apo të legjislaturës së kaluar. Në total, më shumë se 61% e deputetëve të opozitës kanë votuar pro në rreth 60% të akteve të kaluara në Kuvend. Përveç tre deputetëve me 100% të votave pro në rastet kur kanë marrë pjesë në votim, ka një numër të madh deputetësh me votë pro në më shumë se 80% të rasteve të votimit në parlament, ku bëjnë pjesë E.Rrushi e E.Bojaxhiu me nga 86%, Y.Shehu me 85%, N.Musaj me 82%, A.Roshi e V.Sterjovski me nga 81%, të ndjekur më pas nga S.Jenishehri me 79%, E.Stojku me 78% dhe A.Mara me 76%.

Vota konstruktive e opozitës nuk është përkthyer në një klimë më konstruktive në parlament, pasi asnjë nga nismat ligjore të opozitës nuk ka gjetur mbështetje parlamentare të shumicës, megjithatë, është tregues i ndryshimit nga politika thellësisht konfliktuale e dy legjislaturave të fundit. Nga ana tjetër, opozita aktuale është e fragmentarizuar dhe më shumë kemi të bëjme më zgjedhje e preferenca personale të shumicës së deputetëve, sesa me qëndrime kolektive dhe të kalkuluar politike.

<b>DEPUTETËT OPOZITARË ME MË SHUMË VOTA PRO NË VOTIMET NË SEANCAT PLENARE</b>			
<i>EMRAT E DEPUTETËVE</i>	<i>VOTË PRO</i>	<i>EMRAT E DEPUTETËVE</i>	<i>VOTË PRO</i>
ENADA KAPLLANI	100%	AURORA MARA	76%
LEFTER KOKA	100%	RAMAZAN GJUZI	74%
MYSLIM MURRIZI	100%	RALF GJONI	73%
EDIOLA BRAHA	90%	EDLIRA HYSENI	72%
EDMOND RRUSHI	86%	BESNIK TROPLINI	70%
EUGEN BOJAXHIU	86%	MAJLINDA HALILAJ	68%
YLLI SHEHU	85%	HALIT VALTERI	68%
NIMET MUSAJ	82%	RUDINA HAJDARI	68%
ENVER ROSHI	81%	ARTUR ROSHI	67%
VASIL STERJOVSKI	81%	FATJONA DHIMITRI	67%
SELAMI JENISHEHRI	79%	KRENAR RRYÇI	67%
EDMOND STOJKU	78%	ARLIND ÇAÇANI	66%

#### **8.4. ALIMADHI 73% VOTË “KUNDËR”, 4 DEPUTETË ME 0% VOTA “KUNDËR”**

Një analizë interesante është edhe deklarimi publik i votës kundër nismave të mazhorancës në parlament. Tradicionalisht votat kundër janë të opozitave politike, në rastin tonë vota kundër është më specifike dhe më individuale. Disa nga deputetët më aktivë opozitarë nuk janë pjesëmarrës të rregullt në votime, duke figuruar edhe me përqindje të ulët të votës “pro” apo “kundër”, ndërkohë që deputetë kryesisht të rinj të ardhur rishtas më 2019 janë më të dallueshëm në këtë sjellje politike.

Konkretisht, deputeti me më shumë vota kundër akteve të mazhorancës dhe të qeverisë është kryetari i PBK A.Alimadhi, me 73% të votave kundër, me diferencë prej 15% nga vendi pasues në tabelë. Në listë me përqindje të lartë të votave kundër janë edhe deputetët përbërës të Grupit “Demokrat” si A.Elezi, K.Lita, A.Zeneli apo H.Jakimi me përkatësisht 42% deri në 58% vota kundër. Edhe emrat vijues në listë janë prurje të reja të pranverës 2019 nga listat proporcionale të PD e LSI, pjesë përbërëse të grupit të Pavarur apo të deputetëve pa grup parlamentar.

Nga ana tjetër kemi listën e deputetëve që nuk kanë asnjë votë “kundër” dhe atyre që kanë më pak se 11% vota “kundër” në aktet katër-mujore të Kuvendit. Disa prej tyre kanë përqindje të ulët të votës kundër edhe për shkak se kanë përqindje të lartë të mospjesëmarrjes në votim, ndaj edhe përqindja në tabelë tregon vetëm rastet e prezencës së tyre aktive në votimet në parlament. Sic shihet nga tabela janë katër deputetë me 0% vota kundër në katër muaj në parlament, ku bëjnë pjesë dy deputetë të rinj dhe dy deputetë të karrierës. Po ashtu në listë me përqindje minimale të votës kundër gjenden edhe Kryeministri e Zv/Kryeministri E.Braçe (në 8% të rasteve), ministrat B.Klosi e O.Manastirliu, deputetë të mazhorancës dhe të prurjeve të reja në Kuvend.



Në total deputetët e PS kanë votuar kolektivisht kundër në 12 prej 61 akteve në parlament, ndaj edhe vota e përfaqësuesve të mazhorancës lidhet pikërisht me këto raste, të cilat ose janë nisma ligjvënëse të opozitës ose të ndonjë deputeti pa miratimin politik brenda mazhorancës.

<b>DEPUTETËT ME MË SHUMË / PAK VOTA KUNDËR NË VOTIMET E AKTEVE NË PARLAMENT</b>			
<i>EMRAT E DEPUTETËVE</i>	<i>VOTË KUNDËR</i>	<i>EMRAT E DEPUTETËVE</i>	<i>VOTË KUNDËR</i>
ADRIATIK ALIMADHI	73%	ENADA KAPLLANI	0%
ARBEN ELEZI	58%	ERION PICIRI	0%
KORAB LITA	55%	LEFTER KOKA	0%
ALBAN ZENELI	53%	MYSLIM MURRIZI	0%
HALIL JAKIMI	42%	YLLI SHEHU	6%
NIKOLIN STAKA	42%	KLOTILDA BUSHKA	6%
ZEF SHTJEFNI	42%	OGERTA MANASTIRLIU	6%
LIGORAQ KARAMELO	41%	KOSTAQ PAPA	7%
ANDI PËRMETI	39%	EDIOLA BRAHA	7%
ELDA HOTI	35%	EDI RAMA	8%
ARLIND ÇAÇANI	34%	EDMOND RRUSHI	8%
FATJONA DHIMITRI	33%	ERION BRAÇE	8%
GJETAN GJETANI	32%	TATIANA PIRO	8%
RUDINA HAJDARI	32%	ERVIS MEÇO	9%
SUZANA TOPI	32%	BLENDI KLOSI	10%
HALIT VALTERI	32%	FATMIR VELAJ	11%

## 8.5. DEPUTETËT E RINJ “ABSTENUES”, KRYESJNË GJUZI, PAPA E MEÇO

Vetëm 34 nga 122 deputetë kanë zgjedhur të abstenojnë në një ose disa nga 61 votimet e akteve ligjore në Kuvend gjatë sesionit të fundit parlamentar. Në krye të listës së abstenuesve është deputeti K.Gjuzi me 60% të votave abstenuese, i njohur për ligjërimit dhe sjelljen e tij kontroverze në parlament, ndërsa në fund të listës është deputeti i mazhorancës F.Xhafaj me vetëm 2% të votave abstenuese. Deputetët më abstenues të përfshirë në këtë tabelë janë të gjithë deputetë nga prurjet e reja parlamentare pas vendimit të opozitës për dorëzimin e mandateve parlamentare. Në listën e deputetëve me më shumë abstënime bëjnë pjesë deputetët me pak përvojë parlamentare si K.Papa e E.Meço, K.Qama e A.Barova, E.Hoti e S.Topi, si dhe deputetë me më përvojë parlamentare si L.Maliqi, L.Karamelo apo E.Xhina.

<b>DEPUTETËT E OPOZITËS ME MË SHUMË VOTA ABSTENUESE NË PARLAMENT</b>		
<i>EMRAT E DEPUTETËVE</i>	<i>GRUPI</i>	<i>VOTË ABSTENIM</i>
KUJTIM GJUZI	PA GRUP	60%
KOSTAQ PAPA	PED	49%
ERVIS MEÇO	PED	35%
KLAJDI QAMA	PA GRUP	26%
LEFTER MALIQI	PA GRUP	24%
AMRA BAROVA	PAV	17%
ELDA HOTI	PAV	13%




## 9. SEANCAT PLENARE: BILANCI I FJALIMEVE, TEMATIKAVE DHE DEBATIT

Seancat plenare përbëjnë aktivitetin më të rëndësishëm publik të deputetëve. Ata diskutojnë, votojnë, propozojnë dhe mbajnë qëndrime politike, të cilat kanë impakt në perceptimin publik ndaj tyre, në karrierën politike në parti dhe në raportet me elektoratin që përfaqësojnë. Grupi monitorues është përpjekur të analizojë jo vetëm diskutimet numerike të deputetëve, por edhe përmbajtjen e tyre për të kuptuar më mirë se sa efektiv dhe përfaqësues kanë qenë ata në raport me pritshmëritë e elektoratit dhe të funksionit që ushtrojnë.

### 9.1. PËR ÇFARË FLITET NË PARLAMENT?

Në dallim nga disa prej sesioneve të tjera parlamentare, në sesionin e fundit shtator-dhjetor 2019 nuk pati konsum të madh të replikave dhe retorikës politike të ditës. Replikat dhe debatet e ditës zunë vetëm 19%, nga të cilat çështjet zgjedhore të ditës 9% dhe çështje të zhvillimeve politike 10%. Problematika më e diskutuar ishte ajo që lidhej me buxhetin faktik 2019 dhe buxhetin e ri 2020, në total 20% e deputetëve diskutues.




Çështja e dytë më e diskutueshme lidhej me vendimin negativ të BE për Shqipërinë, lidhur me procesin integruar, (12%) po aq sa debati për çështjet rinore dhe ligjin e kthyer për rininë, apo problematikat e emigrimit dhe arsimit për të rinjtë. Reforma në drejtësi, sidomos debati mbi Presidentin dhe Gjykatën Kushtetuese zuri 11% e të gjitha fjalimeve. Problematika me kontratat e PPP morën 6% të kohës dhe ato që lidhen me Kodin Penal dhe legjislacionin penal, me sektorin mineral dhe me çështjen e sigurimeve për emigrantët zunë po ashtu 5% të numrit total të fjalimeve.


## 9.2. JAVA ELEKTORALE? VETËM 31% FOLËN PËR ZGJEDHËSIT

Gjatë sesionit parlamentar shtator-dhjetor 2019 pati dy seanca të veçanta të dedikuara për zgjedhësit dhe problematikën e tyre, një praktikë e re e mundësuar nga ndryshimi i Rregullores së Kuvendit në korrik 2019 (neni 40/1). Si e tillë kjo është një seancë me vlerë simbolike, por ishte edhe një test vlerësimi nëse zgjedhësit do të ishin sa duhet të përfaqësuar në fjalimet e deputetëve.

Nga të dhënat e stafit monitorues, në totalin e seancave për zonën elektorale morën pjesë vetëm 47% e deputetëve, prej të cilëve vetëm 63% e tyre u morën vërtetë me problematika të zonës zgjedhore apo grupeve të ndryshme qytetare. Në totalin e 112 deputetëve jo ministra rezultoi se folën për zonën elektorale dhe zgjedhësit vetëm 31% e deputetëve, pra më pak



se një në tre deputetë. Ndër deputetët që folën mbi problematika konkrete të zonës elektorale dhe zgjedhësve ishin A. Marto, A. Xhembulla, A. Dhima, B. Çela, E. Felaj, F. Ylli, J. Çyrbja, K. Spahiu, I. Beqaj, F. Nasufi, Xh. Qefalia, A. Jaku, A. Konomi, E. Hoti, E. Hysko, E. Hyseni, V. Sinaj, M. Murrizi, L. Nikolla, R. Lala, S. Mesi, A. Roshi, E. Spaho, E. Bojaxhi, K. Tahiri, K. Qama, L. Karamelo, N. Musaj, S. Topi, V. Sterjovski, V. Bello, Z. Shtjefni, E. Hoxha, I. Beqiraj, H. Jakimi, dhe pjesërisht ndonjë deputet tjetër si R. Hajdari, K. Papa, B. Troplini, T. Nurce, etj, mbi problematika specifike të grupeve të ndryshme të interesit. Disa prej deputetëve nuk kanë zonë fiksë elektorale ndaj edhe evitojnë prezantimin në emër të një zone të caktuar, disa të tjerë kanë ndryshuar zonën në varësi nga vendimi politik i partisë së tyre, ndërkohë që ka një numër të vogël deputetësh që më shumë mërret me zonën e vet sesa me aktivitet parlamentar publik në parlament.



Pjesa më e madhe e deputetëve (53% nuk mori pjesë në debat, kurse ndër ata që morën pjesë në debat pati deputetë që morën kohën në dispozicion për të bërë deklarata politike lidhur me zhvillime politike të ditës apo fjalime të përgjithshme pa një fokus e objekt konkret. Në total 14% e deputetëve folën në




këto seanca u morën me çështje të përgjithshme dhe jo me zonën, kurse 23%, kryesisht të mazhorancës, u morën me pasojat e tërmetit të shtator dhe problematika të administrimit të pasojave të tij.

Për shembull, pothuajse mbi 15 deputetët folës të mazhorancës u fokusuan tek tërmeti i shtatorit dhe masat e marra nga qeveria dhe ata vetë për normalizimin e gjendjes edhe pse tërmeti kishte pasojë vetëm në një qark nga 12 qarqet e vendit. Ata të gjithë cituan shifra dramatike të dëmeve dhe të banesave të dëmtuara, dhe siç ndodh gjithnjë kur je në qeveri, të gjithë lavdëruan pa fund reagimin e institucioneve dhe mekanizmin e emergjencave civile. Nga debatet krijohet përshtypja se Shqipëria e ka zgjidhur tashmë përfundimisht problematikën e reagimit të shpejtë, të parandalimit dhe të bashkëpunimit institucional. Madje një pjesë e diskutuesve deklarojnë se situata u menaxhua aq mirë sa nuk është më problem kryesor tërmeti i 21 shtatorit dhe pasojat e tij, por shqetësim kryesor për qytetarët është debati politik midis qeverisë e presidentit apo midis mazhorancës dhe opozitës.

Nga deputetët e tjerë, shumica e individëve politikë jashtë mazhorancës ia dedikuan fjalimet e tyre zhvillimeve politike në vend dhe vetëm një pjesë e vogël e tyre u fokusua tek thelbi i seancës për zgjedhësit, tek problematikat lokale dhe shqetësimet e banorëve të zonave që përfaqësojnë. Tre deputetëve, (K.Papa,H.Valteri dhe F.Dhimitri) iu tërhoq vëmendja për shkelje të Kodit të Etikës, për shkak të gjuhës së përdorur në diskutimin e tyre.

### 9.3. “HESHTËN” OSE “FOLËN” VETËM NJË HERË, RRETH 45% E PARLAMENTIT

Të dhënat e angazhimit të deputetëve në seancat plenare gjatë periudhës shtator-dhjetor 2019 nxjerrin në pah nivelin minimal të angazhimit të shumicës së deputetëve. Në total 24% e deputetëve ose 27 deputetë (duke lënë jashtë listës ministrat dhe Kryetarin e Kuvendit) nuk kanë folur në asnjë prej seancave plenare, 21% kanë pasur vetëm nga një fjalim në parlament dhe 20% kanë pasur maksimumi nga dy fjalime në 13 seancat plenare të parlamentit.



Së bashku, rreth 65% e deputetëve kanë pasur nga 0-2 fjalime dhe 45% nga 0-1 fjalim në parlament, e dhënë kritike për nivelin e angazhimit në parlament të deputetëve sidomos në rrethana të reja procedurale, kur parlamenti mundëson seanca të hapura dedikuar problematike elektorale dhe zonale.



Nga ana tjetër deputetët me 10 dhe 11 fjalime zënë përkatësisht 8% të numrit total të deputetëve dhe ata midis 8-11 fjalimeve zënë vetëm 10% të totalit të deputetëve folës në seancat parlamentare.

#### 9.4. “ORATORËT” KRYESORË NË SEANCË, DOMINUES PRURJET E REJA

Në dallim të madh nga sesioni i kaluar parlamentar gjatë këtij sesioni deputetët e ardhur në parlament nga listat proporcionale të PS e LSI ishin shumë më tepër aktiv në debatet në seancat plenare sesa deputetët tradicionalë dhe me më shumë mandate parlamentare. Preferenca për të qenë aktiv në debatet në seancë lidhet me nevojën e tyre për të përfituar nga prania e medias dhe vëmendja publike, por edhe është një formë reflektimi ndaj kritikave të vazhdueshme rreth aftësisë së tyre për të zhvilluar aktivitet politik e parlamentar.

Në krye të listës me më shumë diskutime në parlament janë katër deputetë, - deputeti A.Roshi, njëherësh kryetar i Ballit Kombëtar Demokrat, deputeti i ri H.Valteri, deputeti K.Papa dhe deputeti N.Musaj, tre të ardhur nga lista proporcionale e PD dhe një nga lista proporcionale e LSI. Musaj është i vetmi midis tyre që drejton edhe një grup parlamentar dhe për pasojë, ka akses më të madh në debatet dhe procedurat parlamentare.

#### TIPARET E NË SEANCAT PLENARE

*Në zhvillimin e seancave plenare monitoruesit konstatuan se rreth 5 deputetë që kishin regjistruar emrin për diskutim nuk ishin në sallë në momentin e diskutimit (12/9), një ish ministër relaton në emër të komisionit në parlament një nismë që ka iniciuar vetë nga pozita e mëparshme, (12/9), përdorimi i gjuhës jo etike e jo parlamentare (12/9, 3/10, 17/10, 4/11, 28/10, 5/12, etj), kërkesa për të folur për procedurë por që kalojnë në çështje politike të ditës (12/9), ka mospërputhje midis numrit të deputetëve votues dhe atyre prezent në momentin e votimit (3/10, 5/12), ndërprerje e shkurtër e seancës pas një grindjeve personale midis një deputeti dhe një ministri (17/10), etj.*

#### DEPUTETË ME MË FJALIME NË SEANCAT PLENARE SHTATOR-DHJETOR 2019

NR	EMRI I DEPUTETËVE	GRUPI	FJALIME	NR	EMRI I DEPUTETËVE	GRUPI	FJALIME
01	<b>ARTUR ROSHI</b>	PA GRUP	<b>11</b>	12	<b>ANTONETA DHIMA</b>	PS	<b>7</b>
02	<b>HALIT VALTERI</b>	DEM	<b>11</b>	13	<b>ARBEN AHMETAJ</b>	PS	<b>7</b>
03	<b>KOSTAQ PAPA</b>	PED	<b>11</b>	14	<b>ENVER ROSHI</b>	PAV	<b>7</b>
04	<b>NIMET MUSAJ</b>	PAV	<b>11</b>	15	<b>KUJTIM GJUZI</b>	PA GRUP	<b>7</b>
05	<b>MYSLIM MURRIZI</b>	DEM	<b>10</b>	16	<b>EDLIRA HYSENI</b>	PAV	<b>6</b>
06	<b>RALF GJONI</b>	PAV	<b>10</b>	17	<b>ELDA HOTI</b>	PA GRUP	<b>6</b>
07	<b>RUDINA HAJDARI</b>	DEM	<b>10</b>	18	<b>ILIR BEQAJ</b>	PS	<b>6</b>
08	<b>TAULANT BALLA</b>	PS	<b>10</b>	19	<b>LEFTER MALIQI</b>	PA GRUP	<b>6</b>
09	<b>ZEF SHTJEFNI</b>	PED	<b>9</b>	20	<b>VASIL STERJOVSKI</b>	PA GRUP	<b>6</b>
10	<b>KORAB LITA</b>	DEM	<b>8</b>	21	<b>VULLNET SINAJ</b>	PS	<b>6</b>
11	<b>HALIL JAKIMI</b>	DEM	<b>7</b>				




Pas tyre në listë është zv/kryetari i Kuvendit M.Murrizi, deputeti R.Gjoni, kryetarja e grupit “Demokrat” R.Hajdari dhe kryetari i Grupit të PS T.Balla, të katër mjaft aktivë në këtë sesion parlamentar. Diferencat në numra fjalimesh janë minimale dhe pa domethënie ndaj faktit se për shkak të pozitës dhe pritshmërive publike ndërhyrjet e tyre vazhdimisht kanë pasur impakt parlamentar dhe janë shndërruar në lajme mediatike.

Në listën e surprizave janë edhe përfshirja e deputetëve Z.Shtjefni, K.Lita, H.Jakimi etj, në listën e 11 deputetëve me më shumë fjalime në parlament, për të vijuar me deputetët tradicionale të vlerësuar si A.Dhima e A.Ahmetaj nga Partia Socialiste. Siç shihet nga tabela, në 21 deputetët më të angazhuar në debatet parlamentare nuk bëjnë pjesë shumë prej emrave të njohur të politikës, përfshirë shtatë nga tetë kryetarët e komisioneve parlamentare.

### 9.5. ANGAZHIMI NË SEANCË PLENARE, KRYESON GRUPI “DEMOKRAT”

Analiza e angazhimit të deputetëve në seanca plenare (diskutime, ndërhyrje, referime, etj) gjatë periudhës shtator-dhjetor 2019 tregon se deputetët e rinj të ardhur gjatë vitit 2019 dhe dy deputetët e mbetur në parlament nga ish deputetët e opozitës i kanë kushtuar vëmendje të veçantë prezencës më të madhe mediatike në parlament, angazhimit publik dhe rritjen e nivelit të efikasitetit përmes këtyre aktiviteteve parlamentare. Konkretisht, Grupi “Demokrat” ka rezultatin më të lartë në mesataren e grupeve për angazhim në seancat plenare, 6 fjalime mesatare për deputet, në distancë të thellë nga grupet e tjera parlamentare.



Grupi më i madh parlamentar, ai i PS ka koeficientin më të ulët mesatar të angazhimit të deputetëve në fjalime në parlament, vetëm rreth 2 fjalime, - shifër e ulët në raport me mundësitë dhe hapësirën që ky grup ka në jetën parlamentare.

Gjithashtu edhe deputetët pa grup parlamentar, midis të cilëve bëjnë pjesë edhe ish-deputetët të PDIU, deputeti i PSD apo një ish deputet i PS i larguar nga grupi, ka mesatare minimale prej vetëm 2,6 fjalime për deputet. Dy grupet e tjera, ai “I Pavarur” dhe ai “Partive të Djathta” kanë pothuajse të njëjtin nivel angazhimi, 3,5 deri 3,7 fjalime për deputet, - rezultat shumë më i mirë në raport me PS, por në distancë të thellë nga mesatarja e Grupit “Demokrat”.

## 9.6. DEPUTETËT MË TË “SPONSORIZUAR” NGA PARTITË

Tradicionalisht grupet parlamentare promovojnë politikanë të veçantë, kryesisht përmes fjalimeve në emër të grupit në seancat plenare. Referuar të dhënave të tabelës së mëposhtme, rezulton se deputetët A.Ahmetaj, A.Dhima, E.Kushi, T.Balla, etj, janë më të promovuarit për diskutime në seancat plenare në emër të grupeve. Madje, në rastin e A.Ahmetaj, ai ka më shumë fjalime në emër të grupit, sesa si deputet me nismën e tij.

Qëndrimet në emër të grupit lidhen me ligje që vijnë nga komisionet, por në tërësi janë qëndrime politike dhe synojnë edhe të prezantojnë ekspertizë të veçantë ose imazh publik të veçantë nga ana e deputetit. Në listën e deputetëve diskutues rezulton se edhe të vetmet fjalime të mbajtura në Kuvend gjatë këtij sesioni parlamentar kanë qenë fjalime të promovuara në emër të grupit, për rastet e deputetëve, A. Alimadhi, B.Fino, etj.

DEPUTETËT ME MË SHUMË FJALIME NË EMËR TË GRUPIT POLITIK			
NR	EMRI I DEPUTETËVE	FJALIME	GRUPI
01	ARBEN AHMETAJ	5	PS
02	ANTONETA DHIMA	3	PS
03	EVIS KUSHI	3	PS
04	TAULANT BALLA	3	PS
05	ANDREA MARTO	2	PS
06	ARTEMIS DRALO	2	PS
07	EGLANTINA GJERMENI	2	PS
08	ERVIN BUSHATI	2	PS
09	NIMET MUSAJ	2	PAV
10	RUDINA HAJDARI	2	DEM
11	VASILIKA HYSI	2	PS

## 9.7. NË TOTAL 22% E DEPUTETËVE, “0” FJALIME NË 13 SEANCAT PLENARE

Në sesionin e fundit parlamentar vijon trendi i 20%-25% të deputetëve që nuk përfshihen në debatet parlamentare dhe një pjesë e tyre as nuk lënë as gjurmë në aktivitetin vendimmarrës parlamentar. Lista e mëposhtme përfshin deputetët që nuk kanë mbajtur asnjë fjalim në 13 seancat parlamentare të sesionit të vjeshtës 2019, disa prej të cilëve janë të njëjtë edhe më “të heshturit” e sesioneve të tjera parlamentare të kësaj legjislature.

Nga të dhënat e tabelës rezultojnë se bëjnë pjesë. 1 deputet nga Grupi “Demokrat”, 7 deputetë pa grup parlamentar, 5 deputetë nga Grupi i “Pavarur”, 2 deputet nga Grupi i “Partive të Djathhta” dhe 12 deputetë nga Grupi i PS-së. Në këtë të fundit bëjnë pjesë emra të njohur të politikës përfshirë bashkëkryetarin e Komisionit të Reformës Zgjedhore D.Gjikhuri (aktiv në Komision, por jo në seancë), deputeti me përvojë S.Braho (aktiv në media, por jo në parlament), si dhe deputetë të tjerë që kanë bërë “headline” në media gjatë këtij sesioni si Rr.Rraja, etj.



EMRAT E DEPUTETËVE ME “0” FJALIME NË SEANCAT PLENARE SHTATOR-DHJETOR 2019							
NR	EMRI I DEPUTETËVE	GRUPI	FJALIME	NR	EMRI I DEPUTETËVE	GRUPI	FJALIME
01	<b>ALBAN ZENELI</b>	DEM	0	15	<b>RAMAZAN GJUZI</b>	PED	0
02	<b>DRITAN BICI</b>	PA GRUP	0	16	<b>ARBEN KAMAMI</b>	PS	0
03	<b>EDMOND RRUSHI</b>	PA GRUP	0	17	<b>DAMIAN GJIKNURI</b>	PS	0
04	<b>EDMOND STOJKU</b>	PA GRUP	0	18	<b>EDMOND LEKA</b>	PS	0
05	<b>ELENA XHINA</b>	PA GRUP	0	19	<b>ILIRIAN PENDAVINJI</b>	PS	0
06	<b>GJETAN GJETANI</b>	PA GRUP	0	20	<b>LUAN HARUSHA</b>	PS	0
07	<b>NIKOLIN STAKA</b>	PA GRUP	0	21	<b>MIRELA KUMBARO</b>	PS	0
08	<b>TOM DOSHI</b>	PA GRUP	0	22	<b>NIKO PELESHI</b>	PS	0
09	<b>AMRA BAROVA</b>	PAV	0	23	<b>PAULIN STERKAJ</b>	PS	0
10	<b>AURORA MARA</b>	PAV	0	24	<b>ROBERT BITRI</b>	PS	0
11	<b>EDIOLA BRAHA</b>	PAV	0	25	<b>ROLAND XHELILAJ</b>	PS	0
12	<b>ENADA KAPLLANI</b>	PAV	0	26	<b>RAHMAN RRAJA</b>	PS	0
13	<b>YLLI SHEHU</b>	PAV	0	27	<b>SPARTAK BRAHO</b>	PS	0
14	<b>ERVIS MEÇO</b>	PED	0				

Në total janë rreth 22% të deputetëve që nuk janë e angazhuar në debatet në seancat plenare, përfshirë edhe në dy seancat që i janë dedikuar zgjedhësve dhe problematikave të zonave zgjedhore. Për disa prej tyre mospjesëmarrja në debatet parlamentare është kompensuar me pjesëmarrje aktive në mbledhjet e Komisioneve Parlamentare, por gjithsesi në listë ka emra të përhershëm që nuk preferojnë të jenë aktivë në debate dhe as protagonistë në seancat plenare.

Politikisht lista tregon edhe se cilët janë deputetët që nuk preferohen nga drejtuesit e grupeve parlamentare dhe për pasojë, nuk u delegohet e drejta për t’u promovuar në seanca në emër të grupit të vet politik. Po ashtu në listën e “të heshturve” në seancat plenare bëjnë pjesë edhe rreth 5-6 deputetë nga lista e 10-15 deputetëve me më shumë përfitim financiar nga trajtimi i funksionit të deputetit gjatë vitit 2019.



## 10. KLASIFIKIMI I EFIKASITETIT TË DEPUTETËVE 2019

Bazuar në metodologjinë e projektit, klasifikimi i nivelit të efikasitetit të deputetëve, bazohet:

- në vlerësimin e nismave ligjore të deputetëve (10 pikë),
- në vlerësimin e propozimeve për ndryshime ligjore gjatë debatit në komisione ose në seancën plenare (10 pikë),
- në vlerësimin e interpelancave të iniciuara nga deputetët (10 pikë),
- në vlerësimin e angazhimit në seancat plenare (20 pikë),
- në vlerësimin e angazhimit në komisionet parlamentare (20 pikë),
- në vlerësimin e votimit të akteve në Kuvend (10 pikë),
- në vlerësimin e aktivitetit parlamentar për kërkesa / informacion ose seanca pyetjesh (10 pikë),
- si dhe në angazhimin publik e në zonë të deputetëve (10 pikë).

Deputetët që janë penalizuar në shkelje të Rregullores së Kuvendit penalizohen edhe në klasifikimin e nivelit të efikasitetit (me - 10 pikë). Në rastin aktual nuk kemi pasur penalizime, por kemi pasur tërheqje vëmendje dhe një protestë publike ndaj deputetit M.Murrizi, i cili për këtë arsye ka marrë një vlerësim negativ me 5 nga 10 pikë maksimale.

Në realizimin e klasifikimit ia vlen të theksohet se të dhënat e grupeve të monitorimit mbi aktivitetin e komisioneve parlamentare, por edhe të dhënat mbi debatet në seancat plenare tregojnë forcimin e fenomenit të promovimit procedural të një grupi deputetësh nga ana e drejtuesve të grupit, - duke krijuar idenë e rritjes së efikasitetit parlamentar të tyre. Për shembull, të dhënat mbi deputetët që flasin në emër të grupeve parlamentare në seancat plenare ose në komisione, ashtu edhe të dhënat që disa deputetë ftohen formalisht të jenë nënshkrues të nismave ligjore, të cilat *de facto* vijnë nga institucione të tjera, siç është shumica e paketës së ligjeve të reformës në drejtësi, - tregojnë se secila kryesi e grupeve parlamentare ka preferencat dhe prioritetet e veta në promovimin e deputetëve.

### 10.1. DEPUTETËT MË EFEKTIVË: BALLA, HAJDARI, AHMETAJ DHE ROSHI

Klasifikimi i deputetëve në renditjen përfundimtare reflekton zhvillimet e përgjithshme në Kuvend, ku deputetë të rinj të ardhur në parlament më 2019 u përpoqën të jenë shumë më aktiv në debatet në seancat plenare dhe në komisione, si dhe të shfrytëzojnë në maksimum të drejtat e deputetit për interpelancë, kërkesa për informacion, propozime ligjore, etj.

Në vlerësimin e përgjithshëm kreu i grupit të PS Taulant Balla vijon të jetë deputeti me pikët më të larta në klasifikim. Ai ka iniciuar ligje, ka adresuar kërkesa për informacion, ka marrë pjesë në debatet plenare dhe në komisione (në dallim nga ish kryetarët e grupeve parlamentare në legjislaturat e kaluara, të cilët në mbi 90% të rasteve nuk merrnin pjesë në mbledhje të komisioneve), si dhe ka ushtruar në maksimum të drejtat e deputetit. Ai është i privilegjuar edhe për shkak se, si drejtues i grupit ka hapësirë, mundësi dhe mekanizma shumë më të mëdha për të qenë aktiv në jetën parlamentare.

Në katër deputetë me rezultatin më të lartë në klasifikimin e efikasitetit bën pjesë edhe deputetja Rudina Hajdari, drejtuese e Grupit "Demokrat", e cila vijon të ruajë përfaqësimin sasior dhe të rrisë atë cilësor në raport me sesionin e kaluar parlamentar. Ajo ka pjesëmarrje aktive në debate në seanca dhe në komision, ka nisma ligjore dhe amendime, ka kërkesa për interpelancë dhe për informacion, si dhe



është aktive në Komisionin e Reformës Zgjedhore dhe në debatet publike. Vlerësim të lartë ka edhe kreu i Komisionit të Ekonomisë, ministri më i ri i kabinetit qeveritar, Arben Ahmetaj. “Surprizë” pozitive përbën angazhimi dhe rezultati i arritur në këtë sesion nga deputeti Artur Roshi, i cili renditet në vendin e katërt nga 112 deputetë (duke lënë jashtë klasifikimit ministrat dhe kryetarin e Kuvendit).

Në listën e 22 deputetëve më aktivë dhe efektivë në parlament bëjnë pjesë edhe deputetët e rinj Ralf Gjoni e Vasil Sterjovski, Kostaq Papa, Enver Roshi, Halit Valteri, Zef Shtjefni, Nimet Musaj dhe Edlira Hyseni, dy prej të cilëve përfitojnë edhe nga pozita e kreut të një grupi parlamentar ose një komisioni parlamentar.

Në listën e më të mirëve bëjnë pjesë edhe deputetët tashme më përvojë dhe pjesë e tabelës vlerësuese në dy sesionet e fundit parlamentare, Ilir Beqaj, Antoneta Dhima, Vasilika Hysi, Besnik Baraj, Elona Gjebrea, Evis Kushi, Ulsi Manja, si dhe hyrja “e re” Vullnet Sinaj.

KLASIFIKIMI: 22 DEPUTETËT MË EFEKTIVË NË RENDITJEN E PËRGJITHSHME SHTATOR-DHJETOR 2019							
NR	DEPUTETËT	GRUPI	PIKË	NR	DEPUTETËT	GRUPI	PIKË
1	<b>TAULANT BALLA</b>	<b>PS</b>	<b>64</b>	12	<b>BESNIK BARAJ</b>	<b>PS</b>	<b>49.8</b>
2	<b>RUDINA HAJDARI</b>	<b>DEM</b>	<b>62</b>	13	<b>VASILIKA HYSI</b>	<b>PS</b>	<b>49.5</b>
3	<b>ARBEN AHMETAJ</b>	<b>PS</b>	<b>61</b>	14	<b>ENVER ROSHI</b>	<b>PAV</b>	<b>47.5</b>
4	<b>ARTUR ROSHI</b>	<b>PA GRUP</b>	<b>58.7</b>	15	<b>ELONA GJEBREA</b>	<b>PS</b>	<b>46.8</b>
5	<b>ERMONELA FELAJ</b>	<b>PS</b>	<b>56.8</b>	16	<b>EVIS KUSHI</b>	<b>PS</b>	<b>44.3</b>
6	<b>MYSLIM MURRIZI*</b>	<b>DEM</b>	<b>56.8</b>	17	<b>ULSI MANJA</b>	<b>PS</b>	<b>44</b>
7	<b>VASIL STERJOVSKI</b>	<b>PA GRUP</b>	<b>56.2</b>	18	<b>HALIT VALTERI</b>	<b>DEM</b>	<b>43.6</b>
8	<b>ILIR BEQAJ</b>	<b>PS</b>	<b>56.1</b>	19	<b>ZEF SHTJEFNI</b>	<b>PED</b>	<b>42.8</b>
9	<b>RALF GJONI</b>	<b>PAV</b>	<b>55.8</b>	20	<b>NIMET MUSAJ</b>	<b>PAV</b>	<b>42.6</b>
10	<b>ANTONETA DHIMA</b>	<b>PS</b>	<b>55</b>	21	<b>EDLIRA HYSENI</b>	<b>PAV</b>	<b>42.4</b>
11	<b>KOSTAQ PAPA</b>	<b>PED</b>	<b>50</b>	22	<b>VULLNET SINAJ</b>	<b>PS</b>	<b>42.2</b>

*Shënim: Deputeti Murrizi ka vlerësimin 61,8 pikë, por për arsyet e cituara më lart në raport merr – 5 pikë në vlerësimin final*

## 10.2. DEPUTETËT MË PAK EFEKTIVË? KOKA, DOSHI...DHE 12 “PRURJE TË REJA”

Pjesa tjetër e tabelës së efektivitetit merr në konsideratë dhe është në interes publik edhe për deputetët që kanë qenë më pak efektivë gjatë sesionit të fundit parlamentar. Siç shihet nga tabela, përveç deputetes së re Enada Kapllani e ardhur nga lista e LSI Vlorë, dy deputetët më pak efektivë janë dy emra të njohur të politikës dhe të jetës parlamentare, - ish ministri Lefter Koka dhe deputeti Tom Doshi.



Secili prej emrave në listën fundore të renditjes ka kontribut simbolik në të gjithë aktivitetin parlamentar, çfarë do të thotë, nuk ka ndërmarrë nisma ligjore, nuk kanë qenë aktivë me prezencë e diskutime në komisione dhe në seanca, nuk kanë ushtruar kompetencat e deputetëve në raport me funksionet e tjera parlamentare, pra nuk kanë lënë gjurmë në vendimmarrjen parlamentare të sesionit që sapo është mbyllur.

Në listë bën pjesë edhe ish deputeti i PS Gjetani tashmë i pavarur, deputeti P.Sterkaj si dhe deputeti biznesmen S.Abazi. Në tërësi janë po ata emra, kryesisht lidhje të biznesit me politikën, që nuk kanë aktivitet parlamentar në atë masë sa të dëshmojnë nivel mesatar ose të lartë efektiviteti. Interesante është se në listën e 18 deputetëve më pak efektivë në parlament gjatë sesionit të fundit bëjnë pjesë 12 deputetë nga prurjet e reja të pranverës 2019, një bilanc ky kritik për deputetët e rinj dhe për vetë parlamentin.

<b>KLASIFIKIMI: 18 DEPUTETËT ME VLERËSIM MINIMAL NË RENDITJEN E PËRGJITHSHME SHTATOR-DHJETOR 2019</b>							
<i>NR</i>	<i>DEPUTETËT</i>	<i>GRUPI</i>	<i>PIKË</i>	<i>NR</i>	<i>DEPUTETËT</i>	<i>GRUPI</i>	<i>PIKË</i>
1	<b>ENADA KAPLLANI</b>	<b>PAV</b>	<b>4.7</b>	10	<b>FATMIR VELAJ</b>	<b>PS</b>	16.6
2	<b>LEFTER KOKA</b>	<b>PA GRUP</b>	<b>8</b>	11	<b>NIKOLIN STAKA</b>	<b>PA GRUP</b>	16.9
3	<b>TOM DOSHI</b>	<b>PA GRUP</b>	<b>10.2</b>	12	<b>YLLI SHEHU</b>	<b>PAV</b>	17.5
4	<b>GJETAN GJETANI</b>	<b>PA GRUP</b>	<b>11.9</b>	13	<b>EUGEN BOJAXHI</b>	<b>PA GRUP</b>	17.9
5	<b>AMRA BAROVA</b>	<b>PAV</b>	<b>13.3</b>	14	<b>KLAJDI QAMA</b>	<b>PA GRUP</b>	17.9
6	<b>PAULIN STERKAJ</b>	<b>PS</b>	<b>14</b>	15	<b>BESNIK TROPLINI</b>	<b>PA GRUP</b>	18
7	<b>EDMOND RRUSHI</b>	<b>PA GRUP</b>	<b>14.3</b>	16	<b>EDMOND STOJKU</b>	<b>PA GRUP</b>	18.2
8	<b>ERION PICIRI</b>	<b>PA GRUP</b>	<b>14.3</b>	17	<b>EDIOLA BRAHA</b>	<b>PAV</b>	18.8
9	<b>SADRI ABAZI</b>	<b>PS</b>	<b>15.8</b>	18	<b>AURORA MARA</b>	<b>PAV</b>	18.9

### **10.3. GRUPI “DEMOKRAT” DHE GRATË DEPUTETE MË EFEKTIVËT**


Të dhënat krahasuese midis grupeve parlamentare dhe deputetëve sipas shkallës së renditjes në nivelin e efektivitetit tregojnë se deputetët e Grupit “Demokrat” me figurat kryesore R.Hajdari e M.Murrizi kanë qenë edhe grupi më i suksesshëm në bilancin e aktivitetit parlamentar shtator-dhjetor 2019. Ata kanë arritur kuotën mesatare 40,70 pikë, shumë më lartë se grupet e tjera dhe me distancë prej rreth 7 pikësh nga grupi i PS, i cili është i dyti në renditjen klasifikuese.

Socialistët kanë nivel efektiviteti mesatar prej 33,29 pikë, ndjekur nga grupi tashmë i shpërbërë i partive të djathta me 30,29 pikë, si dhe shumë afër tyre me 29,05 pikë deputetët e “Grupit të Pavarur”.





Deputetët pa grup parlamentar në total kanë përfaqësimin më të ulët në renditjen kolektive të grupeve me vetëm 25,82 pikë mesatare për deputetë.



Në klasifikimin gjinor të përfaqësimit edhe në këtë rast gratë deputete janë shumë më efektive sesa meshkujt deputetë. Diferenca prej më shumë se 2% nuk është simbolike por domethënëse, sidomos në një mjedis politik e publik si ai shqiptar, ku politikanet përballen me ligjërim e klimë shpeshherë fyese e denigruese sidomos nga rivalët politikë apo mediat online.

#### 10.4. GRUPI I PS, - KRYESOJNË TË NJËJTIT, PA SURPRIZA NË RENDITJE

Të dhënat e tabelës së efektivitetit për deputetët e PS tregojnë se edhe në këtë sesion parlamentar nuk ka ndryshime dhe zhvendosje të mëdha. Të njëjtit deputetë që kanë qenë aktivë dhe të vlerësuar edhe më parë për bilancin e punës së tyre në aktivitetin parlamentar vijojnë të jenë pjesë dominuese e klasifikimit pozitiv. Të tillë janë kreu i grupit T.Balla, kryetarët e komisioneve E.Felaj dhe A.Ahmetaj, deputetët me përvojë I.Beqaj, B.Baraj, V.Hysi dhe E.Kushi, drejtuesja e Aleancës së Grave Deputete E.Gjebrea, deputetët U.Manja, V.Sinaj dhe E.Bushati, etj.

Gjithashtu edhe fundi i listës së klasifikimit tek grupi parlamentar i PS ka pothuajse të njëjtin trend si edhe në sesionin e kaluar parlamentar, ku bëjnë pjesë deputetët me shumë mandate të ardhur nga bota e biznesit, por me përjashtim, deputeti D.Gjijnuri, i cili ishte mjaft aktiv në Komisionin e Reformës Zgjedhore, por nuk ka qenë aktiv në aktivitetet e tjera funksionale parlamentare.

<b>RENDITJA E DEPUTETËVE TË PS SIPAS NIVELIT TË EFIKASITETIT</b> (SHTATOR – DHJETOR 2019)					
NR	DEPUTETËT	PIKË	NR	DEPUTETËT	PIKË
1	TAULANT BALLA	63	34	BUJAR ÇELA	31.6
2	ARBEN AHMETAJ	61	35	ADELINA RISTA	30.3
3	ERMONELA FELAJ	56.8	36	VILMA BELLO	30




4	ILIR BEQAJ	56.1	37	LUAN HARUSHA	29.6
5	ANTONETA DHIMA	55	38	JURGIS ÇYRBJA	29.3
6	BESNIK BARAJ	49.8	39	XHAVIT BUSHAJ	28.9
7	VASILIKA HYSI	49.5	40	XHEMAL QEFALIA	28.5
8	ELONA GJEBREA	46.8	41	KLOTILDA BUSHKA	28.2
9	EVIS KUSHI	44.3	42	ARTEMIS DRALO	28
10	ULSI MANJA	44	43	ILIRIAN PENDAVINJI	27.7
11	VULLNET SINAJ	42.2	44	MIRELA KUMBARO	27.5
12	ERVIN BUSHATI	40.7	45	LUAN DUZHA	27.5
13	ISMET BEQIRAJ	40.1	46	ANDUEL XHINDI	27.4
14	BLERINA GJYLAMETI	39.6	47	ARDIANA JAKU	27
15	NIKO PELESHI	39	48	ILIR NDRAXHI	26.6
16	MILVA EKONOMI	38.5	49	FATMIR XHAFAJ	26.4
17	MIMI KODHELI	38	50	ELIO HYSKO	26.2
18	BASHKIM FINO	38	51	EDMOND LEKA	25.8
19	DITMIR BUSHATI	37.6	52	FIDEL YLLI	25.3
20	ARBEN PELLUMBI	36.7	53	FLORENC SPAHO	25.2
21	ALMIRA XHEMBULLA	36.1	54	TATJANA PIRO	24.4
22	SENIDA MESI	36.1	55	ARDIT KONOMI	22.6
23	ANDREA MARTO	35.8	56	ROLAND XHELILAJ	22.5
24	EGLANTINA GJERMENI	35.4	57	ROBERT BITRI	21.6
25	ALKET HYSENI	35.3	58	SPARTAK BRAHO	21.5
26	KLODIANA SPAHIU	34.6	59	RRAHMAN RRAJA	21.4
27	FADIL NASUFI	34.6	60	ARBEN KAMAMI	21.1
28	ADNOR SHAMETI	34.2	61	DRITAN BICI	20.8
29	EDLIRA BODE	34.1	62	DAMIAN GJIKNURI	20.5
30	SADI VORPSI	34	63	FATMIR VELAJ	16.6
31	LINDITA NIKOLLA	33	64	SADRI ABAZI	15.8
32	MUSA ULQINI	32.5	65	PAULIN STERKAJ	14
33	ANASTAS ANGJELI	31.9			

## 10.5. GRUPI DEMOKRAT, KRYESJNË HAJDARI E MURRIZI

Në renditjen e deputetëve të grupit “Demokrat” nuk ka surprizë për faktin se dy deputetët me më shumë përvojë janë edhe dy figurat më aktive në klasifikimin e deputetëve sipas efektivitetit. Ata kanë mbajtur peshën kryesore në komisione dhe në seanca plenare.

Një tipar tjetër dallues i këtij grupimi është se secili prej deputetëve ka pasur aktivizim në debate në komisione dhe seanca, pra përpjekje për rritje në vlerësimin e efektivitetit. Gjithashtu një numër nismash ligjore janë ndërmarrë në mënyrë kolektive si formë promovimi dhe bashkëpunimi brenda grupit ndonëse në shtator e tetor mosmarrëveshjet midis disa anëtarëve për drejtimin e grupit bënë “headline” negativ në media.






#### 10.6. GRUPI "I PAVARUR", KRYESOJNË GJONI DHE ROSHI

Në vlerësimin e efektivitetit të deputetëve tek Grupi "I Pavarur" nuk ka surpriza. Kryesues për nivelin e efektivitetit është deputeti Ralf Gjoni, i cili merr pjesë aktive në debate publike, në komisione dhe në seancat plenare, si dhe kreu i vetëm i një komisioni nga ky grup, Enver Roshi. Përqindje të lartë angazhimi kanë edhe kreu i grupit, Nimet Musaj, si dhe sidomos deputetja e ardhur nga qarku Durrës si zëvendësuese nga lista proporcionale e LSI, Edlira Hyseni.


Në këtë grup bën pjesë edhe një prej deputetëve me nivelin më minimal të angazhimit dhe efikasitetit gjatë sesionit të fundit parlamentar, ardhur përmes listës proporcionale nga qarku Vlorë.



## 10.7. ISH GRUPI “PARTITË E DJATHTA”, TË GJITHË MIDIS 18-48 PIKËVE

Deputetët që deri në dhjetor 2019 bënë pjesë në Grupin e “Partive të Djathta” kanë pasur angazhim proporcional në sesionin e fundit parlamentar. “Surprizë” pozitive mbetet të theksohet angazhimi në debatet parlamentare në seancat plenare të deputetëve K.Papa dhe Z.Shtjefni, të cilët kanë edhe vlerësimin më të lartë në nivelin e efikasitetit.

Disa prej deputetëve të këtij grupi kanë vendosur të japin dorëheqje nga grupi dhe në janar do të jetë më i qartë angazhimi i tyre i ri parlamentar. Megjithatë, prishja e grupit do ta dëmtojë pozitën dhe mundësinë e tyre për të qenë më tepër prezent edhe në mbledhje të tjera vendimmarrëse siç janë Konferenca e Kryetarëve apo të përfaqësuar në komisione të veçanta që ngre parlamenti.



## 10.8. DEPUTETËT PA GRUP: KRYESOJNË ROSHI, STERJOVSKI DHE PËRMETI

Deputetët që njihen “pa grup” nuk kanë organizim dhe përfaqësojnë prurje të ndryshme politike majtas e djathtas. Megjithatë në renditjen e përgjithshme si kategori jashtë grupeve parlamentare, rezulton se deputetët më efektivë gjatë sesionit të fundit parlamentar kanë qenë Artur Roshi, Vasil Sterjovski dhe Andi Përmeti. Ata kanë ndërmarrë nisma ligjore, prej tyre ka pasur së paku një interpelancë, kanë qenë mjaft aktiv në debatet parlamentare dhe në debatet në komisione.

Në nivel të lartë angazhimi në parlament kanë qenë edhe deputetët Lefter Maliqi, Ligoraq Karamelo, Suzana Topi, Elda Hoti dhe Krenar Rryçi, të gjithë me më shumë se 30 pikë në renditjen e përgjithshme. Disa prej tyre bëjnë pjesë për herë të parë në renditje pozitive në Kuvend, - një tregues se brenda një kohe të shkurtër kanë arritur të kuptojnë e të përdorin mekanizmat parlamentarë të përfaqësimit. Në fundin e listës së deputetëve pa grup parlamentar bëjnë pjesë deputeti i PSD Tom Doshi, ish-deputeti socialist Gjetan Gjetani, deputetët Erion Piciri, Edmond Rrushi dhe Nikolin Staka, të ardhur në parlament përkatësisht nga listat proporcionale të PD, LSI dhe PD.

NIVELI I EFIKASITETIT, DEPUTETËT PA GRUP PARLAMENTAR			
NR	DEPUTETËT	GRUPI	PIKË
1	ARTUR ROSHI	PA GRUP	58,7
2	VASIL STERJOVSKI	PA GRUP	56,1
3	ANDI PERMETI	PA GRUP	40,4
4	LEFTER MALIQI	PA GRUP	36,2
5	LIGORAQ KARAMELO	PA GRUP	36,1
6	SUZANA TOPI	PA GRUP	31,8
7	ELDA HOTI	PA GRUP	30,8
8	KRENAR RRYCI	PA GRUP	30,2
9	KUJTIM GJUZI	PA GRUP	30,1
10	REME LALA	PA GRUP	25,8
11	MAJLINDA HALILAJ	PA GRUP	25
12	ELENA XHINA	PA GRUP	21,3
13	EDMOND STOJKU	PA GRUP	18,2
14	BESNIK TROPLINI	PA GRUP	18
15	EUGEN BOJAXHI	PA GRUP	17,9
16	KLAJDI QAMA	PA GRUP	17,9
17	NIKOLIN STAKA	PA GRUP	16,9
18	EDMOND RRUSHI	PA GRUP	14,3
19	ERION PICIRI	PA GRUP	14,3
20	GJETAN GJETANI	PA GRUP	11,9
21	TOM DOSHI	PA GRUP	10,2

### 10.9. GRATË DEPUTETE: KRYESOJNË HAJDARI, FELAJ DHE DHIMA

Në vlerësimin e veçantë për nivelin e angazhimit të grave deputete në parlament, rezultojnë se jo domosdoshmërisht deputetet që kanë edhe pozita drejtuese në grupet parlamentare ose në komisione kanë edhe nivel më të lartë efektiviteti. Duke përjashtuar deputetet R.Hajdari, E.Felaj, V.Hysi, F.Dhimitri dhe M.Kodheli, në listën e grave me vlerësimin më të lartë pozitiv gjatë sesionit të fundit parlamentar bëjnë pjesë edhe deputetet që nuk drejtojnë direkt komisionet dhe grupin, si A.Dhima, E.Gjebrea, E.Kushi, E.Hyseni, B.Gjylameti apo A.Xhembulla.

Tabela e efektivitetit në renditjen e përgjithshme parlamentare tregon se gratë deputete kanë qenë pjesë e modeleve të pakta pozitive në parlament. Përvoja parlamentare tregon se sa herë parlamenti nuk ka debate të ashpra dhe konfliktualitet politik gratë deputete janë shumë më produktive në aktivitetin parlamentar, në rastet e tjera gjuha denigruese që përdoret shpesh bëhet pengesë edhe për nxjerrjen në pah të cilësive pozitive të deputetëve.

Në listën e grave deputete, ka modele pozitive angazhimi, por bëjnë pjesë edhe disa prej deputeteve të reja që kanë nivel minimal angazhimi në aktivitetin parlamentar. Tabela ilustron rastet dhe renditjen.



RENDITJA E GRAVE DEPUTETE SIPAS EFIKASITETIT (SHTATOR – DHJETOR 2019)							
NR	DEPUTETËT	GRUPI	PIKË	NR	DEPUTETËT	GRUPI	PIKË
1	RUDINA HAJDARI	DEM	62	18	SUZANA TOPI	PA GRUP	31,8
2	ERMONELA FELAJ	PS	56,8	19	ELDA HOTI	PA GRUP	30,8
3	ANTONETA DHIMA	PS	55	20	ADELINA RISTA	PS	30,3
4	VASILIKA HYSI	PS	49,5	21	VILMA BELLO	PS	30
5	ELONA GJEBREA	PS	46,8	22	KLOTILDA BUSHKA	PS	28,2
6	EVIS KUSHI	PS	44,3	23	ARTEMIS DRALO	PS	28
7	EDLIRA HYSENI	PAV	42,4	24	MIRELA KUMBARO	PS	27,5
8	BLERINA GJYLAMETI	PS	39,6	25	ARDIANA JAKU	PS	27
9	FATJONA DHIMITRI	DEM	38,8	26	REME LALA	PA GRUP	25,8
10	MILVA EKONOMI	PS	38,5	27	MAJLINDA HALILAJ	PA GRUP	25
11	MIMI KODHELI	PS	38	28	TATJANA PIRO	PS	24,4
12	ALMIRA XHEMBULLA	PS	36,1	29	ELENA XHINA	PA GRUP	21,3
13	SENIDA MESI	PS	36,1	30	AURORA MARA	PAV	18,9
14	EGLANTINA GJERMENI	PS	35,4	31	EDIOLA BRAHA	PAV	18,8
15	KLODIANA SPAHIU	PS	34,6	32	AMRA BAROVA	PAV	13,3
16	EDLIRA BODE	PS	34,1	33	ENADA KAPLLANI	PAV	4,7
17	LINDITA NIKOLLA	PS	33				

#### 10.10. MINISTRAT MË AKTIVË? MË PAK AKTIV JANË KRYEMINISTRI DHE ZV/KRYEMINISTRI

Për vlerësimin e efektivitetit të anëtarëve të kabinetit qeveritar ka parametra të tjerë nga ato për deputetët pa mandatet ministrorë. Disa nga ministrat (6) nuk janë deputetë, ndaj nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në votimet në parlament dhe kanë të drejta të kufizuara edhe në komisionet dhe mbledhjet e tjera të strukturave të Kuvendit.

Tabela bën diferencën midis dy grupeve në qeveri, ministrave deputetë dhe atyre që nuk janë deputetë. Në këta të fundit Ministria e Financave ka qenë më aktive (interpelancë, pjesëmarrje në komisione, sqarime në parlament) me 19.2 pikë nga 30 në total, ndjekur nga Ministria e Arsimit, Rinisë e Sporteve dhe Ministrja e Drejtësisë me nga 16 pikë dhe më pas tre ministrat e tjerë, B.Balluku, E.Margariti dhe S.Lleshaj. Ky i fundit ka qenë më pak i pranishëm në debate kryesisht nga fakti se nuk ka pasur nisma të rëndësishme ligjore në lidhje me sektorin e tij dhe se nuk ka pasur ngjarje politike si protestat e pranverës dhe verës, ku MPB kishte rol thelbësor.

Nga ministrat që janë edhe deputetë më aktive në parlament është Ministria që mbulon marrëdhëniet me parlamentin, Elisa Spiropali me 25,8 pikë nga 30 maksimale. Ajo ka zhvilluar një interpelancë në emër të Kryeministrit, ka diskutuar në disa prej rasteve të rëndësishme në parlament dhe ka luajtur rol aktiv edhe në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve.

Siç shihet edhe nga tabela, ka ministra që nuk kanë pasur rast për të folur në Kuvend (nuk ka pasur kërkesë ndaj tyre ose ndonjë nismë ligjore), por edhe që nuk kanë vlerësuar të jenë vullnetarisht pjesë e



debatit në parlament. Në tabelë kemi edhe kryeministrin me vetëm 5 fjalime aq sa B.Shahini e B.Balluku dhe 1-2 fjalime më pak se E.Spiropali, A.Denaj e E.Gjonaj. Zv/Kryeministri Braçe nuk ka qenë aktiv edhe për shkak se ka qenë shumë më tepër i përqendruar në drejtimin e qeverisë në emër të Kryeministrit (një sërë aktesh rezultojnë se janë miratuar në KM nën drejtimin e tij).

MINISTRAT MË AKTIVË NË AKTIVITETIN PARLAMENTAR		FJALIME
ELISA SPIROPALI	25.8	6
OGERTA MANASTIRLIU	18.9	3
PANDELI MAJKO	18	2
BLENDI KLOSI	17.4	3
OLTA XHAÇKA	16	3
EDUARD SHALSI	12	1
BLEDI ÇUÇI	10	0
EDI RAMA	9.6	5
ERION BRAÇE	8.1	0
ANILA DENAJ	19.2	7
BESA SHAHINI	16.6	5
ETILDA GJONAJ	16.5	7
BELINDA BALLUKU	12.6	5
ELVA MARGARITI	9.6	3
SANDER LLESHAJ	7	1
<i>Shënim: Gjashtë ministrat e fundit nuk janë deputetë ndaj nuk votojnë në parlament</i>		



## 11. RAPORTI “PËRFITIME FINANCIARE” VS “EFIKASITETI” I DEPUTETËVE

Për herë të parë stafi i ISP vendosi të bëjë edhe një shtesë në procesin e monitorimit të parlamentit, duke vendosur në ballafaqim të dhënat e përfitimit financiar nga deputetët me renditjen e tyre bazuar në nivelin e efikasitetit gjatë aktivitetit parlamentar. Nisma u ndihmua nga fakti se Kuvendi ka aplikuar për herë të parë deklaratimet publike të të ardhurave të deputetëve bazuar në përfitimet e rrogës së përhershme dhe përfitimet e tjera nga statusi i deputetit.

Gjetja më e rëndësishme e tabelës, - se shumë prej deputetëve më të mirë-paguar nuk janë deputetë efektivë në bilancin e aktivitetit parlamentar, - shërben për të zgjeruar komponentët e vlerësimit publik për deputetët dhe për t'i dhënë dimensionit të transparencës dhe të llogaridhënies një të dhënë të re të pa aplikuar më parë.

### 11.1. DEPUTETËT MË TË PAGUAR 2019, KRYESOJNË DEPUTETËT E QARQVE PERIFERIKE

Një kalkulum teknik i bërë nga stafi i ISP, sipas tabelës bashkëngjitur, paraqet deputetët më të paguar gjatë vitit 2019. Në krye të listës janë kryesisht deputetët që përfitojnë bonus strehimi dhe trajtimi të veçantë për shkak të largësisë me zonën zgjedhore / zonën e banimit, por edhe një listë paralele deputetësh që marrin pjesë rregullisht në çdo komision e mbledhje, duke përfituar edhe pagesat përkatëse financiare për aktivitete të tilla parlamentare.

#### DEPUTETËT ME MË SHUMË TË ARDHURA FINANCIARE NË AKTIVITETIN PARLAMENTAR 2019

NR	DEPUTETËT	PËRFITIMI	GRUPI	NR	DEPUTETËT	PËRFITIMI	GRUPI
1	EDMOND LEKA	2,914,507	PS	16	TATIANA PIRO	2,545,607	PS
2	EDLIRA BODE	2,850,465	PS	17	ARBEN KAMAMI	2,497,425	PS
3	FADIL NASUFI	2,839,707	PS	18	ROLAND XHELILAJ	2,486,292	PS
4	XHEVIT BUSHAJ	2,821,007	PS	19	LUAN DUZHA	2,478,725	PS
5	LUAN HARUSHA	2,798,345	PS	20	EVIS KUSHI	2,476,479	PS
6	ILIRJAN PENDAVINJI	2,745,872	PS	21	BUJAR ÇELA	2,472,539	PS
7	ELENA XHINA	2,682,644	PDIU	22	ILIR NDRAXHI	2,448,090	PS
8	VILMA BELLO	2,605,328	PS	23	ANDUEL XHINDI	2,432,668	PS
9	SENIDA MESI	2,601,360	PS	24	FATMIR VELAJ	2,378,871	PS
10	ADELINA RISTA	2,596,334	PS	25	KLODIANA SPAHIU	2,365,166	PS
11	ANTONETA DHIMA	2,586,134	PS	26	SPARTAK BRAHO	2,358,541	PS
12	ANDREA MARTO	2,579,607	PS	27	JURGIS ÇYRBJA	2,334,128	PS
13	DRITAN BICI	2,576,867	PS	28	NIKO PELESHI	2,333,111	PS
14	ALMIRA XHEMBULLA	2,572,534	PS	29	EMONELA FELAJ	2,310,844	PS
15	ROBERT BITRI	2,554,716	PS	30	RRAHMAN RAJA	2,281,119	PS

Burimi: Nga faqja zyrtare e Kuvendit ([www.parlament.al/RaporteStatistika?statusId=9](http://www.parlament.al/RaporteStatistika?statusId=9))





Konkretisht, deputeti me më shumë të ardhura financiare nga funksioni i tij parlamentar është deputeti i Vlorës E.Leka me rreth 29 milionë lekë (vjetra) në 12 muaj. Më tej deputetët E.Bode (Korçë), F.Nasufi (Berat), Xh.Bushaj (Fier), L.Harusha (Shkodër), I.Pendavinji (Korçë), E.Xhina (Elbasan), V.Bello (Vlorë), S.Mesi (Shkodër), etj, figurojnë si deputetët me më shumë të ardhura gjatë vitit 2019 për shkak të aktivitetit si deputetë.

A ka përputhshmëri midis deputetëve me më shumë të ardhura financiare dhe atyre me nivel më të lartë efektiviteti në aktivitetin parlamentar? Dukshëm jo. Për shembull, deputeti me më shumë të ardhura financiare nga aktiviteti parlamentar, në të dhënat e sesionit shtator-dhjetor 2019 rezulton se nuk ka pasur asnjë diskutim në 13 seancat plenare të Kuvendit. Po ashtu, pjesa më e madhe e 30 deputetëve më të paguar në parlament nuk bëjnë pjesë në 30 deputetët më efektivë në parlament sesionin e kaluar apo këtë sesion parlamentar dhe as në deputetët më të spikatur në nismat parlamentare, në debatet në komisione apo në debatet në seancat plenare. Sic shihet nga tabela, ka deputetë të mirëpaguar që zakonisht kanë bërë “headline” në publik dhe media jo për politikë por për skandale dhe probleme me ligjin, siç ka deputetë që aktivitetin parlamentar e kanë angazhim të vetëm ndaj edhe angazhohen plotësisht në pjesëmarrjet e rregullta në të gjitha mbledhjet ku janë zgjedhur ose deleguar nga kryesia e Grupit dhe nga Kuvendi.

## 11.2. TRE DEPUTETËT QË KANË PËRPUTHSHMËRI MIDIS “RROGËS” DHE “EFIKASITETIT”

Klasifikimi i deputetëve sipas nivelit të përfitimit financiar (pagës) dhe sipas renditjes finale të efektivitetit jep edhe rastet kur ka përputhshmëri maksimale +10/-10. Nga tabela rezulton se nga 112 deputetë, vetëm 3 deputetë kanë përputhshmëri të plotë midis “pagës” dhe “efikasitetit”.

DEPUTETËT ME DIFERENCË MË TË VOGËL “PAGË – EFIKASITETIT”				
NR	DEPUTETËT	SIPAS PAGËS	SIPAS EFEKTIVITETIT	DIFERENCA
1	KLOTILDA BUSHKA	54	64	-10
2	ALKET HYSENI	33	42	-9
3	ADNOR SHAMETI	37	45	-8
4	MUSA ULQINI	41	49	-8
5	MAJLINDA HALILAJ	78	82	-4
6	ERVIS MEÇO	94	95	-1
7	<b>ANTONETA DHIMA</b>	<b>11</b>	<b>11</b>	<b>0</b>
8	<b>SADI VORPSI</b>	<b>47</b>	<b>47</b>	<b>0</b>
9	<b>KLAJDI QAMA</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>0</b>
10	NIKO PELESHI	28	27	1
11	EVIS KUSHI	20	16	4
12	BASHKIM FINO	35	31	4
13	EGLANTINA GJERMENI	46	41	5
14	ANASTAS ANGJELI	55	50	5
15	ERION PICIRI	112	106	6
16	ARBEN ELEZI	71	62	9
17	SELAMI JENISHEHRI	90	81	9



Ata janë deputetët e PS Antoneta Dhima e Sadi Vorpsi, si dhe deputeti pa grup parlamentar Klajdi Qama, të cilët respektivisht renditen në vendet 11, 47 dhe 100 në dy tabelat e vlerësimit, për pagën financiare më të madhe të fituar dhe për nivelin më të lartë të efektivitetit në aktivitetin parlamentar.

Me diferencë minimale +/-1 janë edhe dy deputetët e tjerë, prurja e re Ervis Meço (PeD) dhe deputeti me përvojë Niko Peleshi (PS). Midis kufirit +/-10 janë edhe deputetë të tjerë të njohur, si Evis Kushi (PS), Bashkim Fino (PS), por edhe Majlinda Halilaj nga deputetët pa grup, të cilët renditen përkatësisht në vendet 16, 31 dhe 82 për shkallën e efikasitetit. Po ashtu përputhshmëri maksimale kanë edhe deputetë E.Gjermani, A.Angjeli, M.Ulqini, A.Shameti, K.Bushka e E.Hyseni të PS, si dhe deputetët e rinj në parlament E.Piciri, A.Elezi e S.Jenishehri.

### 11.3. DEPUTETËT MË EFEKTIVË NË RAPORT ME PAGËN, DOMINOJNË PRURJET E REJA

Lista më pozitive e renditjes është ajo e diferencës më të madhe midis nivelit të efikasitetit dhe të pagës përfituese financiare. Në krye të listës është deputeti Artur Roshi (PBKD) me diferencë 95 (numri 4 në klasifikimin e efikasitetit dhe numri 99 në klasifikimin për përfitimin financiar). Pas tij janë po ashtu deputetët e rinj Halit Valteri (DEM), Vasil Sterjovski (Pa grup), Kostaq Papa (PeD), Ralf Gjoni (PAV), Zef Shtjefni (PeD). Të parët dhe të vetmit socialistë në listën e 16 deputetëve me renditje më të mirë në klasifikimin e efikasitetit sesa në klasifikimin e të ardhurave financiare janë Arben Ahmetaj dhe Vasilika Hysi.

DEPUTETËT ME DIFERENCË MË TË MADHE MIDIS NIVELIT TË EFIKASITETIT DHE PAGËS PËRFITUESE				
NR	DEPUTETËT	RENDITJA SIPAS PAGËS	RENDITJA SIPAS EFEKTIVITETIT	DIFERENCA MIDIS TYRE
1	ARTUR ROSHI	99	4	95
2	HALIT VALTERI	107	18	89
3	VASIL STERJOVSKI	88	7	81
4	KOSTAQ PAPA	93	13	80
5	RALF GJONI	85	9	76
6	ZEF SHTJEFNI	95	19	76
7	ARBEN AHMETAJ	77	3	74
8	VASILIKA HYSI	86	12	74
9	KORAB LITA	92	24	68
10	ANDI PERMETI	97	30	67
11	ENVER ROSHI	70	14	56
12	FATJONA DHIMITRI	84	28	56
13	EDLIRA HYSENI	75	21	54
14	MYSLIM MURRIZI	58	6	52
15	SUZANA TOPI	101	51	50
16	KRENAR RRYÇI	106	56	50



Lista dominohet në 81% të saj nga deputetë të rinj të hyrë në parlament gjatë muajve mars-qershor 2019, gjë që i bën ata përfitues financiar të kufizuar në varësi nga momenti i betimit si deputet dhe i ndihmon të jenë më mirë në renditje sesa deputetët që kanë qenë në parlament gjatë gjithë periudhës vjetore.

#### 11.4. DEPUTETËT MË PËRFITUES, POR MË PAK EFEKTIVË NË KUVEND?

Lista e deputetëve që kanë pasur përfitim më të madh financiar, sesa renditja e tyre në klasifikimin e efikasitetit vlen për të bërë dallimin midis tri kategorive, atyre me përputhshmëri të plotë, atyre me diferencë pozitive për shkak se kanë qenë më efikas në punën e tyre dhe atyre që kanë nivel minimal efikasiteti. Në këtë listë bëjnë pjesë edhe disa nga deputetët e qarqeve të largëta, të cilët janë përfitues të bonusit financiar për udhëtim e fjetje në Tiranë gjatë aktivitetit parlamentar.

DEPUTETËT ME DIFERENCË MË TË MADHE MIDIS PAGËS DHE NIVELIT TË EFIKASITETIT				
NR	DEPUTETËT	SIPAS PAGËS	SIPAS EFEKTIVITETIT	DIFERENCA
1	ELENA XHINA	7	90	-83
2	DRITAN BICI	13	92	-79
3	FATMIR VELAJ	24	103	-79
4	GJETAN GJETANI	31	109	-78
5	EDMOND LEKA	1	77	-76
6	ARBEN KAMAMI	17	91	-74
7	ROBERT BITRI	15	87	-72
8	ROLAND XHELILAJ	18	86	-68
9	TATIANA PIRO	16	83	-67
10	PAULIN STERKAJ	42	107	-65
11	ILIRJAN PENDAVINJI	6	68	-62
12	SPARTAK BRAHO	26	88	-62
13	RRAHMAN RAJA	30	89	-59
14	XHEVIT BUSHAJ	4	61	-57
15	EDIOLA BRAHA	40	96	-56
16	LUAN HARUSHA	5	59	-54
17	ILIR NDRAXHI	22	73	-51
19	VILMA BELLO	8	58	-50
20	LUAN DUZHA	19	69	-50

Referuar tabelës, deputetët me diferencën më të madhe midis “përfitimit financiar” dhe nivelit të “efikasitetit” janë dominues deputetët e zgjedhur me mandat të plotë në legjislaturë, kryesisht të PS dhe partive të tyre aleate. Në listën e 20 emrave me diferencën më të madhe kryesojnë dy ish-deputetët e PDIU Elena Xhina dhe Dritan Bici respektivisht me -83 dhe -79, ndjekur nga deputetët e PS, F.Velaj (-79), Gj.Gjetani, E.Leka, A.Kamani, R.Bitri, R.Xhelilaj, T.Piro, P.Stërkaj, I.Pendavinji, etj. Në listë bën pjesë edhe deputeti S.Braho me renditje 26 në të ardhurat financiare, por vetëm 88 në nivelin e efikasitetit në parlament. Nga deputetët e rinj në 20 vendet e para të diferencës negative është vetëm E.Braha (PAV).



### 11.5. ME “0” FJALIME NË PARLAMENT? 8 NGA 20 DEPUTETËT MË TË “PAGUAR”

Aktiviteti kryesor publik i deputetëve janë fjalimet dhe ndërhyrjet në seancat plenare. Për shkak se Rregullorja e re e Kuvendit parashikon zhvillimin e seancave dedikuar zonave zgjedhore dhe takimeve me elektoratin, (janë zhvilluar dy seanca të tilla gjatë shtator-dhjetor 2019) deputetët kanë mundësi të përdorin tribunën e parlamentit për të “ngritur zërin” mbi shqetësimet e banorëve të zonave të tyre zgjedhore, ose zonave ku janë deleguar të punojnë nga partia e tyre politike.

Mbi këtë bazë stafi i ISP bëri krahasimin e 20 deputetëve më të “mirëpaguar” në parlament me angazhimet e tyre në 13 seancat plenare. Siç rezulton nga tabela, deputeti më i mirëpaguar ka “0” fjalime në parlament, po ashtu “0” fjalime kanë edhe numri 5, 6 dhe 7 në renditjen e deputetëve më të paguar gjatë 2019, për të vijuar më pas me numrat 13, 15, 17 dhe 19. Pra në total, në listën e 20 deputetëve me më shumë përfitime financiare në Kuvend për shkak të aktivitetit të tyre parlamentar gjatë 2019, 8 prej tyre nuk kanë folur asnjëherë në asnjë prej seancave plenare të katër muajve të fundit në parlament. Shembull pozitiv përbëjnë deputetë të tjerë të listës, si A.Dhima, E.Kushi, A.Marto, F.Nasufi, S.Mesi dhe A.Xhembulla, të cilët kanë midis 7 dhe 3 fjalimeve gjatë shqyrtimit të ligjeve në seancat plenare.

#### **ERION PICIRI: DEPUTETI QË “REFUZON” RROGËN NË PARLAMENT**

*Deputeti Erion Piciri vijon të jetë deputeti i vetëm që nuk përfiton asnjë shumë financiare nga aktiviteti parlamentar. Ai ka deklaruar se nuk përfiton as rrogën, as përfitimet financiare nga angazhimi në seanca dhe në komisione dhe as bonuset që ofron statusi i deputetit. Ky është rasti i parë në legjislaturat parlamentare, por edhe një zgjedhje personale për të përcjellë mesazhin se nuk ka vendosur të marrë mandatin e lënë bosh nga PD për përfitime financiare.*

**TABELA KRAHASIMORE E DEPUTETËVE MË TË PAGUAR  
NË RAPORT ME NUMRIN E FJALIMEVE  
SHTATOR-DHJETOR 2019**

NR	DEPUTETËT	FJALIME	NR	DEPUTETËT	FJALIME
1	EDMOND LEKA	0	11	ANTONETA DHIMA	7
2	EDLIRA BODE	2	12	ANDREA MARTO	4
3	FADIL NASUFI	3	13	DRITAN BICI	0
4	XHEVIT BUSHAJ	2	14	ALMIRA XHEMBULLA	3
5	LUAN HARUSHA	0	15	ROBERT BITRI	0
6	ILIRJAN PENDAVINJI	0	16	TATIANA PIRO	1
7	ELENA XHINA	0	17	ARBEN KAMAMI	0
8	VILMA BELLO	2	18	ROLAND XHELILAJ	0
9	SENIDA MESI	3	19	LUAN DUZHA	1
10	ADELINA RISTA	1	20	EVIS KUSHI	5



## 12. SHTOJCË 1: TABELA E PLOTË E VLERËSIMIT TË DEPUTETËVE SIPAS TREGUESVE TË AKTIVITETIT PARLAMENTAR

Më poshtë paraqitet tabela e plotë e vlerësimit të deputetëve për sesionin parlamentar shtator-dhjetor 2019, bazuar me metodologjinë e projektit, e cila është ndjekur e njëjtë edhe në monitorimet e tjera periodike prej vitit 2017. Jashtë renditjes në listë janë lënë deputetët që janë ministra, përfshirë Kryeministrin, si dhe Kryetari i Kuvendit. Për një deputet (M.Murrizi) ka vlerësim -5 pikë nga vlerësimi i përgjithshëm, për arsytet e shpjguara më lartë në raport.

NR	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI POLITIK	NISME LIGJORE	AMENDIM LIGJOR	PR+DISK KOMISION	PR+DISK SEANCË	KERKESË INFORMIM	INTERPELANCE	VOTIM I LIGJEVE %	ZONË / PUBLIK	TOTAL 100 PIKË
1	ADELINA RISTA	PS	0	2	11.3	2	0	0	10	5	30.3
2	ADNOR SHAMETI	PS	4	5	7.2	2	0	0	10	6	34.2
3	ADRIATIK ALIMADHI	PeD	0	4	14.2	2	0	0	1.8	6	28
4	ALBAN ZENELI	DEM	0	3	8.6	0	3	3	5.2	5	27.8
5	ALKET HYSENI	PS	4	5	9.7	2	0	0	9.6	5	35.3
6	ALMIRA XHEMBULLA	PS	0	2	13.1	6	0	0	10	5	36.1
7	AMRA BAROVA	PAV	0	0	7.4	0	0	0	3.9	2	13.3
8	ANASTAS ANGJELI	PS	0	3	9.6	4	0	0	9.3	6	31.9
9	ANDI PERMETI	PA GRUP	0	4	11.5	8	0	5	5.9	6	40.4
10	ANDREA MARTO	PS	0	3	9.8	8	0	0	10	5	35.8
11	ANDUEL XHINDI	PS	0	2	8.4	2	0	0	10	5	27.4
12	ANTONETA DHIMA	PS	0	2	11.4	14	10	0	9.6	8	55
13	ARBEN AHMETAJ	PS	5	5	20	14	0	0	10	7	61
14	ARBEN ELEZI	DEM	0	2	6.6	4	3	4	5.9	3	28.5
15	ARBEN KAMAMI	PS	0	0	8.1	0	0	0	10	3	21.1
16	ARBEN PELLUMBI	PS	0	2	14.7	4	0	0	10	6	36.7
17	ARDIANA JAKU	PS	0	2	6.9	4	0	0	8.1	6	27
18	ARDIT KONOMI	PS	0	2	5.6	2	0	0	10	3	22.6
19	ARLIND ÇAÇANI	DEM	0	3	6	2	6	4	7.7	3	31.7
20	ARTEMIS DRALO	PS	0	2	7	6	0	0	10	3	28
21	ARTUR ROSHI	PA GRUP	5	2	16.7	20	0	0	9	6	58.7
22	AURORA MARA	PAV	0	0	7.8	0	0	0	8.1	3	18.9
23	BASHKIM FINO	PS	2	6	14.3	2	0	0	6.7	7	38
24	BESNIK BARAJ	PS	0	6	18.8	8	0	0	10	7	49.8
25	BESNIK TROPLINI	PA GRUP	0	2	0	4	0	0	10	2	18
26	BLERINA GJYLAMETI	PS	0	3	13.8	8	0	0	8.8	6	39.6
27	BUJAR ÇELA	PS	0	2	13.1	2	0	0	9.5	5	31.6
28	DAMIAN GJIKNURI	PS	0	3	1.5	0	0	0	10	6	20.5
29	DITMIR BUSHATI	PS	0	4	13	4	0	0	9.6	7	37.6
30	DRITAN BICI	PS	0	2	7.3	0	0	0	9.5	2	20.8
31	EDIOLA BRAHA	PAV	0	0	7.2	0	0	0	9.6	2	18.8
32	EDLIRA BODE	PS	0	2	14.1	4	0	0	10	4	34.1
33	EDLIRA HYSENI	PAV	0	3	12.6	12	0	0	9.8	5	42.4
34	EDMOND LEKA	PS	4	3	4.8	0	0	0	10	4	25.8
35	EDMOND RRUSHI	PA GRUP	0	0	4	0	0	0	8.3	2	14.3
36	EDMOND STOJKU	PA GRUP	0	0	6.4	0	0	0	9.8	2	18.2



37	EGLANTINA GJERMENI	PS	0	4	11.8	4	0	0	9.6	6	35.4
38	ELDA HOTI	PA GRUP	0	3	8.1	12	0	0	3.7	4	30.8
39	ELENA XHINA	PA GRUP	0	2	10.2	0	0	0	6.1	3	21.3
40	ELIO HYSKO	PS	0	2	5.2	6	0	0	10	3	26.2
41	ELONA GJEBREA	PS	0	4	11.7	10	5	0	9.1	7	46.8
42	ENADA KAPLLANI	PAV	0	0	0.8	0	0	0	1.9	2	4.7
43	ENVER ROSHI	PAV	0	2	18.5	14	0	3	7	3	47.5
44	ERION PICIRI	PA GRUP	0	2	5.3	4	0	0	0	3	14.3
45	ERMONELA FELAJ	PS	0	4	18.2	8	10	0	9.6	7	56.8
46	ERVIN BUSHATI	PS	0	3	8.7	8	5	0	10	6	40.7
47	ERVIS MEÇO	PeD	0	0	4.6	0	0	3	9.3	2	18.9
48	EUGEN BOJAXHI	PA GRUP	0	0	4.6	2	0	0	9.3	2	17.9
49	EVIS KUSHI	PS	0	4	13.3	10	0	0	10	7	44.3
50	FADIL NASUFI	PS	0	2	11.6	6	0	0	10	5	34.6
51	FATJONA DHIMITRI	DEM	0	3	18.4	10	0	0	4.4	3	38.8
52	FATMIR VELAJ	PS	0	0	5	2	0	0	4.6	5	16.6
53	FATMIR XHAF AJ	PS	0	3	5.4	2	0	0	10	6	26.4
54	FIDEL YLLI	PS	0	0	10.8	2	0	0	9.5	3	25.3
55	FLORENC SPAHO	PS	0	0	9.2	4	0	0	10	2	25.2
56	GJETAN GJETANI	PA GRUP	0	0	5.3	0	0	0	4.6	2	11.9
57	HALIL JAKIMI	DEM	0	3	5.2	14	0	3	9	3	37.2
58	HALIT VALTERI	DEM	3	2	6.9	20	0	0	6.7	5	43.6
59	ILIR BEQAJ	PS	10	6	12.3	12	0	0	9.8	6	56.1
60	ILIR NDRAXHI	PS	0	2	9.6	2	0	0	10	3	26.6
61	ILIRIAN PENDAVINJI	PS	0	2	10.7	0	0	0	10	5	27.7
62	ISMET BEQIRAJ	PS	0	2	13.1	6	5	0	10	4	40.1
63	JURGIS ÇYRBJA	PS	0	2	9.3	4	0	0	10	4	29.3
64	KLAJDI QAMA	PA GRUP	0	0	4.4	2	0	0	9.5	2	17.9
65	KLODIANA SPAHIU	PS	0	2	13	6	0	0	9.6	4	34.6
66	KLOTILDA BUSHKA	PS	0	4	8.5	2	0	0	7.7	6	28.2
67	KOÇI TAHIRI	PeD	0	2	8.5	4	0	4	4.9	3	26.4
68	KORAB LITA	DEM	0	3	8.8	16	0	3	5.4	4	40.2
69	KOSTAQ PAPA	PeD	0	2	12	20	0	3	9	2	48
70	KRENAR RRYCI	PA GRUP	0	3	13.4	2	0	0	9.8	2	30.2
71	KUJTIM GJUZI	PA GRUP	0	0	6.4	14	0	0	5.7	4	30.1
72	LEFTER KOKA	PA GRUP	0	0	2.4	2	0	0	1.6	2	8
73	LEFTER MALIQI	PA GRUP	0	3	11.6	12	0	0	5.6	4	36.2
74	LIGORAQ KARAMELO	PA GRUP	0	2	16	4	0	0	9.1	5	36.1
75	LINDITA NIKOLLA	PS	0	2	13	2	0	0	10	6	33
76	LUAN DUZHA	PS	0	2	10.5	2	0	0	10	3	27.5
77	LUAN HARUSHA	PS	0	2	12.6	0	0	0	10	5	29.6
78	MAJLINDA HALILAJ	PA GRUP	0	2	9.2	2	0	0	9.8	2	25
79	MILVA EKONOMI	PS	0	2	19	4	0	0	9.5	4	38.5
80	MIMI KODHELI	PS	0	2	20	2	0	0	10	4	38
81	MIRELA KUMBARO	PS	0	2	11.5	0	0	0	10	4	27.5
82	MUSA ULQINI	PS	0	2	11.5	4	0	0	10	5	32.5
83	MYSLIM MURRIZI*	DEM	6	2	9	20	5	10	1.8	8	56.8
84	NIKO PELESHI	PS	0	4	20	0	0	0	10	5	39



85	NIKOLIN STAKA	PA GRUP	0	2	7	0	0	0	5.9	2	<b>16.9</b>
86	NIMET MUSAJ	PAV	0	3	7.3	20	0	0	9.3	3	<b>42.6</b>
87	PAULIN STERKAJ	PS	0	0	1	0	0	0	10	3	<b>14</b>
88	RALF GJONI	PAV	0	5	18.4	20	0	0	5.4	7	<b>55.8</b>
89	RAMAZAN GJUZI	PeD	0	0	9.2	0	0	3	8.6	2	<b>22.8</b>
90	REME LALA	PA GRUP	0	2	8.5	4	0	0	9.3	2	<b>25.8</b>
91	ROBERT BITRI	PS	0	2	8.8	0	0	0	8.8	2	<b>21.6</b>
92	ROLAND XHELILAJ	PS	0	2	6.5	0	0	0	10	4	<b>22.5</b>
93	RUDINA HAJDARI	DEM	2	5	14	20	5	3	4	9	<b>62</b>
94	RRAHMAN RRAJA	PS	0	2	7.6	0	0	0	9.8	2	<b>21.4</b>
95	SADI VORPSI	PS	0	2	10	4	3	0	10	5	<b>34</b>
96	SADRI ABAZI	PS	0	0	0	4	0	0	9.8	2	<b>15.8</b>
97	SELAMI JENISHERI	PeD	0	2	9.3	4	0	0	7.8	2	<b>25.1</b>
98	SENIDA MESI	PS	0	4	11	6	0	0	9.1	6	<b>36.1</b>
99	SPARTAK BRAHO	PS	0	2	7.5	0	0	0	10	2	<b>21.5</b>
100	SUZANA TOPI	PA GRUP	0	0	12.1	10	0	0	7.7	2	<b>31.8</b>
101	TATJANA PIRO	PS	0	2	9.4	2	0	0	8	3	<b>24.4</b>
102	TAULANT BALLA	PS	4	5	14	18	3	0	10	9	<b>63</b>
103	TOM DOSHI	PA GRUP	0	0	0.8	0	0	0	7.4	2	<b>10.2</b>
104	ULSI MANJA	PS	0	5	18	6	0	0	10	5	<b>44</b>
105	VASIL STERJOVSKI	PA GRUP	5	3	14	12	10	0	6.2	6	<b>56.2</b>
106	VASILIKA HYSI	PS	3	5	15	8	0	0	9.5	9	<b>49.5</b>
107	VILMA BELLO	PS	0	2	10	4	0	0	10	4	<b>30</b>
108	VULLNET SINAJ	PS	0	2	13.4	12	0	0	9.8	5	<b>42.2</b>
109	XHAVIT BUSHAJ	PS	0	2	9.6	4	0	0	9.3	4	<b>28.9</b>
110	XHEMAL QEFALIA	PS	0	0	6.5	4	3	0	10	5	<b>28.5</b>
111	YLLI SHEHU	PAV	0	2	5	0	0	0	8.5	2	<b>17.5</b>
112	ZEF SHTJEFNI	PeD	0	2	10	18	0	0	9.8	3	<b>42.8</b>



## MBI INSTITUTIN E STUDIMEVE POLITIKE

Instituti i Studimeve Politike ([www.isp.com.al](http://www.isp.com.al)) është një organizatë e shoqërisë civile që vepron në fushën e demokratizimit dhe shtetit të së drejtës. Drejtor Ekzekutiv aktual është Prof. Afrim Krasniqi. ISP është e fokusuar në monitorimin e institucioneve demokratike, si dhe në hartimin e raporteve / analizave profesionale mbi problematika specifike politike me interes për qytetarët, shoqërinë dhe partnerët ndërkombëtarë. Pjesë e ISP janë ekspertë të njohur të zhvillimeve politike dhe të drejtësisë, të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të marrëdhënieve publike. ISP publikon vazhdimisht raporte monitoruese.

### DISA NGA PROJEKTET KRYESORE TE REALIZUARA VITET E FUNDIT NGA ISP:

- Database [www.deputetim.al](http://www.deputetim.al) mbi monitorimin e Kuvendit të RSH (2017-2020)
  - Database <http://dekriminalizimi.isp.com.al/> mbi monitorimin e ligjit 138/2015 (2019-2022)
  - Monitorim të standardeve të etikës dhe Konfliktit të Interesit në parlament (2019-2020)
  - Monitorim të përdorimit të burimeve shtetërore në fushatë elektorale (2019-2020)
  - Monitorim të reformës në drejtësi dhe progresit të integritetit (nga 2016 dhe në vijim)
  - Database online [www.muzeumemories.info](http://www.muzeumemories.info) Shqipëria në periudhën komuniste
  - Database [www.politike.al](http://www.politike.al) mbi partitë politike, zgjedhjet, organizimin e tyre, 2016-2017
  - Database [www.vota.al](http://www.vota.al) mbi votën dhe subjektet zgjedhore 1991-2017
  - Monitorimin e demokracisë së brendshme në partitë politike (nga 2015). Raporte vjetore periodike
  - Monitorimin e reformës zgjedhore dhe komentat (broshurë) mbi ligjin “Mbi partitë politike”
  - Monitorimi i përfaqësimit të grave në partitë politike (2017) dhe në zgjedhjet lokale 2015
  - Monitorim i zonave zgjedhore të riskut dhe të përfshirjes së elementëve të inkriminuar 2015-2019.
  - Monitorim i qeverisë me ministra teknikë dhe botim profesional me gjetjet (2017-2018)
  - Monitorim të Kuvendeve Kombëtare të partive kryesore. Anketime dhe raporte mbi gjetjet
  - Monitorimin e ligjit mbi të drejtën e informimit (nga 2014 dhe në vijim)
  - Monitorim të ligjit mbi qeverisjen vendore dhe efektet me ndarjen e re (nga 2016 dhe në vijim)
- ❖ Raporti do tu shpërndahet në rrugë elektronike dhe të printuar të gjithë deputetëve në parlament, partive politike parlamentare, partnerëve të ISP, ekspertëve të angazhuar, si dhe mediave kryesore.
  - ❖ Të gjitha publikimet e ISP që lidhen me projekte kombëtare e ndërkombëtare (libra, studime, policy paper, raporte, etj) jepen falas për çdo të interesuar, si dhe publikohen në faqen zyrtare të ISP në formë të përmbledhur
  - ❖ Për çdo interes, sugjerim apo informacion, mund të kontaktoni në çdo kohë ISP përmes adresës zyrtare, e-mailit, faqes së internetit, adresave të ISP në rrjetet sociale, etj.

### CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Kuvendi : bilanci, transparenca dhe problematika : raport monitorues, shtator-dhjetor 2019 / dr. i projektit Afrim Krasniqi. – Tiranë: Instituti i Studimeve Politike, 2020, ... f. ; ... cm. ISBN 978-9928-4592-2-0

1.Kuvendi i Republikës së Shqipërisë 2.Parlamenti shqiptar  
3.Raporte 4.Monitorime 5.Shqipëri

328(496.5) “2019” (047)





[www.isp.com.al](http://www.isp.com.al)  
[www.deputetim.al](http://www.deputetim.al)